



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 25 MAJ 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
NËNKRYETARJA E KUVENDIT
ERMONELA FELAJ
(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 18.5.2023 *(neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)*

2. Njoftime *(neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)*

3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

4. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” *(në mbështetje të neneve 81, 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë të cilësuar votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

5. Projektligji “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet

e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” (në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

Për shkak të objektit të njëjtë, të tria projektligjet do të diskutohen së bashku.

6. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” (në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

7. Akti normativ nr. 1, datë 27.4.2023 “Për një shtesë në ligjin nr.8952, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar” (neni 101 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurisë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

8. Projektvendimi “Për emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit të Statistikave (në mbështetje të pikës 1 të nenit 22, të ligjit

nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit)

9. Projektvendimi “Për emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit të Statistikave (në mbështetje të pikës 1 të nenit 22, të ligjit nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit)

10. Projektvendimi “Për emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit të Statistikave (në mbështetje të pikës 1 të nenit 22, të ligjit nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit)

11. Projektvendimi “Për emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit të Statistikave (në mbështetje të pikës 1 të nenit 22, të ligjit nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit)

12. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit, çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës, nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)

Ermonela Felaj – Kolegë, mirëdita!

Ju lutem, të zëmë vend për fillimin e seancës plenare!

Edhe një herë, kolegë që qëndroni në këmbë, kuorumi për të filluar është i plotë, kështu që, ju lutem, zini vend, që të fillojmë seancën plenare!

Hapim seancën plenare.

Në bazë të nenit 30 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ju bëj të njohur rendin e ditës për këtë seancë.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Fillojmë me çështjet e rendit të ditës.

Kolegë, besoj se jeni njohur me procesverbalin e seancës së kaluar plenare, të datës 18 maj. Nuk e di, a ka dikush vërejtje për procesverbalin? Nëse nuk ka, atëherë procesverbali miratohet.

Kalojmë te njoftimet.

Dëshiroj t'ju njoftoj se gjatë kësaj jave në Kuvendin e Shqipërisë janë depozituar këto akte: një akt nga Këshilli i Ministrave.

Titullin e këtyre çështjeve e gjeni në njoftimet elektronike që i bëhen çdo deputeti.

Në bazë të nenit 16, pika 2, ju njoftoj se me shkresën nr.16/43, datë 23.05.2023, të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është bërë me dije se kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është zgjedhur zoti Gazment Bardhi, duke liruar nga detyra zotin Enkelejd Alibeaj për shkak të dorëheqjes së tij nga ky funksion.

Ju vë në dijeni, po ashtu, se nga institucioni i Presidentit të Republikës është dhënë pëlqimi për hyrjen në fuqi menjëherë të të gjithë paketës ligjore për ndryshimin e pagave.

Gjithashtu, ju njoftoj se deputetët Shkëlqim Bullari dhe Frrok Gjini deklarojnë se dëshirojnë të bëhen pjesë e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ndërsa deputetët Qani Xhafa dhe Asllan Dogjani bëhen pjesë e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Më shkresën nr.16/51, datë 23.05.2023, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, po ashtu Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, me shkresën e vetme nr.16/67, datë 24.05.2023, kanë bërë disa propozime për caktimin e anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues në komisionet e përhershme parlamentare. Këto vendime do t'i miratojmë në fund të seancës plenare. Po ashtu, do të bëjmë me dije përmbajtjen konkrete të secilit prej këtyre vendimeve.

Vijojmë me rendin e ditës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën për procedurë e ka zoti Tritan Shehu.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në këtë sallë prej kohësh bëhen shkelje të rënda të Kushtetutës dhe të Rregullores. Ju takon juve si drejtuese e seancës, Kryetares, pikërisht ta mbronin këtë parlament nga ato shfaqje kaq të rënda, nga këto veprime, të cilat po e shkatërrojnë demokracinë e brendshme të parlamentit duke shkelur Rregulloren dhe procedurën.

Përpara disa kohësh (unë e kam ngritur disa herë, por nga ju nuk ka asnjë përgjigje) u përjashtuan deputetët në mënyrë arbitrare nga Grupi Parlamentar i PD-së, me një paçavure të dikujt dhe ju këtu e justifikoni, duke shkuar në kundërshtim të plotë me Rregulloren e Parlamentit të Shqipërisë, por edhe me procedurat e Parlamentit të Shqipërisë. Cila është sot pasoja?! Sot doli një pasojë katastrofale e këtyre veprimeve arbitrare, antidemokratike, antirregullore, kundër procedurës së parlamentit shqiptar. Ju njoftoni këtu zgjedhjen e dikujt si kryetar të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, që ka marrë 18 vota. Grupi Parlamentar i PD-së ka dalë nga zgjedhjet e vitit 2021, me 52 anëtarë. Si mundet të legalizohen dhe të njoftohen këto gjëra zyrtarisht këtu?! Pra, e kuptoni se ku po çojnë këto veprime që janë anti procedurës, anti Rregullores, anti demokracisë, që po realizohen në parlamentin shqiptar, sa kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së votohet me 18 vota dhe zyrtarizohet nga ju këtu?! Ky është turpi i botës! Është një turp i paimagjinueshëm, sepse ju në këtë mënyrë bashkëpunoni me ata që shkelin Rregulloren dhe falsifikojnë të vërtetën e Partisë Demokratike brenda saj, duke i zyrtarizuar ata. Nuk ka turp më të madh sesa ky. Nuk ka shkelje më të madhe të demokracisë sesa kjo. Prandaj kërkoj të bllokohen këto veprime dhe të vihet në vend e drejta, siç thuhet në Rregullore, për përcaktimin e grupeve parlamentare dhe për vullnetin e çdo deputeti për ta përcaktuar ai përkatësinë në grupin parlamentar, sepse Rregullorja nuk njeh përjashtime, nuk njeh veprime të tilla antidemokratike, sepse Rregullorja është rregullore, e bërë pikërisht për këtë arsye, për të mos i lënë mundësi arbitraritetit dhe pazarit që kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të zgjidhet me 18 vota.

Qesharake kjo, qesharake për të gjithë, qesharake edhe për ju që e zyrarizoni këtu!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shehu!

Kjo është një çështje e tejkaluar. E kemi diskutuar në Kuvendin e Shqipërisë. Ka dy vjet që ka filluar kjo legjislaturë. Kështu që, kjo është përgjigja për vërejtjen që ngritët si vërejtje procedurale.

Siç jeni njoftuar, në rendin e ditës janë 3 projektligje, të cilat përbëjnë paketën ligjore për ndryshimin e pagave, konkretisht: projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584/2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”; projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; projektligji “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”. Dëshiroj t’ju njoftoj se të tria këto projektligje do të diskutohen së bashku dhe sigurisht që deputetët do të kenë të drejtë të flasin në kohën maksimale të diskutimeve, siç e parasheh Rregullorja, për rrjedhojë koha e diskutimeve do të jetë pa limit.

Referuar nenit 73, pika 2 e Rregullores, a ka pyetje për paketën e projektligjeve, të cilën sapo e përmenda? Nuk ka pyetje.

Atëherë, më lejoni të ftoj ministren e Financave dhe Ekonomisë të mbajë fjalën si nismëtare e këtyre projektligjeve. Diskutimi nuk përmban kufizim kohor.

Ju lutem, zonja Ministre, fjala është për ju!

Delina Ibrahimaj – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot ndihem e privilegjuar që vij para jush për të prezantuar finalizimin e një pune të gjatë: hapin më të rëndësishëm ligjor në aplikimin e një reforme të plotë dhe të domosdoshme të pagave në administratën publike. Kjo reformë do të përfshijë të gjithë hierarkinë e administratës shtetërore, të gjithë sektorët e saj dhe besojmë se do të pasohet edhe me rritje të pagave në sektorin privat. Transformimi i sistemit të pagave do të sjellë stimuj të rinj për ekonominë tonë, në një kohë kur rrethanat ekonomike botërore paraqesin

sfida ende të mëdha. Bazat e kësaj reforme u hodhën me rritjen e fortë të pagës minimale, e cila nisi gjatë vitit të kaluar, duke arritur në nivelin 34 000 lekë dhe që nga muaji prill 2023, shkoi në nivelin 40 000 lekë. Ne do të vazhdojmë me rritjen e pagës minimale deri në nivelin 45 000 lekë dhe në vijim, deri në fund të këtij mandati qeverisës. Ky nuk është vetëm një premtim, por është një mjet konkret për t’i mbështetur punonjësit me paga të ulëta në Shqipëri. Kjo është një arritje që tregon përkushtimin tonë për të rritur mirëqenien e punëmarrësve. Ne besojmë te vlera e punës, tek ata njerëz që i shërbejnë shtetit, si dhe tek ata njerëz që i shërbejnë sipërmarrjes private dhe, duke besuar se kapitali njerëzor është aseti më i rëndësishëm që kemi, inicijojmë këtë reformë dhe, si e tillë, ajo duhet vlerësuar. Ne vijmë sot me këtë reformë që mundëson jo vetëm rritjen e pagave më të ulëta, por një shtrije të gjerë të rritjes së pagave në të gjitha nivelet e administratës publike.

Ne besojmë te puna e përkushtuar e mijëra funksionarëve publikë, e mjekëve, e infermierëve, e zjarrfikësve, e mësuesve, e edukatorëve, e inxhinierëve, e punonjësve të rendit, e punonjësve të shërbimeve mbështetëse, të mijëra e mijëra qytetarëve që çdo ditë japin kontributin e tyre për ta bërë vendin tonë më të mirë.

Gjatë vitit të ardhshëm, paga mesatare bruto në administratën publike pritet të arrijë nivelin 900 euro. Kjo është një arritje e konsiderueshme, nëse ne marrim në konsideratë se në vitin 2013 paga mesatare në administratën publike ishte 370 euro. Pra, në 10 vjet ne do të arrijmë që pagën ta rritim me 140%. Ndërkohë që shumëkush mund të thotë se ka pasur edhe rritje të çmimeve. Nëse ne do të eliminojmë efektin e inflacionit në këtë rritje të çmimeve, rritja e pagës reale në 10 vjetët e fundit do të shkojë në nivelin 115%. Kemi dëgjuar rëndom në këtë periudhë që kjo ishte një reformë elektorale, se e lançuam për hir të zgjedhjeve. Gjatë fushatës pati edhe diskutime për një bllokim të mundshëm, për pamundësinë e kryerjes së kësaj reforme. E vërteta është se kjo reformë nuk nisi nga hiçi. E vërteta është se ne kemi vite që duam ta realizojmë këtë reformë dhe që punojmë për të. Por të tilla reforma nuk janë çështje dëshirash dhe vullneti, pasi për të tilla reforma duhet të përmbushen kushtet e përcaktuara ekonomike, në mënyrë që të implementohen, dhe sot ekonomia na e jep këtë

mundësi. Sot ekonomia na e jep mundësinë, pasi ne ndër vite kemi implementuar reforma strukturore, të cilat po japim frytet e tyre. Kur kemi bërë ndërhyrjen e parë në sistemin e pagave, ne kemi menduar të ndërhyjmë në ata sektorë, të cilët kishin më shumë nevojë dhe ndër vite kemi ndërhyrë në pagat e sistemit shëndetësor, në pagat e sistemit arsimor. 26% janë rritur pagat e infermierëve, 22% janë rritur pagat e mjekëve, 7% janë rritur pagat e mësuesve në sistemin parauniversitar. Megjithatë, reforma që sjellim sot do t'i vërë kapakun njëherë e përgjithmonë rritjes së pagave dhe diskutimit të rritjes së pagave. Ndër vite kemi diskutuar për domosdoshmërinë e indeksimit të pagave dhe si pjesë e paketës që prezantojmë sot, parashikohet dhe indeksimi me normën e inflacionit të të gjitha pagave të funksionarëve publikë në të gjithë administratën publike. Siç e thashë edhe më sipër, kjo është një reformë, të cilën ekonomia na e mundëson sot. Ne sot kemi një pagë minimale, e cila ka shkuar në nivelin 40 mijë lekë. Unë dua t'ju kujtoj që në vitin 2013 paga minimale ishte 22 mijë lekë. Unë dua t'ju kujtoj që prodhimi i brendshëm bruto, rritja e ekonomisë në vitin 2013 ishte 1%, ndërsa në vitin 2022 ishte 4,8%. Ne gjetëm një normë papunësie prej 16,4%, ndërkohë që në vitin 2022 ajo arriti në 10,8%. Ne e gjetëm borxhin publik 70,4% të PBB-së dhe sot e kemi çuar atë 63,27%. Ne e gjetëm PBB-në për frymë në vitin 2013 në nivelin 3325 dollarë, ndërsa sot është 6418 dollarë. Të gjithë këta parametra i rendis dhe i shtjelloj, me qëllim për të shpjeguar se sot ekonomia ecën me hapa të shëndoshë dhe ne kemi hapësirën e përshtatshme buxhetore për ta përballuar këtë reformë madhore për rritjen e pagave. Nëpërmjet kësaj reforme synojmë të krijojmë një piramidë të niveleve të pagave për disa institucione kushtetuese dhe të pavarura, e cila do të jetë në përputhje me rëndësinë dhe përgjegjësinë e tyre, me përcaktimin e pagës së Presidentit, si paga më e lartë në Republikën e Shqipërisë, ku paga bruto e Presidentit nga 257 mijë lekë do të shkojë në 425 mijë lekë në muaj ose rreth 65,3% më shumë. Unë dua t'ju kujtoj se paga e Presidentit nuk ka ndryshuar që nga viti 2013.

Nëpërmjet këtij projektligji synojmë të përmirësojmë hierarkinë e pagave të administratës publike, duke krijuar kështu kushtet e nevojshme për të tërhequr dhe për të mbajtur

individët e kualifikuar në administratën publike. Ne do të realizojmë një lidhje të drejtpërdrejtë midis pozicionit të punës dhe përgjegjësisë përkatëse me pagën. Reforma synon të krijojë rritje të mëdha të pagës për rritje të kompleksitetit të punës dhe të përgjegjësisë, duke përfshirë përgjegjësitë drejtuese. Po japim një pagë më të mirë për pozicionet e punës dhe do të presim një punë më të mirë për çdo pagë.

Efekti financiar i kësaj reforme, pasi ajo të implementohet si e tërë, është 39 miliardë lekë nominalë. Janë mbi 130 mijë punonjës që do të përfitojnë nga kjo reformë në të gjitha qelizat e administratës publike, qoftë në nivel qendror, qoftë në atë lokal. Pra, janë 39 miliardë lekë dhe këtu përfshihet edhe 1 miliard lekë si efekt i vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe rritjes së pagës së magistratëve për shkak të këtij vendimi, një tjetër ligj, i cili do të prezantohet sot dhe pritet të miratohet sot.

Të nderuar deputetë, ky është ndryshimi më i madh që kemi bërë ndonjëherë në politikën buxhetore dhe fiskale. Është një ndryshim historik, i cili, nëse doni t'ju shpjegoj me fjalë të thjeshta, e sjell politikën buxhetore më shumë në shërbim të qytetarëve. Sot, për çdo 2 lekë të ardhura, që mblidhen nga taksat dhe tatimet, 1 lek do të shkojë për transfertat direkte, për paga, për pensione dhe për transfertat sociale, për ndihmë ekonomike apo për aftësi të kufizuara. Pra, gjysma e parave të buxhetit të shtetit do të shkojë drejtpërdrejt te qytetarët shqiptarë, ndërkohë që gjysma tjetër do të shkojë për përmirësimin e shërbimeve, për investime dhe për aktivitete të tjera buxhetore.

Ky projektligj na mundëson një reformë të plotë në administratën shtetërore, për ta bërë atë më kompetitive në raport me ekonominë shqiptare, duke ndjekur, urojmë, rritjen e pagave për pjesën më konkurruese në sektorin privat, duke ushtruar nxitje në të gjithë ekonominë, duke nxitur konsumin, duke nxitur rritjen ekonomike. Më lejoni ta përkthej në terma më të thjeshtë, për ta bërë të qartë se çfarë sjellin këto ndryshime.

Në shëndetësi, mjeku specialist do të përfitojë një pagë bruto prej 174 mijë lekësh ose 115 mijë lekë në muaj më shumë se në vitin 2013. Mjekët e përgjithshëm do të përfitojnë një pagë bruto prej 137-mijëlekësh ose 77 mijë lekë më shumë se në vitin 2013. Infermierët do të përfitojnë mesatarisht një pagë bruto prej rreth 87-

mijëlekësh ose 25 mijë lekë më shumë se në vitin 2013.

Në arsimin parauniversitar, mësuesi i shkollës nëntëvjeçare do të përfitojë një pagë bruto prej rreth 99-mijëlekësh ose 40 mijë lekë më shumë se në vitin 2013. Rritja mesatare në arsim është 72,4 %, ndërsa në shëndetësi është 99,2 %.

Në Policinë e Shtetit, një komisar do të përfitojë një pagë bruto prej 105-mijëlekësh në muaj ose 36 mijë lekë më shumë se në vitin 2013. Inspektori i parë i Policisë së Shtetit do të përfitojë një pagë bruto prej rreth 90-mijëlekësh në muaj ose 37 mijë lekë më shumë se në vitin 2013.

Pra, pagat mesatare do të rriten në mënyrë të qëndrueshme, ndërkohë që kemi pasur shumë diskutime mbi rritjen e pagave të Presidentit, të deputetëve dhe të kabinetit qeveritar. Niveli i rritjes së tyre, siç parashtrova, është më i ulët se pjesa më e madhe e rritjes së pagave të funksionarëve publikë të domosdoshëm.

Të nderuar deputetë, për ta përmbledhur fjalën time dhe për t'ju bërë ftesë në lidhje me miratimin e kësaj pakete ligjore, më lejoni të shprehem se sot është një nga ditët më të shënuara për mua si ministre e Financave dhe Ekonomisë, për të gjithë kabinetin qeveritar. Besoj se edhe për ju si përfaqësues të popullit do të jetë një ditë e tillë. Teksa paraqesim për miratim këto projektligje, tashmë të konsultuara e të dakordësuara në komisionet parlamentare, është shumë e rëndësishme për ne që të konstatojmë se sa e qëndrueshme është ekonomia shqiptare, dhe se sa kemi hyrë realisht në një fazë të re të zhvillimit të saj, pavarësisht goditjeve të jashtëzakonshme që Shqipëria ka marrë në vazhden e disa sfidave që na është dashur të përballojmë, për të cilat jemi dëshmitarë jo vetëm ne e qytetarët, por edhe më gjerë, madje e gjithë bota. Ne sot, të gjithë bashkë, po vendosim një gur kilometrik në reformën e re të pagave. Rritja e pagave është një ndër hapat më të mëdhenj që ka ndërmarrë qeveria, gjë që është rezultat i të gjitha përpjekjeve, reformave e punëve të bëra, për të ardhur në ditën kur të krijojmë një mundësi për shtëpinë tonë të përbashkët.

Kësisoj, unë ju falënderoj dhe ju ftoj edhe një herë ta miratoni këtë projektligj të rëndësishëm dhe të gjithë paketën që e shoqëron atë!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ju faleminderit, zonja Ministre!

Fillojmë me diskutimet për paketën ligjore që lidhet me reformën e pagave.

Fjalën e ka deputetja Blerina Gjylameti.

Të përgatitet zonja Tabaku.

Blerina Gjylameti – E nderuara zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ky që po diskutojmë sot është një nga projektligjet më të rëndësishme që kemi diskutuar në këtë mandat, por dhe në mandatet e mëparshme.

Nëse duhen thënë dy gjëra, me të cilat mund t'u drejtohem qytetarëve shqiptarë, ato kanë të bëjnë me faktin se ky projektligj nuk vjen si një vendim i pakonsultuar e i pabazuar në atë çfarë do të ishte një rritje ekonomike e qëndrueshme. Kur erdhëm në pushtet në vitin 2013 gjetëm një ekonomi pothuajse të rrënuar. Ajo që premtuam ishte se nuk do të preknim aspak pagat, deri në momentin kur do të kishim një rritje ekonomike të qëndrueshme, do të kishim financa publike, të cilat do të ishin në atë çfarë është trendi normal. Nga ana tjetër, më pas do të punonim në të gjithë ata sektorë, të cilët janë sektorë të rëndësishëm, si shëndetësia, arsimi dhe rendi.

Sot jemi në një moment kur, pas tre vjetëve dhe tri goditjeve shumë të mëdha që ka marrë ekonomia shqiptare nga fatkeqësi natyrore si tërmeti, nga pandemia, e më pas nga kriza mbarëbotërore e inflacionit, e cila vjen si pasojë e agresionit rus në Ukrainë, ne vijmë sot me këtë lajm kaq të rëndësishëm, që prek çdo qytetar shqiptar, qoftë ata që janë të punësuar në administratën publike, qoftë ata që punojnë në sektorin privat.

Të gjithë e dimë se në tre sektorët kryesorë, në të cilët është ndërhyrë prej vitesh, ne kemi ndërhyrë me prioritet për shkak të problematikave, për pjesën e shëndetësisë, për pjesën e arsimit, për pjesën e rendit. Ndërkohë, sot arrijmë të kemi një prekje në çdo buxhet familjar. Jam më se e lumtur që jo vetëm ka mbështetje buxhetore, jo vetëm që ky është një impuls i ri në ekonominë shqiptare, por dhe se do të vlejë për shërbime shumë më të mira publike nga ana e administratës publike. Vjen si pasojë edhe e disa problematikave që ka pasur, problematika të largimeve nga administrata publike drejt sektorit

privat, për shkak të gjithë atyre pagave që janë jokonkurruese në administratën publike, por dhe për rekrutimin e një stafi shumë herë më të kualifikuar, duke pasur paga më të larta.

Unë besoj se një sërë reformash strukturore në ekonomi, të ndërmarra ndër vite, gjë që e kemi thënë vazhdimisht, të cilat kanë pasur pasoja dhe kanë qenë të dhimbshme, kanë bërë të mundur që sot të ketë një reformë të thellë të pagave në administratën publike. Të flasim sot se për çfarë do të jetë ndryshimi dhe cili do të jetë lajmi, unë besoj se është diçka që na bën të ndihemi mirë të gjithëve, si nga krahu i mazhorancës, ashtu edhe nga ai i opozitës. Këtu është momenti për të falënderuar të gjithë kolegët e opozitës, të cilët kanë qenë jo vetëm pjesëmarrës në diskutime, por edhe mbështetës të kësaj reforme. Sot ne prekim ata që punojnë në të gjithë sektorët, duke filluar që nga shëndetësia, ku kemi një rritje që nis nga infermierët, me një pagë që do të shkojë mesatarisht në 90 mijë lekë deri në fund të vitit 2024, gjithashtu, edhe për mjekët, të cilët do të kalojnë me një pagë mesatare që e kapërcen **11-mijëlekëshin** për mjekët e familjes apo mjekët e përgjithshëm, ndërsa mjekët specialistë kalojnë me një impakt mbi 174 mijë lekë.

Nga ana tjetër, unë jam e bindur se edhe për sistemin parauniversitar vazhdimi i rritjes është shumë i rëndësishëm. Kjo e shoqëruar me reformat në kurrikula, e shoqëruar edhe me të gjitha investimet në infrastrukturë, do bëjë të mundur që ne të investojmë për të ardhmen. Duke pasur mësues të sistemit parauniversitar, që kanë një pagë që nis me një rritje nga 20 mijë në 51 mijë, te pjesa e një rritjeje mesatare 26 mijë lekë për çdo mësues të sistemit parauniversitar, paga shkon në një nivel të kënaqshëm, dhe na nxit të vijojmë me atë që kemi nisur. Nga ana tjetër, për të gjithë mësuesit që janë të angazhuar në sistemin e arsimit të mesëm, paga mesatare shkon 106 mijë lekë. Përsëri është një pagë e cila vlerëson në mënyrë dinjitoze punën që ata bëjnë.

Ndërkohë, kur flasim për sistemin universitar, kemi debatuar dhe diskutuar shumë herë në Komisionin e Ekonomisë në lidhje me mënyrën se si duhej të ndikonim për të ndryshuar pjesën e shpërblimit që merr e gjithë trupa pedagogjike në arsimin universitar. Sot ne flasim për një rritje mesatare nga 20 mijë lekë për nivelin më të ulët të gradave, për lektorin, në një rritje prej 52-mijëlekësh për gradat më të larta. Kësisoj, unë

besoj se ky është një tjetër lajm shumë i mirë për të gjithë ata që na dëgjojnë. Ndërkohë, në anën tjetër, ne diskutojmë për numrin e atyre që preken në administratën publike.

Të nderuar kolegë, besoj se me këtë rritje pagash, me këtë reformë, ne jo vetëm do të arrijmë të mbajmë njerëzit apo punonjësit më të kualifikuar në administratën publike, por po ashtu edhe do të rekrutojmë më të mirët. Kjo duke nisur me pagat e specialistëve, që fillojnë me një rritje nga 26% në 34%, nga 2023 në 2024, po ashtu me të gjitha gradat në të gjithë administratën, por dhe me sektorë të rëndësishëm si rendi, me pagat që nisin me një rritje nga 21% në 36%, duke vijuar me zjarrfikësit, një tjetër diskutim që e kemi pasur vazhdimisht, sepse në kohën e fatkeqësive të gjithë e kuptuam se ata do të duhej të ishin më të shpërblyer, që të mund të kemi atë që duhet të kemi: një shërbim sa më cilësor në ruajtjen e njerëzve. Sa u takon zjarrfikësve, ne vazhdojmë përsëri me rritje të pagës nga 7% deri në 40%.

Ndërkohë, unë jam e bindur se edhe për pjesën e rendit në polici, edhe për pjesën e Gardës së Republikës, do të ketë vijimësi të rritjes jo vetëm në pjesën e pagave bruto. Nga ana tjetër, është një lajm shumë i mirë dhe vendim i duhur, besoj unë, rishikimi i pagesave për vështirësi, rishikimi i pagesave për pjesën e vjetërsisë në punë, si dhe specifikat që ka çdo profesion dhe çdo sektor. Të gjitha këto shërbejnë për të pasur jo vetëm shpërblim shumë më të mirë të punës, por edhe shërbime shumë më të mira për qytetarët.

Të nderuar kolegë, ne debatojmë dhe diskutojmë shumë në Komisionin e Ekonomisë sa herë që vjen buxheti, sa herë që vijnë politika në mbështetje të sektorëve të caktuar, duke bërë debate nga më të ndryshmet. Besoj se një nga projektligjet që ka bërë të ulen tonet dhe të zbritet nga llogorja, ka qenë ky. Kjo, sepse bëhet fjalë për një vendim që prek gjithkënd, nuk e prek se është i majtë apo i djathtë. Kësisoj, unë i falënderoj kolegët e opozitës për mbështetjen që kanë dhënë! Nga ana tjetër, dua të falënderoj qeverinë për atë çfarë po ndodh sot! Me rritjen e pagave ne do të kemi një impuls shumë më të madh në ekonomi, që do të thotë se do të kemi rritje të konsumit. Me rritjen e konsumit do të kemi rritje të të ardhurave, duke kaluar në hapin e radhës, që besoj se do të ndërmerret shumë shpejt, gjë të cilën e presin shumë pensionistë në Shqipëri, të gjithë ata që kanë kontribuar ndër vite në sektorë të ndryshëm,

që sot duhet të shpërblehen për punën e tyre. Kështu që, unë besoj se pas këtij hapi, do të kalojmë në hapin tjetër të radhës, që është rritja e pensioneve.

Falënderoj të gjithë kolegët në Komisionin e Ekonomisë, për diskutimet që kemi pasur! Shpresoj që atë frymë bashkëpunimi që kemi pasur atje, ta kemi edhe këtu, duke i votuar të gjitha projektligjet, sepse në fund të fundit kanë efekt financiar për xhepin e çdo qytetari.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Fjalën e ka zonja Tabaku.

Të përgatitet zonja Bushka.

Jorida Tabaku – Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Besoj se për shumë prej nesh është i vështirë rifillimi i seancave aty ku i kemi lënë, duke u sjellë sikur nuk ka ndodhur gjë. Pak më shumë se një javë më parë, Shqipëria dhe shqiptarët humbën shansin për të pasur një rotacion lokal, ku harta kishte pak a shumë të njëjtën pamje që kishte katër vjet më parë.

Këtu nuk është as vendi, as momenti për të bërë analizat tona të brendshme, por pak fjalë dua t'i them: është fakt se mbas zgjedhjeve të 2021-shtit largimi i shqiptarëve nga këto troje është rritur e përsheptuar aq shumë, sa jo pak herë nxitojmë të justifikojmë, edhe me pak siklet, se çfarë po ndodh, cilat janë arsyt, pse sot ka më pak shpresë dhe pse shqiptarët largohen.

Kam takuar pafund të rinj e të reja që kanë një mlllef, që kanë një mërzi, por dhe një dëshirë për ndryshim që duan ta materializojnë, por, fatkeqësisht, nuk arritën dot ta bëjnë në zgjedhjet lokale, nuk arritën dot që atë potencial të paçliruar, ta çlironin, që sot të mund të diskutojmë për të ardhmen, jo për të shkuarën.

Kur shihja fytirat e lodhura në takimet elektorale, që prisnin me valle për të dëgjuar se ç' do të ndodhë nesër, kur shihja moshën mesatare të rritur, kur pashë shifrat, sipas të cilave në mbi 122 000 votues për herë të parë, nuk zgjodhën të shkonin në votime as 17 mijë të tillë, pra 13,5 %, atëherë kuptohet se kjo është edhe pafuqi e shprehur me refuzimin për të votuar. Më tej, kur shohim se shifrat, sipas të cilave pothuajse 300 mijë shqiptarë të tjerë nuk shkuan te kutitë e votimit, atëherë e kupton se problemi është edhe me ne. Ndërkohë, ka një ndjenjë të thellë frustrimi

që rinia e tyre është marrë peng nga një elitë politike, e cila i bën të ndihen të pafuqishëm të ndryshojnë për mirë. Janë disa barrierat e ngritura qëllimisht, për ta ushqyer këtë ndjenjë apo ndjenja të ngjashme me këto, që shtynë shumë njerëz të largohen, në vend që të kërkojnë ndryshimin duke punuar dhe luftuar këtu. Barrierat për të cilat flas nuk janë të padukshme, por ka edhe shumë prej tyre, si përpjekja e vazhdueshme për të ndikuar votën, këmbëngulja e vazhdueshme për të vendosur nën presion administratën, një shtet i kthyer në njësh me partinë në pushtet, blerja e votës, por njëkohësisht edhe një konkurrencë e pashëndetshme e ministrave, për të tërhequr me çdo kusht vëmendjen e liderit, se kush hedh më shumë e kush blen më shumë. Në fakt, duhet të ishte konkurrencë me ne, por që, fatkeqësisht, nuk ndodhi. Në qendrat e bojatisura të qyteteve të rilindura, ku kërcenin të moshuarit, u fol për shumëçka, por shumë pak u fol se si do jetë qeverisja nesër. E në këtë logore fjalësh, kërcimesh, refuzimi për të vepruar, refuzimi për të votuar, mungese alternative e programi, presioni e turli eksperiencash, erdhi sigurisht edhe premtimi për rritjen e madhe të pagave.

Rritja ekonomike, e parashikuar nga qeveria shqiptare se do të ishte në nivelin 4,48%, nuk është aq. Në fakt, pritshmëritë tejet optimiste të qeverisë shqiptare do të përfundojnë në një rritje prej 2,2 %. Mbi 70% e shqiptarëve vuajnë sot krizën ekonomike, krizën e pagave të ulëta, krizën e inflacionit socialist, si pasojë e politikave të skaduara, që kanë ndërtuar një sistem po të skaduar, një kënetë të madhe ekonomike e politike, që qytetarët dhe të rinjtë e kuptojnë, arsye për të cilën refuzojnë të marrin pjesë.

Xhepat e qytetarëve, sidomos të atyre që kanë marrë kredi nëpër banka, do të paguajnë gjithnjë e më shumë parë për këstet e tyre. Sot një shqiptari do t'i duhet të punojnë mbi 14 vjet për të paguar një kredi hipotekore për një shtëpi. Çmimet e konsumit për shportën e ushqimeve janë rritur me mbi 20%, ndërkohë që inflacioni bazë i përlllogaritur nga Banka e Shqipërisë ka shkuar në 9%, krahasuar me vende të tjera të Bashkimit Europian, por edhe të rajonit, ku është në nivelin 6%-6,3 %.

Më të varfër, më të vetmuar, me më shumë kosto! Kjo është ekonomia e ideuar dhe e materializuar nga qeveria në këta dhjetë vjet. Punon shqiptari që të pasurohet oligarku! Mëson

shqiptari që të taksohet më pak oligarku! Përpiqet shqiptari që të përfitojë përjashtime në taksa një pakicë, e cila po merr gjithnjë e më shumë vendime për Shqipërinë.

Shifrat e EUROSTAT-it flasin se, që nga viti 2014, ka shkuar në 200 mijë numri i shqiptarëve të larguar, 75% e të cilëve janë të moshës deri në 35 vjeç. Ky është rreziku i vërtetë i ekonomisë shqiptare: largimi i atyre që sot duhej të bënin diferencën në ekonomi. Sistemi i korrumpuar, që nis nga taksat dhe përfundon në mënyrën se si shkruhen dhe miratohen ligjet, se si promovohesh në administratë, se si nuk ke hapësirë për të shprehur talentin tënd, unë besoj se është një nga arsytet.

Deficiti tregtar thellohet, ndërkohë që euro, që mbase është flamuri i vetëm i një ekonomie informale, nesër do të na dëshmojë se si paratë informale të injektuara në sasi të mëdha në ekonomi, të paktën vitet e fundit e kanë shndërruar ekonominë në një ndër më të dobëtat e Ballkanit Perëndimor, por çuditërisht me monedhën më të fortë të Ballkanit Perëndimor.

Rritja e pagave është një realitet i ri. Nga viti 2019 deri në vitin 2022, paga minimale është rritur me ritme dy herë më të larta se paga mesatare. Gjatë këtij harku kohor paga minimale u rrit me 30%, ndërsa paga mesatare me vetëm 15%. Vetë paga mesatare është rritur nga 45 mijë lekë, që ishte pak vite më parë, në 66 mijë lekë pas nëntë vjetësh, në 2022-shin. Duke e zhveshur nga rritja e çmimeve, nga inflacioni, rritja reale ka qenë 25% në 10 vjetët e fundit, hera e parë që është rritur kaq pak me këto ritme në 30 vjetët e fundit, një herë në dy vjet, me saktësi kalendarike, sa herë ka pasur zgjedhje. Për 10 vjet me radhë janë marrë 4 eurobonde, kontrata e partneritetit publik-privat ka shkuar në 50% të PBB-së, ndërkohë që konkurrueshmëria e pagave me rajonin e ka çuar Shqipërinë të fundit. Fuqia blerëse e një familjeje shqiptare, që merr pagën minimale, sipas EUROSTAT-it është më e ulëta në Ballkanin Perëndimor. Në një ekonomi të tillë nuk prodhon dot një rritje pagash me vendim qeverie, sepse, normalisht, ekonomia duhet ta gjenerojë vetë rritjen e pagave; sektori privat, normalisht, duhet t'i rrisë vetë pagat, dhe ta ndjekë edhe publiku.

Thënë këtë, asgjë nga këto nuk ka rëndësi, sepse rëndësi ka që të punësuarit në administratën publike e meritojnë rritjen e vonuar të pagave,

pasi qeveria, në vend që të punonte për një rritje graduale për to dhe, pa dyshim, për meritokracinë, ka investuar në drejtime të tjera, ndër të cilat kontratat e partneritetit publik-privat.

Fatkeqësisht, pabarazia duket se është thellësisht një proces i ndikuar nga vendimet e këtij parlamenti. Sa e sa ligje janë miratuar këtu, që promovojnë pabarazinë dhe mungesën e mobilitetit social?! Bashkë me këtë, administrata publike sot ka nevojë të jetë e pakapur, ka nevojë të jetë jopolitike, ka nevojë të vazhdojë atë që u nis në vitin 2013, por u shkëlqoi me të dyja këmbët, ka nevojë për një sistem ku promovohesh pa lidhje politike. Kur dëgjoj prezantimet e këshilltarëve bashkiakë nëpër rrethe, janë të gjithë të punësuar ose në OSHEE, ose në administratën publike, ose në drejtoritë rajonale, ose në drejtoritë e shëndetit, ose si drejtorë spitalesh. I gjithë shteti sot është i lidhur politikisht. Prandaj largohen sot të rinjtë, sepse duhet patjetër të jesh dikushi ose familjar i dikushit, ose i lidhur me dikë, që të punësohesh në shtet dhe të kesh mundësi të arrish diçka.

Besoj se shqiptarëve u bëhet shumë vonë për politikën; e kuptojnë shumë mirë politikën, se kur e shkuara u përdoret si shantazh për të ardhmen, se kur e shkuara u sillet si barrierë për të mos ndryshuar dhe për të mos luftuar, edhe për gabimet tona si opozitë, ata zgjedhin të mos votojnë dhe të na bojkotojnë.

Gjithsesi, kjo nuk duhet të na dekurajojë ne nga një përpjekje e thjeshtë dhe tërësisht e ndershme për t'i dëgjuar shqiptarët, për të lexuar votën e tyre, të demokratëve dhe të socialistëve, për t'i ftuar ata në një angazhim, qoftë dhe për t'i mikluar, që në vend të cinizmit të na ofrojnë shansin për t'i përfaqësuar apo për t'u përfaqësuar prej tyre. E di që shumë prej tyre janë mosbesues ndaj nesh. Nuk u vë faj!

Shqipëria sot është një katrahurë ekonomike dhe politike. Besoj se ka vetëm një rrugë për ne, si deputetë të opozitës: të rikthejmë besimin te politika dhe te ndryshimi, te politika si instrument për të bërë mirë e për të ndryshuar çdo ditë, jo sa herë ka zgjedhje, me çdo mundësi, qoftë dhe me kosto politike për secilin prej nesh. Unë besoj se shqiptarët e meritojnë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Tabaku!

Fjalën e ka zonja Bushka.

Të përgatitet zoti Sula.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të dashur kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në fakt, sot është një ditë shumë e rëndësishme për Kuvendin, pasi flasim për një reformë të pagave dhe adresojmë më së miri interesin publik.

Para se të paraqes rëndësinë e projektligjeve, të cilat po i diskutojmë tani, do të doja t'i thosha diçka zonjës Tabaku, sepse e dëgjova fjalimin: ne, zonja Tabaku, jemi në një zonë elektorale, të paktën kështu me rezultot që nga viti 2021. Nëse do t'i shihnit shifrat, jo nga zyra apo nga shtëpia, por nga terreni, do të vinit re se PS-ja, të paktën në njësinë nr.3 në Tiranë, ku unë kam bërë analizën time, ka marrë votat e 2021-shit në këto zgjedhje, madje ka pasur edhe një rritje më shumë në vitin 2023 se në vitin 2021, çka do të thotë se populli e ka mbështetur PS-në, duke i dhënë besimin, dhe besimi nuk është dhënë vetvetiu, por sepse qytetarët kanë besuar te punët e kryera, si dhe u kemi dhënë besim për atë që do të bëhet në të ardhmen. Gjithçka që ju thoni këtu, duhet bërë në bazë të analizave, të objektivitetit dhe, për të thënë të drejtën, me këmbë në tokë. Kërkojini analizat në grupin tuaj, mos na fajësoni ne për humbjet njëra pas tjetrës që pësoni në zgjedhje.

Për sa na takon, ne jo vetëm jemi të përgjegjshëm në punën tonë të përditshme, por besoj se kemi qenë më se konstruktivë në bashkëpunimin me opozitën. Sot është dita që të gjithë të bëjmë një analizë.

Duke i falënderuar qytetarët për mbështetjen që i dhanë PS-së, sa me mendje, aq dhe me zemër, duhet t'i them Partisë Socialiste, kolegëve të mi dhe vetes sime, që ne duhet të analizojmë edhe fitoren, sepse kjo do të na bëjë edhe më të fortë në shërbim të interesave të qytetarëve. Fitorja duhet analizuar, sepse besimi i dhënë nga populli duhet mbajtur në të ardhmen. Pra, nuk është e rëndësishme vetëm të fitosh një betejë politike dhe të marrësh besimin e qytetarëve që t'i shërbesh vendit, por edhe ta mbash me punë atë fitore dhe të justifikosh të gjithë besimin e dhënë nga publiku. Për ne dhe për mua kjo fitore ishte një sfidë dhe një përgjegjësi më e madhe për t'i shërbyer interesit publik. Ndaj po e them edhe një herë, që analizat nuk bëhen nga shtëpia apo nga zyra, por bëhen në bazë të statistikave, bëhen në

terren, duke komunikuar me njerëzit, se, për sa kohë PS-ja ka marrë mbështetje njësoj si në vitin 2021 (po ta shihni, edhe të rinjtë e kanë votuar PS-në, duke i dhënë besimin me votën e tyre), kjo tregon që, të paktën, populli na ka besuar në 2023-shin, ashtu si në 2021-shin, dhe ne këtë besim duhet ta përkthejmë në punë dhe ta justifikojmë.

Gjithçka që dëgjova deri tani nuk është problem i PS-së, por i opozitës, e cila duhet t'i vërë gishtin kokës dhe t'i analizojë të gjitha problematikat se përse i humb zgjedhjet. Kështu që nuk ia kemi fajin ne.

Zotërinj,

Sot është një ditë e rëndësishme, siç e thashë më parë, sepse rriten pagat në vendin tonë. Në kaq vite pas rënies së diktaturës, kjo rritje që bëhet sot është domethënëse dhe nuk erdhi vetvetiu, por erdhi pas disa vitesh punë, punë dhe vetëm punë për konsolidimin e financave të shtetit; pas disa vitesh punë për të mbajtur të qëndrueshme të ardhurat e buxhetit të shtetit; pas disa vitesh punë për të ulur nivelin e borxhit; pas disa vitesh punë për të krijuar fonde për investime, për të rritur ekonominë, për të krijuar të ardhura nga të gjitha politikat tona fiskale, në mënyrë që të krijojmë fonde për zhvillimin ekonomik e më pas për rritjen e pagave; pas disa vitesh punë për përballimin me sukses të disa fatkeqësive dhe krizave, si: tërmeti, Covid-19, rritja e çmimit të energjisë elektrike, që ishte një krizë botërore, dhe kriza e inflacionit të çmimeve, për shkak të luftës në Ukrainë. Pas kaq shumë krizash dhe kaq shumë punësh e përpjekjesh ia kemi dalë të krijojmë mjetet buxhetore për të arritur në këtë ditë, ku pagat e reja, të cilat do të ndikojnë në trajtimin me më shumë dinjitet, në aspektin ekonomik, të administratës shtetërore, të sektorëve të rëndësishëm, si: arsimit, shëndetësia, siguria e më gjerë, do të jenë një motor zhvillimi ekonomik për vendin. Unë besoj se me rritjen e pagave do të kemi një rritje të fondit të kontributeve për sigurimet shoqërore, duke krijuar baza edhe për rritjen e pensioneve në të ardhmen.

Ne kemi bërë rritje të herëpashershme të pagave në sektorë prioritarë, si arsimit dhe shëndetësia, dhe i kemi diskutuar këtu. Ne kemi bërë, gjithashtu, edhe masat e indeksimit të pensioneve, kemi miratuar shpërblime për pensionistët, por në këtë drejtim ende po punojmë. Projektligjet e sotme janë një bazë e

mirë dhe do të ndikojnë pozitivisht në të ardhmen në politikën për rritjen e pensioneve.

Sot pagat janë fryt i përpjekjeve të gjata, i këmbënguljes dhe i durimit të madh të qeverisë shqiptare për reforma të vështira, masa të domosdoshme për ekonominë dhe për financat e vendit, për rritjen e të ardhurave falë rritjes së ekonomisë së tregtisë, investimeve publike dhe private; rritjes së prodhimit dhe eksporteve; modernizimit të sistemit të mbledhjes së taksave përmes kompjuterizimit të transaksioneve në kohë reale; lehtësimit dhe rritjes së shpejtësisë së shërbimeve për biznesin; digjitalizimit të tyre; forcimit të shtetit në tërësi dhe uljes së ndjeshme të korrupsionit në tatime e dogana, por, mbi të gjitha, pagat e reja janë fryt i punës sonë të përbashkët, i çdo shqiptari dhe shqiptareje, që, si në shtet, ashtu dhe në privat kontribuon për ekonominë shqiptare me punën e vet.

Pritet që deri në vitin 2024 paga mesatare të arrijë majën e saj historike prej 900 eurosh, dhe që kjo të arrihet duhet të vijojë ky intensitet pune, por, nga ana tjetër, duhet që sot ne t'u japim dritën jeshile të tria projektligjeve.

Sot kemi për të miratuar projektligjin për pagat në administratën publike, kemi për të adresuar një plotësim të kuadrit ligjor sa u takon pagave të magjistratëve, që vjen si detyrim nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese në dhjetor të vitit të kaluar, si dhe duhet të miratojmë rregullat për përcaktimin e kompetencave të pagave në Republikën e Shqipërisë.

Të tria këto janë bazat kryesore mbi të cilat është bërë edhe një analizë buxhetore e përballimit të shpenzimeve në kohë të gjatë nga qeveria shqiptare, e mirëmbledhur me objektivitet dhe pa populizëm, por dhe me një logjikë të drejtë financiare, ligjore dhe ekonomike.

Të tria projektligjet janë në përputhje të plotë me parimet kushtetuese, me kuadrin ligjor në Shqipëri, me mundësitë reale të shtetit shqiptar dhe me financat që kemi në dispozicion e që mendohen të konsolidohen në të ardhmen për të përballuar këtë politikë të re të pagave.

Thënë këtë, kolegë të dashur, unë dua të falënderoj dhe të përgëzoj qeverinë shqiptare, ministren e Financave për vizionin e shërbimit ndaj publikut në drejtim të asaj që është më e mira për qytetarin! Kjo ditë do të mbahet mend nga të gjithë qytetarët, dhe unë uroj që të jemi të gjithë pjesë e kësaj reforme të rëndësishme.

Falënderoj kolegët e Komisionit të Ligjeve, që patën dakordësinë për miratimin e një pjese të mirë të kësaj pakete! Gjithashtu, i falënderoj të gjithë kolegët deputetë, të cilët i kanë dhënë rëndësinë e duhur shqyrtimit të këtyre akteve, duke vlerësuar se, nëse jemi deputetë, ky është momenti për të treguar që i shërbejmë interesit publik! Nëse jemi deputetë, ashtu siç e kërkojnë qytetari dhe interesi publik, sot duhet të votojmë njëzëri dhe me unanimitet për të tria projektligjet e paketës për rritjen e pagave.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka zoti Sula.

Të përgatiten zoti Gjyknuri dhe zoti Shehi!

Dashnor Sula – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë jam munduar që gjatë këtyre dy vjetëve në këtë sallë të parlamentit të flas shumë qartë dhe të jem i drejtpërdrejtë.

Përsëri edhe sot, pavarësisht se është një moment shumë i rëndësishëm sa i takon rritjes së pagave të administratës, e cila nuk është normale, me aq sa rritet, po e them që më vjen turp që jam pjesë e këtij parlamenti, për gjuhën që u përdor këtu nga mazhoranca. Kam respekt maksimal për zonjën Bushka, si kryetare komisioni, me të cilën kam dy vjet që punoj, si dhe për zonjën Gjylameti, por ato dolën këtu, folën, bënë politikë, propagandë, sulmuan opozitën dhe nuk u kujtuan të thoshin një fjalë të vetme: a po rriten rrogat për ministrat; a po rritet rroga për Kryeministrin; a po rriten rrogat për deputetët? Jepni argumente zonja Bushka, jepni argumente edhe ju, zonja Gjylameti, edhe ju, deputetë të tjerë të mazhorancës! Unë jam këtu dhe do të jap argumentet e mia.

Nuk jam kundër rritjes së pagave të deputetëve dhe të qeverisë, gjë që do ta them edhe më poshtë, por jam kundër rritjes me shifra kaq të mëdha të pagave.

Unë do ta arsyetoj dhe do ta argumentoj më poshtë se përse administrata dhe shtresat e tjera, mësuesit, mjekët e të tjerë kanë një rritje simbolike. Po e saktësoj këtë duke folur me lekë të vjetër, që qytetarët ta kuptojnë realisht se pagat e zyrtarëve të lartë po rriten brenda ditës në këtë vend.

Pagën e mësuesit e kemi rritur 27 mijë lekë, pagën e një infermieri 26 mijë lekë. A e doni më

thjesht? Mësuesi bën 22 ditë punë dhe i keni rritur 1 mijë e 200 lekë në ditë. A e doni më thjesht? Mësuesi punon 8 orë në ditë dhe i keni rritur 153 lekë të vjetër në orë. E njëjta gjë është edhe për infermierin, pa shkuar te pensionistët, ku shtesa nuk e kalon shumë 5 mijë lekë të vjetër në muaj.

Po ndalem te pozicionet e larta të administratës. Dua të flas vetëm për deputetët dhe ministrat. Këtu në parlament ka deputetë që ia shtojnë vlerën këtij institucioni, që janë shtetarë të vërtetë, si majtas, ashtu dhe djathtas, dhe, të jem i sinqertë, meritojnë edhe më shumë se 3,1 milionë, sa po ua rrisni sot pagën. Ka të tjerë që e turpërojnë këtë institucion, sepse, siç e ka treguar koha, në mëngjes kanë ngritur dorën për të votuar ligje e darka i ka zënë në qelinë e burgut. Ka nga ata deputetë që mbajnë familjen me këtë rrogë, sikundër ka edhe nga ata të cilët, po t'i pyesësh, nuk e dinë sa e kanë rrogën.

Çfarë kemi bërë ne, majtas e djathtas, që brenda ditës të na rritet rroga 1,6 milionë lekë?! Flas vetëm për rrogën, se, po të fus këtu dietat që marrim për karburantin e telefonat, rritja i kalon 2 milionë lekë. A e kemi bërë këtë vend të jetueshëm? Jo, sepse me qindra po ikin përditë. A e kemi luftuar korrupsionin? Jo, sepse në çdo raport vetëm na nxijnë. A kemi votuar për t'u dhënë dinjitet mësuesve, mjekëve, infermierëve apo pensionistëve? Jo, se po u japim lëmshë çdo vit, u japim nga një karamelle dhe ua zëmë në gojë sa herë na jepet mundësia. A kemi ditur të bëjmë ndonjëherë zgjedhje të lira e të ndershme që, të paktën, të krahasohemi me standardet e Kosovës? Jo. Çfarë bëjmë ne?! 10 ditë pas zgjedhjeve mbyllemi në një sallë dhe dyfishojmë rrogat tona. Për mendimin tim, turp më të madh, në aspektin personal, nuk ka!

Që të jem i qartë, mendoj se 1,2 milionë, që merr sot çdo deputet, nuk janë të mjaftueshme (nëse secili prej nesh do të linte sot mandatin dhe do të punonte në profesionin e vet, do të merrte më shumë), por rritja e rrogës sonë me 1,6 milionë lekë brenda ditës, na bën ndër më të urryerit në sytë e njerëzve! Po flas këtu për ata deputetë, të cilët, pas seancës së sotme, do të shkojnë nëpër zona, jo për ata që nuk e dinë se ku e kanë zonën. Nëse qëllimi juaj është që deputetin ta shajnë lart e poshtë, në rrugë, në takime, në televizione apo në rrjete sociale, bravo ju qoftë, se po ia arrini!

Vazhdojmë më tej. Dua të sjell në vëmendjen e gjithsecilit në këtë sallë të

parlamentit, se gjatë 10 vjetëve të qeverisjes kjo mazhorancë nuk i rriti asnjëherë pagat në mënyrë reale, përveç indeksimit, dhe në këtë rast më pak se inflacioni. Kjo neglizhencë u bë me qëllim, dhe qëllimi ishte shpopullimi i Shqipërisë, ku qindra e mijëra nëna jetojnë vetëm. Por ndryshe nga periudha e shpopullimit të vendit, gjatë kohës u hapën kufijtë, u detyruan të largohen nga vendi shtesa e mesme, profesionistët, ata që ishin më herët të stabilizuar në Shqipëri. Çdo shtresë e mesme në Shqipëri, intelektualët, nuk pranojnë që propaganda t'ua shpërlajë trurin, se ata kërkojnë llogari. Në këto vite arritët që qindra e mijëra të emigrojnë. Ju do të pyesni: "Pse po e bëni tani rritjen e pagës?" Përgjigjen do ta jap me disa shifra dhe fakte që i tregojnë qartë arsyet.

E para, në tremujorin e parë të këtij viti importet e produkteve farmaceutike u rritën me 2,248 tonë, një rritje prej 23 për qind në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Plakja e popullsisë i ka rritur kërkesat për trajtimin me medikamente dhe produkte farmaceutike. Pra, në Shqipëri ka mbetur vetëm mosha e tretë që nuk janë të aftë të punojnë dhe të nxitin rritjen e ekonomisë, por kanë nevojë për ilaçe.

Së dyti, numri i nxënësve të regjistruar në shkolla shënon rënie të shpejtë për vitin shkollor 2022-2023, duke reflektuar kështu pakësimin e popullsisë nga emigracioni i lartë. Sot INSTAT-i raportoi se në vitin shkollor 2022-2023 u regjistruan në arsimin zyrtar 554 222 nxënës dhe studentë, me një ulje 4,1 për qind, krahasuar me vitin shkollor 2021-2022. Të dhënat e institucioneve, të cilat paguhën me paratë e taksapaguesve, raportojnë se braktisja e Shqipërisë nga familjet e reja, ato që janë edhe forca më vitale për punë, është aq e madhe, sa krijon një gropë edhe në sistemin arsimor.

Së treti, çfarë shkaktojnë këta dy faktorë që përmenda më sipër? Përgjigjja është kjo: importet e produkteve të tjera ushqimore kanë pësuar një tkurrje të shpejtë në katërmujorin e parë të vitit, një trend rënës, i cili ka nisur që në vitin e kaluar. Sipas të dhënave të fundit të INSTAT-it, që i përkasin periudhës janar-prill të vitit 2023, importet e ushqimeve në sasi pësuan rënie me 11 për qind. Rënia e importit të ushqimeve, në një kohë kur prodhimi vendas mbetet i njëjtë apo edhe në rënie për disa artikuj, po zbulon trendin negativ të emigracionit. E gjithë kjo do të thotë më pak para për konsum dhe më pak para për oligarkët.

Konkluzioni i fundit që ka alarmuar edhe qeverinë: pasi koncesionet publike mbaruan dhe pasi çdo pasuri kombëtare u privatizua, tani oligarkët “i kanë zënë derën” qeverisë, duke iu ankuar se nuk po u ecën biznesi dhe se nuk kanë klientë që shpenzojnë para. Qeveria, në fakt, po përbush dëshirën e oligarkëve dhe jo të administratës, sepse, po të ishte për qytetarët, rritja dhe dyfishimi i pagës do të ishte bërë vit pas viti, gjë që do ta kishte frenuar ikjen e qindra mijëra shqiptarëve, të cilët mund të punonin dhe të konsumonin më shumë.

Siç e thashë në krye të herës, rritja e pagës për administratën është e vonuar, ndaj mendoj se duhet ta miratojmë një orë e më parë dhe pa bërë diferencime. Besoj se paga e çdo punonjësi, që shërben në administratën publike, duhet të rritet në të njëjtën masë që do t’u rritet ligjvënësve.

Në këtë sallë apo kudo mund të pretendohet se kjo që unë po them sot, mund të jetë një populizëm, por nuk është kështu.

Të nderuar kolegë, u them edhe të gjithë qytetarëve shqiptarë, se kam marrë vendimin, që shtesa e pagës që përfitoj nga rritja, si deputet i Parlamentit të Shqipërisë, deri në fund të mandatit tim do të shkojë për Shoqatën e Jetimëve në qytetin e Peqinit. Ky është një premtim dhe i ftoj të gjithë gazetarët e të gjitha mediave që të monitorojnë tërheqjen e pagës nga banka, të cilën unë e marr si deputet, dhe dërgimin e parave te Shoqata e Jetimëve në qytetin e Peqinit.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sula!

Fjalën e ka kërkuar Kryeministri.

Edi Rama – Në radhë të parë, jam shumë i impresionuar nga kuraja e parafolësve për ta adresuar parlamentin në emër të shqiptarëve. Në emër të shqiptarëve flasim shqiptarët dhe ata, të cilët shqiptarët i mandatojnë për të folur, por, kur shqiptarët sapo kanë folur (nuk është bërë akoma java e dytë), dhe kanë folur aq qartë, sa natyrisht e kanë tronditur një pjesë të atyre që fatkeqësisht janë ata që nuk duan të dëgjojnë, është shumë komike që të flitet në emër të shqiptarëve. Flitet në emër të shqiptarëve që braktisën politikën, që braktisën zgjedhjet apo në emër të të rinjve që ishin të paktë në votime, por pasqyra e pjesëmarrjes flet pak më ndryshe.

Shqiptarët nuk na kanë braktisur të gjithë ne, shqiptarët kanë braktisur një pjesë nga ne. Për sa i takon pjesës që së bashku me të gjithë deputetët

në krahun e majtë që unë përfaqësoj, shqiptarët jo vetëm që nuk na kanë braktisur, por na kanë mbështetur më shumë se asnjëherë më parë.

Kjo bëhet edhe më e rëndësishme, po të kemi parasysh se ky nuk është një fenomen karakteristik i zgjedhjeve vendore. Në zgjedhjet vendore dihet botërisht (për të gjithë ata që ndjekin historikun e tyre dhe historikun e shifrave), që partitë e mëdha bien te vota për subjektin politik dhe partitë e tjera rriten te vota për subjektin politik, si rezultat i një numri shumë të madh kandidatësh për këshilla dhe si një rezultat i një vote, e cila, nëse shkon në komunitete më të vogla, është e lidhur me personin. Ja që këtë herë ka ndodhur ndryshe, prandaj braktisësit e të gjitha moshave, përfshirë edhe të rinjtë, kërkojnë në radhë të parë te mënyra sesi e kuptoni këtë botë, te mënyra sesi e lexoni Shqipërinë, te mënyra sesi e interpretoni situatën në Shqipëri dhe te mënyra sesi flisni për Shqipërinë dhe shqiptarët. Kjo është një këshillë e pakërkuar, të cilën unë jua kam dhënë që në seancën e parë të Kuvendit të mandatit tonë të parë, kur paraqita programin tonë për herë të parë, dhe fjalëmarrësi i parë pas fjalës sime kërkoi dorëheqjen e qeverisë që atëherë. Kështu që, për sa na takon, ne do të vazhdojmë vetëm përpara.

Sot jam shumë i lehtësuar, për hir të së vërtetës, sepse vijmë për të kaluar një projekt, të cilin kemi dashur ta kalojmë vite më parë dhe për të cilin kemi luftuar çdo ditë të këtyre viteve. E kemi marrë këtë vend, kur tabela e klasifikimit ishte si vijon: 259 euro paga mesatare, ndërkohë që Kosova e kishte 444 euro, Maqedonia e Veriut e kishte 504 euro, Serbia e kishte 537 euro dhe Mali i Zi e kishte 726 euro. Kemi qenë jo thjesht të fundit, por të fundit me diferencë. Sot tabela është si vijon: Kosova 504 euro, Maqedonia e Veriut 705 euro, Serbia 763 euro, Bosnje-Hercegovina 890 euro, Mali i Zi 792 euro dhe me votimin e sotëm ne i hapim rrugë një procesi që në harkun e këtij viti që vjen, pra në prillin e ardhshëm, na çon në 900 euro pagë mesatare. Sigurisht, edhe të tjerat do të rriten në raport me këtë, por, sipas të gjitha gjasave, me këtë parashikim ne ngjitemi në nivelin e lartë të rajonit. Kjo është ajo që po bëjmë ne sot. Të tjerat janë “dokrra hini” kur thoshte At Gjergj Fishta, të njëjtat dokrra që kemi dëgjuar qyshkur kemi filluar punën dhe qyshkur i kemi filluar këto përpjekje.

Pse nuk e kemi bërë më parë dhe pse sot nuk jemi në të njëjtin nivel me rajonin? Për një arsye shumë të thjeshtë, sepse neve na është dashur të përballemi me situata dramatike, të cilat rajoni nuk i ka pasur. Tërmeti ka rënë në Shqipëri, nuk ka rënë në rajon. Mjafton të shihet se sa të ardhura kemi spostuar ne për të sistemuar në shtëpi dhjetëra mijëra familje, për të kuptuar se pse kjo nuk u bë kur u krijuan mundësitë që të bëhej. Pastaj erdhi pandemia, pastaj erdhi agresioni i luftës. Dhe po ju kujtoj të gjithëve atyre që na ndjekin se sot në faturë e energjisë elektrike për të gjitha familjet dhe për biznesin e vogël, por edhe për pjesën dërrmuese të biznesit vazhdon të jetë dora e qeverisë. Ajo që paguajnë familjet, nuk është vlera reale e faturës. Familjet shqiptare dhe biznesi i vogël paguajnë ekzaktësisht sa paguanin me çmimin përpara krizës. Ka rënë çmimi i energjisë në tregun ndërkombëtar, por nuk është kthyer aty ku ishte. Qeveria ka pasur dhe ka vullnetin e plotë të vazhdojë të paguajë, ndërkohë që me ardhjen e verës konsumi do të rritet në mënyrë të ndjeshme përsëri dhe ne do të duhet të rihapim diskutimin e fashës, por sot për sot jemi në këto kushte që vazhdojmë të paguajmë dhe është një sasi e madhe parash.

Prandaj, nëse këtu do të kishim të bënim me një ekonomi lënguese, nëse këtu do të kishim të bënim me një pasqyrë, si ajo që na vihet përpara sa herë që ka një seancë parlamenti, ku merret një shifër këtu e një shifër atje, si ajo përralla e asaj species që donte të zbukurohej dhe mori nga të gjitha kafshët nga një gjë dhe pastaj doli një monstër, atëherë sigurisht që kjo rritje pagash nuk mund të bëhet. Por e vërteta është e thjeshtë fare: ekonomia është rritur, ndryshe nga çfarë është thënë këtu dhe ndryshe nga çfarë parashikonin ata, të cilët, thashë, jetojnë me pasqyra të tilla; papunësia është nën nivelet e para pandemisë; konsumi është rritur (pra, ajo përvojatja lënguese këtu se njerëzit nuk po blejnë dot, nuk provohet në shifrën e konsumit, se konsumi është rritur); eksportet janë rritur. Të gjitha këto nuk janë opinione, nuk janë as shifra të nxjerra nga mënga sipas qejfit. Këto janë shifra të thjeshta që i gjen në çdo raport dhe i gjen në çdo tabelë. Kështu që është e kotë fare që sot të bëjmë debat “e lagu apo nuk e lagu”, përballë faktit kuptimplotë që kjo shumicë qeverisëse po bën rritjen më të lartë historike të pagave dhe po bën kapërcimin e madh të shumëpëritur, të shumëdëshiruar, për të cilin

jemi përpjekur, kemi këmbëngulur, kemi duruar jashtëzakonisht shumë përballë situatave të papritura, befasive dhe fatkeqësive që nuk i kemi sjellë ne, por na kanë zgjedhur ne.

Shqipëria me pagë mesatare 900 euro është një Shqipëri tjetër. E thjeshtë fare! Këtë Shqipërinë tjetër kemi çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, çdo vit që e ndërtojmë, një Shqipëri tjetër, e cila sot pa asnjë shtysë, pa asnjë qindarkë të paguar është rregullisht çdo javë në faqet e mediave më prestigjioze ndërkombëtare si destinacioni për t'u zbuluar dhe për t'u vizituar. Merrni shikoni vetëm shifrat e aeroportit të Rinasit se çfarë ndodh në aeroportin e Rinasit për të kuptuar se çfarë Shqipërie është kjo sot, në krahasim me Shqipërinë dje. Dhe të gjithë ata që vijnë në aeroportin e Rinasit, janë konsumatorë, nuk vijnë me bukë me vete. Janë konsumatorë, janë eksporti më i madh i Shqipërisë dhe turizmi është eksport.

Në këtë Shqipëri është koha që pagat të zënë vendin që meritojnë njerëzit në këtë fazë. Nuk jemi të kënaqur, nuk mbaron këtu, por këtu ndalojmë një moment për të vlerësuar faktin. Dëgjoj që pagat në sektorin privat nuk i rrit shteti. Kjo është e vërtetë, por ama janë dy gjëra që ne i kemi bërë dhe është një gjë që po ndodh. Gjëja që kemi bërë, duke shtyrë pagën minimale, sigurisht që është një faktor i pamohueshëm dhe gjëja që ne po bëjmë duke rritur pagat në sektorin publik, patjetër që është një tjetër faktor i pamohueshëm dhe të dy këta faktorë bëjnë që pagat në sektorin privat të jenë në rritje të përditshme, por që t'i shohësh, duhet t'i kërkosh; që t'i kërkosh, duhet të duash t'i kërkosh dhe nuk mund të duash t'i kërkosh, në qoftë se kërkon t'i bësh shqiptarët të shohin diçka që ti dëshiron ta shohin siç e sheh ti.

Nuk ka pasur përgjigje më spektakolare nga shqiptarët sesa ajo e 14 majit, për të gjithë, për të gjithë, për të gjithë. Spektakolare. Por, mbi të gjitha, që të jemi shumë të qartë, më shumë sesa fitorja jonë, ajo është disfata absolute e politikës që përballtet nga të gjithë ju që vini këtu dhe këndon dokrrat tuaja. Ajo është më absolutja. Po e morët vesh, merreni! Po nuk e morët vesh, faleminderit shumë, se herën tjetër do të jetë edhe më keq për ju, jo për Shqipërinë, jo për shqiptarët!

Tani, për sa i përket hyrjes te pagat një pas një, nuk diskutohet që ne sot jemi në kushtet kur duhet të kuptojmë, dhe duhet ta kuptojmë të gjithë, jo vetëm qeveria, se Europa ka filluar një

luftë, e cila do të bëhet çdo ditë më e pamëshirshme, që të kujton atë shprehjen “Peshku i madh do të hajë të voglin, me çdo çmim, dhe robi do të jetë ujë për robin”. Shtetet do të jenë ujçer për shtetet, sepse demografia e Europës është në kushtet që po i afrohet një tragjedie të këtij kontinenti.

Rënia eksponenciale e lindjeve në vendet më të zhvilluara të Europës ka ardhur sot në pikën ku po reflektohet në tregun e punës dhe ku vendet më të zhvilluara janë në situatën që ose duhet të rrëmbejnë nga të katërta anët, ku të munden, krah pune për të kompensuar boshllëkun, ose duhet të pranojnë perëndimin e suksesit dhe fillimin e falimentimit të tyre, që nga Gjermania, lokomotiva e Europës dhe superfuqia e kontinentit, e cila deri në vitin 2030 ka nevojë për 7 milionë punëtorë jashtë sistemit të demografisë gjermane, pra 7 milionë duhet t'i vijjnë me çdo kusht nga jashtë dhe, kur them “punëtorë”, në të gjitha, në të gjitha, jo thjesht në një lloj pune. Dhe ligji që ka kaluar Gjermania para pak javësh duhet të ngulet në kokën e të gjithë atyre që merren me politikën dhe me politikëbërjen në Shqipëri, pasi është një ligj që hap dyert e Gjermanisë për krah pune nën 35 vjeç, të pakualifikuar. Kurrë më parë një shtet nuk ka bërë një ligj për punonjës të pakualifikuar, por gjithmonë prirja ka qenë për kualifikime dhe specifike në këtë sektor, në këtë sektor, në këtë sektor.

Nëse kthehem pak mbrapa, kur ka filluar kjo situatë, do të shikojmë që fillimisht ishin ata që kishin njohuritë digjitale, pastaj filloi të zgjerohej me ata që kishin njohuri profesionale të nivelit teknik. Sot është hapur totalisht dhe kjo do të jetë tendenca e përditshme në Europën ku jetojmë. Përpjekja jonë është një përpjekje titanike, që duhet ta bëjmë për ta përballuar këtë situatë.

Kënga “Po ikin, po ikin, po ikin” është turpi më i madh i kujtdo që e këndon nga pozitat e politikëbërësit. Nuk ka një motiv më të turpshëm sesa ky për ata që janë politikëbërës.

E para, sepse kjo nuk është fare një arsye për luftëra të brendshme, ashtu siç kjo nuk është një çështje që mund të zgjidhet më mirë nga njëra palë apo nga pala tjetër. Kjo nuk ka lidhje fare me asnjërin nga palët. Ky është impakti dramatik i produkteve të globalizmit, të cilat arrijnë sot të penetrojnë deri në fshatin më të largët dhe në

zonën më të thellë, kudo ku ka një pasqyrë *Iphone*-i. Në momentin kur ata penetrojnë aty, t'u kërkosh ose të pretendosh që ai njeriu atje të presë zhvillimin gradual, ndërkohë, që 1 orë e gjysmë, 2 orë apo 3 orë larg ka atë gjënë që sheh atje, është krejtësisht e palogjikshme, përveçse është edhe qesharake.

Qasja duhet të jetë krejt tjetër dhe jam i bindur se me qasjen tonë gjërat do të shkojnë në drejtimin e duhur në aspektin e një balancimi, jo të ndalimit të kësaj gjëje. Këtë gjë nuk e ka ndaluar askush.

Veneto është rajoni më i pasur i Italisë dhe guvernatori i Venetos problem më të madh ka largimin e mjekëve nga Veneto për në Gjermani e për në vendet e Veriut. Veneto! Mjekët dhe infermierët janë problemi më i madh i Italisë fqinje sot, ndërkohë që ne, po ju them (dhe këtë gjë e tregojnë shifrat), kemi largime, por nuk kemi ende asnjë boshllëk dhe me politikën që po ndjekim tani, plus me politikën tjetër, që është përtej kësaj të pagave nominale për të gjithë, me politikën e pagave të diferencuara, me kontratat e përkohshme në bazë të aftësive, këtu do të jemi dhe do ta shikojmë shpejt rezultatit. Madje do të shikojmë që jo vetëm largimet do t'i kemi tërësisht të balancuara, se largimet janë edhe për arsye studimesh, janë edhe për arsye që nuk lidhen vetëm me faktin që po shkojnë të punojnë atje, ndërkohë që nuk do të kemi asnjë boshllëk, përkundrazi, do të arrijmë të angazhojmë edhe mjekët jashtë vendit për të punuar brenda vendit, pa pasur nevojë të vijnë të jetojnë këtu në këtë vend.

Nuk po hyj tek të gjitha ato që u thanë dhe do të thuhet për pagat nominale, por po kthehem pak te kjo e pagave të deputetëve dhe ministrave, sepse është, nga njëra anë, shumë hipokrizi e madhe çfarë dëgjova më parë, një hipokrizi për të vënë duart në kokë, pasi nivelet e pagave nuk përcaktohen sipas qejfit. Nivelet e pagave përcaktohen me një logjikë, që është ajo e një ekspertize të caktuar, dhe ka një piramidë pagash. Këto të gjitha po jua them si dikush që i ka mësuar, madje jua kam thënë që, kur unë flas, them gjëra që i mësoj shumë mirë për fushën që unë nuk njoh.

Kjo do të thotë se nuk mund të ndërtohet një piramidë pagash dhe ta vendosësh Presidentin e Republikës nën një mësues, pavarësisht se puna e përditshme e një mësuesi mund të jetë më me stres

sesa puna e përditshme e Presidentit të Republikës.

Kemi bërë ne një lajthitje, që e kemi bërë me vetëdije, madje e kemi tepruar në lajthitjen tonë me sistemin e drejtësisë, por ajo është bërë tashmë dhe nuk zhbëhet. Është lajthitje, sepse nuk mund të kemi prokurorë që paguhen më shumë sesa Presidenti. Thjesht nuk mund t'i kemi. Mund ta kenë punën shumë më me stres sesa Presidenti, por nuk mund t'i kemi.

Nuk mund të kemi gjykatës që paguhen më shumë sesa ministri i Drejtësisë. Ata mund ta kenë punën shumë më me stres sesa ministri i Drejtësisë, por nuk mund t'i kemi, se nuk ka kështu.

Doni ju të bëni këtë qarjen e halleve? Nuk ka nevojë që shtesën e pagës t'ua çoni jetimoreve. Hajdeni, vendosni pagën minimale këtu për deputetët! Deputetët të paguhen me pagë minimale. Gati jam! Edhe ministrat! Hajdeni!

(Diskutime në sallë)

E, pra, në qoftë se doni t'i shkojmë deri në fund logjikës që të gjithë janë në punëra dhe në halle, që janë më të mëdha sesa puna dhe hallet tuaja, atëherë çfarë stresi më të madh keni ju...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

...sesa ata që shkojnë punojnë në fasoneri? Hajdeni të vendosim!

Unë mendoj se nuk i hyhet këtij monopati për të marrë nëpër këmbë dhe për t'u tallur me ata që na ndjekin. Ama, prapë ju nuk e mësoni që kush i merr shqiptarët për budallenj, kush i merr për kollaj, mund të gënjejë disa për njëfarë kohe, ajo fara e kohës mund të shkojë edhe 30 vjet, por vjen një ditë, siç erdhi në Shkodër, dhe pastaj firojnë ata.

Nëse do ta vazhdoni këtë, dhe shpresoj ta vazhdoni, sepse unë nuk hyj tek ata që mendojnë se pluralizmi dhe demokracia po kërcënohen se ju po ikni "për pambuk", unë mendoj se ju duhet të ikni "për pambuk", në qoftë se ne duam të kemi një skemë politike, ashtu siç e meritojnë shqiptarët, sepse ju e keni treguar që nuk e bëni dot.

Dhe meqë doni të hyni këtu, urdhëroni pagën minimale, dhe sa herë rritet paga minimale, rritet automatikisht edhe rroga e deputetëve. Unë jam shumë dakord, nuk kam asnjë problem, ndërkohë që pozicioni im ka qenë dhe mbetet, sot që flasim, që pagat duhet të jenë siç janë në piramidën e propozuar dhe siç i ka e gjithë bota.

Krahasohemi këtu me rajonin, se ne nuk mund të krahasohemi me Gjermaninë, në rajon janë po kështu. Nuk kam parë asnjë vend të rajonit që pagat e deputetëve t'i ketë sa pagat e mësuesve apo të mjekëve, nuk kam parë asnjë vend të Europës, nuk kam parë askund!

Dhe ideja që deputetët mblidhen kot dhe janë kot, e ka bazën tek e gjithë pabesia historike që ish-Partia Demokratike i ka bërë politikës me gjithë atë llum, me gjithë ato akuza, me gjithë ato shpifje, me gjithë ato maskarallëqe, me gjithë atë transformim të gjuhës nga gjuha normale e prindërve, e njerëzve me shkollë, e intelektualëve, e akademikëve, që ju të gjithë jeni në jetën normale, në një gjuhë që nuk ka asnjë lidhje me asgjë që ju doni që fëmijët tuaj të mësojnë. Kurrë! Askush nga ju nuk ia pranon një fjali, nga mijëra fjalime tuajat këtu, ta nxjerrë nga goja fëmija në shtëpi. Dhe pse? Sepse keni atë që, kjo është politika. Jo, politika nuk është kjo. Politikë nuk është kjo, fare. Politikë është ajo që bëjmë ne. Si e bëjmë ne, ashtu është politika. Këtë që keni mbjellë për 30 vjet, nuk mund ta korrni dot ju, duke thënë: "Do t'ia jap pagën time jetimore". Çfarë do t'i japësh, shtesën e pagës jetimore?! Çfarë janë këto? Piramida e pagave duhet të jetë ekzaktësisht siç është propozuar, sepse ka logjikën e vet.

Dhe për mua, unë njoh, për fat të mirë, nuk vij nga Hëna, këtu në këtë grup, njerëz që e meritojnë atë pagë dhe e meritojnë atë pagë me respekt, jo thjesht e meritojnë. E meritojnë me respekt dhe nuk janë një e dy, po jua them unë. Mund të mos jenë të gjithë, por nuk janë një e dy. Janë njerëz që me atë pagë jetojnë. Se ky nuk është vendi i kriminelëve, ky nuk është vendi i drogaxhinjve, ky nuk është vendi i narkotrafikantëve, ky nuk është vendi i hajdutëve. Ky është një vend ku mund të ketë, me siguri, edhe ndonjë që nuk duhet të jetë këtu fare, por duhej të ishte me kohë, në fakt, prapa diellit. Por ky nuk është vendi i llumit. Ky është një vend njerëzish normalë, të cilët kanë ardhur këtu për një mijë arsye, dhe këtu fus edhe të gjithë pjesën tuaj më të madhe.

Fakti që këtu pastaj shpërfytyrohemi, çmendeni dhe ktheheni në bisha, që doni të hani mish njeriu, nuk ka lidhje me të vërtetën. E vërteta është që deputetët, për misionin që kanë, për punën që u kërkohet dhe për çfarë duhet të bëjnë

për të gjithë ata që i zgjedhin, meritojnë pagën e propozuar. Kjo nuk diskutohet.

Sa e bëjnë punën, sa e përmbushin misionin, sa, sa, sa? Këto nuk lidhen me si vihet paga. Ama, unë në një gjë jam kundër, po jua them edhe sot, se nuk e votoj këtë pikë. Bëni çfarë të doni, por unë vetë nuk e votoj. Për mua paga duhet të vendoset sot dhe duhet të hyjë në fuqi ditën kur do të bëhet rritja e pagës deri te më i fundit. Pra, nëse mësuesve dhe mjekëve të përgjithshëm, dhe shumë të tjerëve u themi: “Sot ju do të merrni këtë rritje dhe rritjen tjetër do ta merrni në harkun e vitit, dhe paga juaj do të jetë e plotë, e rritur”, dhe ne do të kemi mesataren 900 euro në Shqipëri në mes të vitit të ardhshëm, atëherë për deputetët dhe për ministrat paga duhet të hyjë në fuqi dhe duhet të shkojë në llogaritë e secilit vetëm kur të jetë bërë për të gjithë. Ky është qëndrimi im. Përpara kësaj, unë mendoj se është e pamoralshme. Këtu po, unë jam shumë dakord, për solidaritet dhe për atë që kush merr më shumë, duhet të bëjë më shumë. Ky është principi ynë.

Unë e kam bërë debatin e parë, që të jemi shumë të qartë, që s’duhet të jetë piramidë, por e mësova, se njeriu mëson, kur nuk do të flasë përçart, që kjo nuk është e mundur, është e palogjikshme. Ashtu sikundër ne nuk mund të bëjmë një gjë të pakuptimtë që disave ashtu, disave kështu, me erna, se me demokraci po...

Jo, more, jo, nuk mendohet. Gjëja e parë që ju duhet të bëni për popullin, është që kur të vini të flisni këtu të respektoni nervat e popullit, të respektoni faktin që populli përprijet çdo ditë të rrisë dhe të edukojë fëmijë, të respektoni faktin që populli nuk duhet të mbyllë televizorin ose nuk duhet t’i gjuajë televizorit me shishe apo me gotën që ka përpara, kur dilni ju në ekran, ose pastaj, kur për efekt të përgjigjes dalim edhe ne, dhe “kush fle me qentë, gdhihet me pleshta”. Kjo është gjëja që ju mund të bëni për popullin. Dhe të jeni të sigurt se kjo do ta rrisë ekonominë e Shqipërisë edhe 1% më shumë, atmosfera. Ashtu sikundër, s’jam unë që duhet t’jua them, të jeni të sigurt se kjo gjë do t’ju rrisë ndonjë përqindje më shumë edhe kur të shkoni në zgjedhje. Se jua kam thënë edhe më përpara, janë të regjistruara, unë nuk kisha parashikuar vetëm momentin, por e bëtë më shpejt se ç’e prisja. Unë e prisja nga e marta në darkë, ju e bëtë që të dielën në darkë, kur patë se si Kamza jua ktheu kurrizin në mënyrën më spektakolare. Por nëse do të doni të dini se pse jua

ktheu kurrizin Kamza, mos shkoni të kërkoni fantazma, shkoni në Kamëz! Shkoni në Kamëz dhe merrini me radhë çerdhet, kopshtet, shkollat! Shkoni në Kamëz dhe shikoni gjithë politikën e bashkisë! Shkoni në Kamëz dhe merrini me radhë të gjithë familjet, të cilave iu prishën shtëpitë nga tërmeti, shkoni shikoni ku jetojnë sot! Shkoni në Kamëz dhe pyesni ata të unazës, pse 130 e ca familje në Kamëz nuk bënë asnjë protestë, nuk dolën asgjëkund, por u ulën me kryetarin e bashkisë, firmosën marrëveshjen menjëherë dhe liruan trasenë? Për një arsye shumë të thjeshtë, sepse ata e dinë shumë mirë se ai njeriu që kanë atje, fle i fundit, zgjohet i pari dhe çfarë thotë e bën. Ata e dinë shumë mirë se ajo që kanë firmosur atje, është fiks ajo që do marrin, shtëpinë e re. Por kur t’i shihni këto, do ta kuptoni pse Kamza ju bëri atë që e keni merituar prej kohësh, por jua bëri tamam në momentin e duhur, për hir të së vërtetës.

Hajdeni me mua në Tropojë të shihni pse Tropoja jua ktheu kurrizin, se do të shkoj në Tropojë! Hajdeni shihni, t’ju them se ku të shkoni dhe çfarë të shikoni, dhe kështu tek të gjitha me radhë! Unë e përsëris: rezultati ynë është sa vepër jona, aq edhe vepra juaj. Unë jam i vetëdijshëm. Jeni bashkëpunëtorët më të mëdhenj në këtë rezultat, sepse jeni bërë aq të pashikueshëm, aq të padëgjueshëm, aq të pangrënshëm, aq të patretshëm, sa detyrimisht një pjesë erdhën na votuan ne, një pjesë tjetër ndenjën në shtëpi dhe bënë gjënë e duhur. Dhe këta që erdhën, që nuk e di si i numëroni 500 mijë a 600 mijë, janë nja 250 mijë dhe plus ca të tjerë që janë akoma duke kërkuar autobusin e unazës, herën tjetër do të jenë më pak. Mbajeni mend fjalën time këtu: herën tjetër do të jenë më pak! Nuk ju shpëton dot asnjë fjalim këtu, asnjë baltë që hidhni këtu dhe asnjë përvuajtje këtu kur thoni: “Shtesën e pagës unë do t’ia çoj jetimores”. Vdeksha unë! Vdeksha unë për ty, që do t’ia çosh shtesën e pagës jetimores ti! Vdeksha unë për ty, jetimi im i dashur!

Kështu që, ky është qëndrimi im. Unë për rritjen e pagave jam shumë krenar.

Dhe dua t’i falënderoj nga zemra të gjithë deputetët, sepse është puna e deputetëve, në radhë të parë, e gjithë këtyre viteve, sepse është rezultat reformash, është rezultat ligjesh, është rezultat përpjekjesh.

Dua të falënderoj të gjithë anëtarët e kabinetit që kanë punuar nga dita e parë e vitit

2013 dhe deri më sot, sepse ky është rezultat i përpjekjeve shumë të mëdha. Dua t'ju them se te pika e pagës për deputetët dhe për ministrat, mua më keni kundër që të hyjë në fuqi menjëherë. Ajo duhet të hyjë në fuqi në momentin kur hyn në fuqi e gjithë paketa e rritjes së pagave, por unë një jam, bashkë me Erion Braçen, pastaj kush bëhet tjetër, të shohim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Kryeministër!

Sipas nenit 47, paragrafëve 1, 2, 3 të Rregullores, fjalën e ka kryetari i grupit më të madh të opozitës, zoti Bardhi.

I lutem teknikës të ristartojë të njëjtën kohë diskutimi, sa ishte edhe për Kryeministrin.

Gazment Bardhi - Bëni mirë që ikni, zoti Kryeministër!

Fole këtu 35 minuta, shpjegove rezultatin historik të Partisë Socialiste, siç e quajtet ju, shpjegove rezultatin e opozitës, por nuk na shpjegove rezultatin e aleatit tënd *non grata*, Tom Doshi, sepse, në fakt, konkluzioni më domethënës i zgjedhjeve të 14 majit është rezultati i aleatit politik të Edi Ramës në të gjithë Shqipërinë, i aleatit *non grata* të Edi Ramës të Partisë Socialdemokrate, Tom Doshit. Në fakt, ai është thelbi i pushtetit të Edi Ramës.

Ermonela Felaj – Ju lutem, kolegë!

Kolege, mos flisni nga vendi!

Respektojeni njësoj seancën edhe kur paraqiteni, edhe kur flisni, edhe kur largoheni! Dakord?

Zonja Aça, me ju e kam të parën.

Po, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi - Një këmbë të pushtetit në Durrës ia ka garantuar Vangjush Dako i damkosur *non grata*, për të cilin ai hesht dhe nuk flet. Një këmbë të pushtetit të tij në Shkodër ia ka garantuar Tom Doshi *non grata*, për të cilin ai nuk flet, ndërkohë vjen këtu dhe në vend që të japë llogari për masakrën që bëri në 14 maj, në 35 minuta nga 36 që foli, Kryeministri u mor me opozitën. Në fakt, duhej të vinte këtu dhe të jepte shpjegime pse në 10 vjet nuk ka sjellë në Kuvend asnjë projektligj për rritje pagash edhe pse çmimet janë dyfishuar. Foli këtu për votë pro, për votë kundër, për moral e me radhë. Jo, zoti Kryeministër, nuk ka asgjë të pamoralshme as të rrisësh rrogat e administratës, as të rrisësh rrogat e deputetëve, as të rrisësh rrogat e ministrave. E

pamoralshme dhe e paligjshme është të vjedhësh me tenderë, të jesh i korruptuar apo të drekosh dhe të darkosh me kriminelë, siç bën ti nga mëngjesi deri në darkë, meqenëse na fole: “Me qen që fle dhe me pleshta që gdhihesh”. Po të marrim me kë rri ti dhe me kë shoqërohesh ti, i bie të jesh pjesë e llumit të shoqërisë.

Për t'u kthyer te pika e rendit të ditës, nuk ka asnjë dyshim që vota e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për këtë projektligj do të jetë pro, sepse jetesa është vështirësuar për çdo punonjës të administratës publike nga rritja e çmimeve, veçanërisht vitet e fundit. Por, për fat të keq, ky vendim sot është jo vetëm i vonuar, por dhe i pastudiuar. Pse është i vonuar? Sepse emigracioni ka goditur rëndë ekonominë, ka goditur besoj edhe administratën publike. Janë larguar burra e gra të të gjitha shtresave dhe të të gjitha moshave. Vini re statistikat. Këta 10 vjetët e fundit, gjithmonë largohen akoma më shumë njerëz pas çdo palë zgjedhesh që janë gjithmonë e më të këqija, të mbartura në tavolinë, pa nisur gara. 42 mijë shqiptarë u larguan pas zgjedhjeve të vitit 2021. 180 mijë të tjerë janë larguar fill pas zgjedhjeve të vitit 2017. Është e vërtetë që mund të jenë kthyer disa qindra, por janë shumë më pak se ata që ikin.

Pse është vonë? Sepse në 10 vjet kjo qeveri refuzoi të bëjë një rritje reale pagash, me përjashtim ndoshta të vitit zgjedhor 2017, vetëm për pak kategori. Në 10 buxhete që ky Kryeministër ka sjellë në parlament, ju si mazhorancë keni refuzuar çdo propozim të Partisë Demokratike për rritje pagash. Ju gënjeni kur thoni se gjetët një grope financiare dhe se ju duhej kohë. Sot, do të shpenzoni gati 350 milionë euro për rritjen e pagave, por vetëm për pllakat e “Rilindjes urbane” keni shpenzuar plot 400 milionë euro. Pra, para kishit, por jo për të rritur mirëqenien dhe konsumin e qytetarëve. 11 vjet të humbura pa asnjë rritje page.

Pse është i pastudiuar?

Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Kthejeni memorien vetëm 6 muaj më parë në këtë parlament. Kur këtu në parlament po diskutonim buxhetin, as Edi Rama, as ministrat, as deputetët e tij nuk folën asnjëherë për rritje rrogash në këtë nivel. Numëroi me pikatore disa para për 2-3 kategori dhe refuzoi kërkesën e pedagogëve për rritje normale të pagave me

justifikimin se nuk ka para dhe se ky ishte buxheti i luftës, i luftës që bëhej në Ukrainë, i inflacionit të lartë, i çmimeve të larta, i krizës energjetike që nuk ndodhi kurrë. Por për 3 muaj këto u harruan dhe tani del që ne paskemi para për rritjen e pagave. Gati 7% deri 8% e buxhetit të shtetit do të shkojë për rritje pagash dhe sot akoma nuk e dimë se cili është burimi i këtyre të ardhurave.

Po çfarë ndodhi në 3 muaj? Zbuluam puse naftë? Zbuluam miniera ari? Asgjë nga këto nuk ndodhi. Zbuluam se kemi një qeveri e cila i përdor paratë e taksapaguesve shqiptarë vetëm sipas nevojave elektorale. Nuk ka asnjë rast në botë, të asnjë qeverie demokratike, që të marrë një vendim të tillë pa e konsultuar atë me shumë kujdes, me shumë faktorë, duke marrë edhe më shumë kohë. Rritja e pagave nuk është kurrë surprizë, nuk mbahet kurrë sekret nga qeveria dhe askush nga kolegët europianë dhe perëndimorë të Kryeministrit Edi Ramës, nuk sillet si prestigjator duke nxjerrë nga kapela dhuratën e rritjes së pagave vetëm disa ditë përpara zgjedhjeve.

Do të ketë rritje taksash për financimin e kësaj rritjeje? Qeveria hesht. Askush nuk thotë asgjë. Por mos vini bast, Edi Rama ndryshe thotë dhe ndryshe bën!

Do të ketë ulje të informalitetit? As mos e prisni një gjë të tillë. Tatimet, do të mbledhin më shumë para? Deri tani nuk ka asnjë përmirësim domethënës, që të mbështesë këtë tezë, për të mos thënë se mbledhja e të ardhurave është përkeqësuar.

Do të ketë më pak kontrabandë në dogana? Larg qoftë që Edi Rama të prekë anijet e kontrabandës të karburanteve të oligarkëve, me të cilët ndan pasuritë e vendit.

Do të ketë ulje të korrupsionit nga tenderët fiktivë dhe me fitues të paracaktuar? Mos e dhëntë Zoti as këtë për këtë qeveri, sepse partia në pushtet dhe aleatët e saj *non grata* nga Shkodra në Durrës, do të mbeteshin pa financimet e tyre të pista për fushatën e ardhshme elektorale.

Sot është dita që Edi Rama të flasë dhe të thotë ku do të gjenden paratë për rritjen e pagave. Do të ketë rritje taksash, apo do të ketë shkurtime të investimeve? Do të marrë më shumë para borxh për të financuar këtë lëvizje të drejtë, por të vonuar, të papritur dhe të pastudiuar?

Kam vënë re se gjatë kësaj periudhe që Kryeministri ka marrë përsipër të luajë rolin e shpëtimtarit, të bamirësit dhe të zemërmadhit, e

shtron çështjen e rritjes së pagave si një bamirësi që po bën me paratë e veta. Në fakt, janë paratë tona, nga taksat që paguan çdo qytetar, nga të cilat nuk marrin mbrapsht asnjë shërbim të saktë.

Ka një thënie të famshme që na kujton gjithnjë se nuk është qeveria ajo që paguan pagat, është konsumatori ai që i paguan pagat, qeveria vetëm i menaxhon. Faktet tregojnë se në këta 10 vjet i ka keqmenaxhuar. Me inflacionin në rritje, me çmime të çmendura, që nuk bien këtu në Shqipëri as kur bien në të gjithë botën, rritja e pagave, ndonëse është lëvizja e duhur, nuk do të ndihet aq shumë nga përfituesit. Ne vazhdojmë të blejmë me çmime shumë të larta në një treg të deformuar nga oligarkët e qeverisë. Kështu pra, një pjesë të mirë të rritjes do ta gllabërojnë inflacioni dhe çmimet e larta, pjesën tjetër do ta gllabërojë korrupsioni i qeverisë dhe njerëzit do ta ndiejnë pak ose aspak këtë rritje. Për shkak të korrupsionit, njerëzit do të marrin shërbime me cilësi më të ulët, por me çmime më të larta. Ku ka korrupsion, ka varfëri, ka informalitet, ka pasiguri. Është një mashtrim gjigand i Edi Ramës, që një rritje e tillë pagash ndodh për herë të parë në Shqipëri. Një mashtrim që i shkon për shtat vetëm Edi Ramës.

Kur Partia Demokratike erdhi në pushtet në vitin 2005, paga mesatare në sektorin publik ishte 268 mijë lekë në muaj. Pra, 268 mijë lekë të vjetër në muaj. Gjatë mandatit qeverisës së PD-së, paga mesatare në sektorin publik u rrit në 522 mijë lekë në muaj, pra thajse u dyfishua. U rrit rreth 95%, megjithëse ishte koha e krizës ekonomike globale dhe me gjithë vështirësitë që kishte vendi. Po rezultati i Edi Ramës në 10 vjet, cili është? Pa rritjen që miratojmë sot, Edi Rama në 10 vjet e rriti pagën mesatare në shtet vetëm 123 mijë lekë ose më pak se 25%. Dhe vetëm në vitin 2025, pra 12 vjet pasi ka ardhur në pushtet, ndoshta do të arrijë të dyfishojë pagat në sektorin publik, gjë që Partia Demokratike e bëri brenda një mandati. E gjithë kjo llogari nuk merr parasysh rritjen reale që është shumë pak për shkak të inflacionit, pra të rritjes së çmimeve, keq-qeverisjes dhe korrupsionit.

Partia Demokratike do ta miratojë sot rritjen e pagave edhe pse ky është një akt shumë i vonuar, i pastudiuar dhe i bazuar tërësisht në motive elektorale-politike.

Por sot është dita që ne të ngremë zërin edhe për pensionistët. Ata duhet të ishin të parët në

vlërësim, por si gjithmonë mbeten të fundit. Ne do ta ngremë zërin për personat që përfitojnë ndihmë ekonomike, sepse vlëra e saj është thajse gesharake dhe nuk siguron minimumin jetik.

Çfarë do të bëhet me përcaktimin e minimumit jetik? A ka qeveria një plan lidhur me të? Na thonë se nuk kanë para, por para kanë mjaftueshëm, duhet thjesht dhe vetëm të mos i vjedhin. Mjafton të kujtojmë se vetëm në tubat e sobës së një pastrueseje, të një drejtoreshe të Edi Ramës, u gjetën 500 mijë euro korrupsioni dhe llogaritë janë të qarta si drita e diellit. Nëse nuk vidhni, ka para edhe për të rritur pagat, edhe për të rritur pensionet, edhe për të rritur masën e ndihmës ekonomike. Liderët e mirë u shërbejnë njerëzve me paga të mira, me pensione të mira dhe i trajtojnë ata me dinjitet dhe respekt. Këtu tek ne, asnjë nga këto nuk ndodh. Ne na drejton një qeveri e korruptuar, që paguan vetëm për të blerë vota, por jo për t'i trajtuar njerëzit me respekt dhe me dinjitet. Unë e di se kjo qeveri nuk i sheh as pensionistët, as punonjësit e sektorit publik, as profesionistët e lirë, as punonjësit e sektorit privat dhe as studentët, si njerëz që duhen shpërblyer për punën e tyre. Në listën e Edi Ramës ata janë thjesht numra zgjedhorë, që i duhen vetëm për të bërë llogaritë e pushtetit personal. Prandaj, për rritjen e pensioneve do të dëgjojmë ndoshta afër zgjedhjeve të ardhshme të vitit 2025, sepse kjo është fiks në stilin e kësaj qeverie, është fiks në stilin e Edi Ramës.

Faleminderit!

Ormonela Felaj – Faleminderit, zoti Bardhi!

Fjalën e ka zoti Gjikhuri.

Damian Gjikhuri – Mirëdita të nderuar deputetë!

Në fakt, diskutimi i sotëm është me rëndësi. Kjo temë që është prekur edhe para zgjedhjeve, por atëherë, fatkeqësisht opozita e shikonte si mekanizëm ndikimi elektoral, sot ka filluar t'i kthehet kundër, megjithëse për mua dhe për shumë njerëz që i njohin problemet e këtij vendi, ato çka tha Kryeministri janë më se të vërteta. Shqipëria ndodhet para sfidave të mëdha. Ky vendimi i qeverisë shqiptare, të cilin sot parlamenti do ta kthejë në ligj, është një nga masat e duhura për t'iu përgjigjur një kërkesë të kohës. Këtu s'duhet të kishim fare debat politik, këtu mbase duhet të merreshim me kategoritë. Këtu mund të kërkonim më shumë transparencë për sa

i përket mënyrës sesi do të financohet kjo rritje. Kjo me të drejtë mund t'i shqetësojë të gjithë, sesa është në gjendje ta përballojë qeveria këtë rritje, që është një masë jashtëzakonisht e rëndësishme me kosto financiare për buxhetin e shtetit, e mirëmenduar, sepse ministrja e Financave e shpjegoi shumë qartë, por të mos harrojmë që është masa e duhur, madje e vonuar. Sfidat janë shumë të mëdha. Le të flasim konkretisht nga terreni, se të gjithë takojnë biznese, takojnë njerëz dhe e dinë shumë mirë se problemi më i madh që ka ky vend nuk është çështja e investimit dhe e dështimit të aseteve, qoftë edhe atyre publike, por pasja e njerëzve për t'i mirëmbajtur këto mjete publike, duke filluar nga mjekët. Ne nuk kemi nevojë thjesht për spitale më të mira për të bërë investime në pajisje, por kemi nevojë për mjekë. Ne kemi nevojë për mësues më të mirë, jo vetëm për shkollat më të mira si objekte. Ne kemi nevojë për administratorë publikë më të mirë. Faktikisht, kjo rritje page ndikon direkt në mirëmenaxhimin e çdo gjëje që është publike dhe që efektin patjetër do ta ketë edhe te privati. Kjo është masa e duhur, është në kohën e duhur, madje edhe impaktin do ta ketë shumë pozitiv.

Ne kemi nevojë që të rinjtë dhe të rejtat tona ta ndërtojnë të ardhmen në këtë vend. Është kollaj të bësh demagogji politike, siç edhe ju shpesh e bënit në fushatë, kur u thoshit njerëzve: "Shqiptarët po ikin, se po ikin nga qeveria". Në fakt, në globalizimin e sotëm dhe në ato çka tha me të drejtë Kryeministri, sfidat që kanë shumë vende europiane janë të tilla që diktojnë thithjen e krahut të punës nga kudo. Ky është një problem real. Kjo është e barabartë me ligjet e karakterit darvinian, këtu po zhduken vende. Vendet do të kenë probleme serioze për të mbajtur skemat e pensioneve. Shikoni çfarë ka ndodhur në Francë! Shikoni çfarë ka ndodhur në vendet e tjera të Europës! Atëherë, si mund të vijmë ne këtu dhe të bëjmë politikë për një gjë që s'duhet të ishte politike, por përkundrazi, duhet të mbështetet nga të gjitha palët. Natyrshëm që ka një impakt ekonomik, i cili do të ndikojë direkt dhe te sektori privat. Disa industri duhet të adoptohen, patjetër do të adoptohen. Një pjesë të riskut financiar e ka marrë shteti, sidomos për skemën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, prandaj u rrit dhe paga minimale. Kjo është një masë jashtëzakonisht e rëndësishme, e cila jo vetëm që ndikon në ekonominë e vendit, sepse neve na duhet t'i

mbajmë kapacitetet tona ekonomike, që të mos ndikohen nga këto politika kaq të nevojshme, por nga ana tjetër, një pjesë të riskut shteti e merr përsipër. Nga ana tjetër, kjo është një masë e mirë sociale.

Unë e kam thënë dhe herë tjetër, unë jam krenar që qeveria socialiste adreson një çështje që është e mirëfilltë sociale. Administrata publike është e të gjithëve, është shumë e rëndësishme. Patjetër, ashtu siç kërkojmë rritjen e rrogës dhe mirëpagimin e tyre, sepse, në fund të fundit, e thashë, na duhen njerëz më të mirë, që të rinjtë dhe të rejat ta ndërtojnë të ardhmen këtu, duhet t'u kërkojmë edhe më shumë llogari. Kjo duhet të shkojë krah për krah. Pagat e administratës publike kanë qenë jo në nivelin e duhur dhe shpeshherë, fatkeqësisht, në shumë sektorë ne nuk kemi njerëz. Unë këtë e kam konstatuar dhe vetë kur kam qenë ish-drejtuës institucioni, ish-ministër, nuk gjen specialistë. Kjo është sfidë për të gjithë, nuk është thjesht çështje politike. Mund të vijmë të flasim sa të duam, por kjo është një sfidë reale e këtij vendi. Mund të investosh sa të duash në asete, mund të bësh rrjete të reja energjetike, mund të bësh spitale të reja, mund të bësh rrugë të reja, mund të bësh gjithçka, sepse me para sot mund të bësh gjithçka. Ekonomia shqiptare dhe buxheti i shtetit po përmirësohen, falë edhe rritjes ekonomike, përtej skenarëve që thoni. Por nga ana tjetër, kush do t'i mirëmbajë këto asete? Faktori njeri është faktori më i rëndësishëm në çdo fushë të jetës dhe jo më në mbarëvajtjen e një vendi. Prandaj, kjo masë shkon direkt te njerëzit, te faktori njeri. Të mbajmë profesionistët në këtë vend, të ndërtojnë të ardhmen për këtë vend. Them që kjo është masa e duhur, në kohën e duhur dhe këtu nuk ka nevojë për spekulim.

Realisht, ngrihet pyetja: çfarë efekti do të ketë te sektori privat? Një e preka. Patjetër, shteti do të marrë përsipër që për një farë kohe të kompensojë, aq sa mundet sektorin privat.

E dyta. Të flasim dhe të jemi dëshmitarë, më gjeni sot mua një kompani që paguan nën 40 000 lekë? S'ka më. Nuk gjen më punëtorë me 40 000 lekë të rinj, s'ka mundësi. Sot ka një konkurrencë në tregun e punës. Ky është realiteti. Ka vende që kanë asete shumë të mira turistike. Në Jugun e vendit, në bregdetin shqiptar nuk gjen punonjës edhe me 80 apo 90 000 lekë. Pra, mos e kini merakun e sektorit privat, sepse sektori privat

automatikisht do të ndjekë këtë trend. Pasja e njerëzve këtu, pasja e familjeve këtu, jep mundësinë për të pasur më shumë njerëz dhe në sektorin privat, sepse do të ikin njerëzit dhe realisht beteja jonë kthehet në një betejë kot, betejë fjalësh këtu. Për çfarë të luftojmë? Prandaj them që masa do të ndikojë direkt edhe në sektorin privat, për të mbajtur specialistë dhe njerëz aq të nevojshëm për ekonominë tonë, qoftë për ekonominë në sektorin publik, por mbi të gjitha për ekonominë në sektorin privat. Kjo është e vërteta.

Shikoni kompanitë e ndërtimit! Sot ka shumë asete prodhuese, po flas për zonën e Elbasanit, asete të mirëfillta prodhuese, fabrika që eksportojnë pajisje, madje pajisje industriale. Janë me mijëra punonjësit në këto fabrika, por ato kanë një problem, gjetjen e specialistëve. Atëherë, aspak nuk duhet ta shikojmë me frikë këtë rritje, përkundrazi duhet ta shikojmë me shumë pozitivitet.

Natyrshëm (fatkeqësisht, bëhet populizëm, bëhet edhe politikë) këtu ngrihet edhe çështja e pensioneve. Shumë e vërtetë. Më falni, por po bëj një pyetje (se kjo është llogaria më e thjeshtë për çdo njeri që e njeh abc-në e shtetit), si do të ngrihen pensionet po nuk u furnizua me para skema e pensioneve? Atëherë, t'i shtrojmë pyetjen vetes, nëse paga mesatare në Shqipëri do të shkojë 900 euro në të gjithë sektorët e marrë së bashku, a do të rritet dhe kontributi për skemën e pensioneve nëpërmjet skemës së sigurimeve shoqërore? Përgjigja është "po". Atëherë, shtrohet pyetja tjetër, a do të krijohet mundësia që edhe pensionistët të shikohen me sy tjetër? Po, natyrshëm, sepse shtimi i financimit të skemës së pensioneve do të garantojë, mbi të gjitha, këto pensione që kemi, si dhe do të hapë siparin, do të krijojë hapësirën për financimin e rritjes së pensioneve në shumë drejtime. Kështu bëhet kjo. Kjo është politikë e mirëfilltë shtetërore. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër. Mund të flasim sa të duam ne, por nuk ka asnjë mënyrë tjetër për ta realizuar atë.

Kështu që, atyre pensionistëve që na dëgjojnë, ju them: të nderuar pensionistë, fushata mbaroi (se këta e kishin për politikë përpara fushatës), jam i bindur që rritja mesatare e pagës do të ketë efekt pozitiv edhe për ju. Kjo është e garantuar, sepse vetë skema e pensioneve do të shtojë financimet për këtë skemë. Faktikisht, në vitin e fundit kjo qeveri ka treguar bujari për

pensionistët. Nuk po them se ka plotësuar çdo nevojë, se do të ishim naivë ta thoshim këtë gjë, por vetëm 6 muajt e fundit janë dhënë 160 000 lekë të vjetër shpërblime për pensionistët, për efekte të krizës, rritjes së çmimeve, gjëra që nuk varen nga ne, por shteti ka treguar se është një shtet me qasje sociale dhe e ka bërë këtë me masa konkrete. Realisht, forcimi i kësaj skeme me rritjen e pagave, do të çojë patjetër dhe në rritjen e pensioneve, dhe për këtë unë besoj se ka ardhur momenti.

Jam krenar për Partinë Socialiste dhe qeverinë e Partisë Socialiste, e cila do të bëjë të mundur edhe këtë kërkesë që e kanë mbarë qytetarët, sepse patjetër që pensionistët meritojnë më shumë.

Nga ana tjetër, nuk dua të lë pa përmendur qesharakllëkun e disave këtu, për atë populizmin tipik, kur bie fjala te paga e deputetëve. Unë nuk dua të hyj në këtë temë se sa duhet ta ketë deputeti pagën, por si ka mundësi të bëhet politikë sot nga ata njerëz? Pra, është tamam dilemë Zhvejkiane, se, në fakt, nuk është as dilemë, por është shfaqje Zhvejkiane, kur thuhet: “Ç’më duhet mua, ç’them unë”. Pa pikë turpi, voton tjetri në komision para dy ditësh për rritjen e pagës së deputetëve në ato nivele që pranon hierarkia e pagave, pastaj këtu thotë: “Jam kundër”. Ç’është ky qesharakllëk! A jeni njerëz seriozë? Këtu nuk duhet spekuluar me këtë temë. Po, atëherë, ta bëjmë që të mos ketë pagë deputeti, të bëjë edhe punë të tjera, mos ketë më asnjë kufizim, le të vijë nga çdo fushë e jetës dhe le të hiqet ky debat një herë e përgjithmonë, por jo me këto lloj formash, që për shkak se nuk kemi këtë, çfarë po bëjmë. Vetë ishit në konsensus, të gjithë palët e pranuan dhe nuk ka nevojë të bëhen shfaqje të shëmtuara nga kjo foltore, nga ata njerëz që me të dyja duart thanë: “Shyqyr që po rriten, se nuk jetohet më me këto paga, se deputeti ka vuajtje, ka probleme”, gjë që është e vërtetë, se është një punë që ka shumë angazhime dhe natyrshëm ka shumë kufizime.

Kështu që, t’i lëmë këta populizma se s’kanë vlerë, por ta miratojmë dhe t’i themi suksese kësaj qeverie, për një politikë aq të nevojshme për të përballuar një nga sfidat më të mëdha që ka jo vetëm Shqipëria, por i gjithë rajoni në këto momente.

Faleminderit shumë!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gjijnuri!

Fjalën për procedurë e ka kërkuar zoti Gjekmarkaj.

Agron Gjekmarkaj – Zonja Felaj, dua të jap edhe unë një mendim për çështjen e rrogave, meqenëse jemi në këtë kontekst. Unë besoj shumë se këto vite ka pasur një strategji për depersonalizimin e deputetit nga viti në vit. Depersonalizimi i deputetit, është depersonalizimi i politikës. Statusi i deputetit, është edhe statusi i politikës.

Unë shoh dhe po kuptoj sot që në këtë parlament duhet të jesh biznesmen, që të vish dhe të bësh politikë, duhet të jesh prokuror, që të vish dhe të bësh politikë, por nëse je pedagog, nëse je njeri i zakonshëm, i bie që nuk vjen dot, sepse nuk ke të ardhura për ta përballuar politikën. Unë e konsideroj shumë të vonë dhe e konsideroj të pamjaftueshme rritjen e rrogave, qoftë edhe për deputetët. Deputetët nuk janë nënkategori, nuk janë specie për t’u përbuzur. Unë nuk pranoj të jem hajdut. Unë dinjitetin e kam te rroga dhe mendoj që është gjëja e duhur dhe e vonuar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gjekmarkaj!

Zoti Shehi e ka fjalën.

Të përgatiten zoti Ahmetaj dhe zonja Ina Zhupa.

Dashamir Shehi - E nderuar zonja nënkryetare,

Të nderuar kolegë,

Sigurisht që në princip jemi të gjithë dakord dhe do ta votojmë këtë ligj. Unë jam prej atyre që këtë gjë e kam përmendur këtu 3 apo 4 herë, madje ka pasur edhe komente nga salla: “Po inflacioni, po kjo”, nga ato përrallat e kota, nga njerëz që nuk e njohin shumë këtë punë, me thënë të drejtën. Kështu që, më bëhet qejfi që po i rrisim pagat. Absolutisht, është një gjë shumë e mirë. Të jesh kundër rritjes së pagave, them se është një lloj budallallëku në këtë kohë. Unë them që është e vonuar, të paktën 5 - 6 vjet, sepse të gjithë tani po e përmendin, që për efekt të pagave kanë ikur njerëzit dhe se kjo rritje u bë nën presionin e kësaj gjëje. Po të ma ktheni mbrapsht kasetën për të parë ato që kam thënë para 2 vjetësh, do të shikoni që po këto fjalë kanë qenë, që pagat duhen rritur, që ta bllokojmë ikjen. A e bllokojnë vetëm pagat? Jo. A ka faktorë të tjerë në këtë fenomen? Plot, më të rëndësishëm sesa pagat, por paga është ajo që ne mund të bëjmë në këtë moment. Them se

paratë kanë qenë aty me kohë, por ne jse, kjo është një gjë e kaluar dhe nuk do të qajmë qumështin e derdhur.

Po çfarë kam unë problem brenda rritjes së pagave? Një herë, ne duhet ta kemi transparente piramidën e profesioneve edhe të shtetit shqiptar, për të parë ku rriten më shumë, ku rriten më pak. A shkojmë të godasim pikërisht ata sektorë, në njëfarë mënyre, të cilët afektohen më shumë nga rritja e pagave? Unë dua të them se duhet të tentojmë të rrisim më shumë pagat në arsim, në shëndetësi, shërbyesit publikë, që janë ushtarakët, policët. Në qoftë se do ta përqendrojmë vertiklizimin vetëm tek administrata, do të krijojmë një piramidë e cila nuk është e vlefshme për këtë hall që kemi ne. Unë gjykoj se kjo është e para dhe ne duam një piramidë të qartë, transparente në gjithë këtë proces, sigurisht, edhe me faturën anash, se nga do të merren këto para dhe si do të shpërndahen këto para.

Unë them se paratë gjenden, e kam thënë edhe herën tjetër, kur kemi folur këtu. Po si do të gjenden paratë? Në qoftë se ne do të vazhdojmë të mbajmë gjithë këtë administratë të madhe...

Se dikush mund të thotë: more, ky do të heqë njerëz nga puna. Nuk mund të rrijë kjo administratë me një popull me 250 mijë banorë. Ne bëme një reformë administrative për t'i shkurtuar njerëzit, sepse thamë që do të kursejmë 80 milionë, por, në fakt, janë rritur shpenzimet për administratën lokale. Ne thamë që kemi investuar gati 160 milionë, madje disa mburren këtu se investimet kanë mbërritur tani 200 milionë, në një sërë institucionesh, sepse presupozohej që një pjesë e shërbimeve të bëhej elektronike dhe një pjesë e njerëzve duhej të largohej, të shkurtroheshin. Kështu që, kjo duhet të jetë politikë konstante për të gjithë dekadën që vjen, rrit pagat dhe shkurto njerëzit që shpeshherë mbushin kot zyrat e shtetit. Nuk mund të bëhet në një ditë kjo. Nuk po them të hiqen njerëzit në mëngjes nga puna, por unë po them të bëhet një projekt 5-vjeçar, i cili largon 20% të administratës dhe në këto kohë ka kërkesë pune, nuk është më kaq dramatike, sepse mund të gjejnë punë në sektorë të tjerë. Sigurisht që do kohë, për mendimin tim.

E dyta. Rritja e pagave duhet të shërbejë edhe për ta rindërtuar piramidën, sipas meritokracisë, sipas nevojave që ka shteti

shqiptar. Ç'domethënë të rriten pagat? Pse është paga?

Paga, së pari, është shpërblim për punën e bërë.

Së dyti, është nevojë për qytetarin, sepse do të plotësojmë dhe disa nevoja të tyre, por është edhe për të ndërtuar hierarkinë brenda një shteti serioz. Në qoftë se kjo pagë e shpërndan hierarkinë, e bën grupe-grupe, unë them që do të mblidhemi prapë këtu mbas një vit për të diskutuar të njëjtat probleme.

Ky ligj i ka dhënë shansin qeverisë, që nuk e ka pasur më përpara, që çdo lloj ndryshimi në sektorin e pagave ta ketë dorën e lirë sot dhe nuk mund të ankohet më që do të vijë në parlament përherë. S'ka pse vjen. Kështu që, e gjithë kjo qeveri duhet të ngrëjë institucionet që merren me pagat, të cilat ka vite që nuk i ka. Nuk ka më as Ministri të Punës, as drejtori të përgjithshme të pagave dhe as të pensioneve. Pra, i mungojnë këtij shteti një sërë institucionesh, të cilat projektojnë politikën e pagave drejt së ardhmes.

Do të ndalem tani te zhurma e madhe e rritjes së pagave për deputetët, që sigurisht ka brenda edhe populizmin, edhe trishtimin e diferencimit. Të them të drejtën, të gjithë këtë zhurmë e ngriti vetë zoti Kryeministër, duke dalë rreth më rreth dhe duke u ankuar e duke thënë se ministrat i kishte bindur ai të mos duan rritje page, por nuk kishte se çfarë t'u bënte deputetëve. Pra, ky është një sulm kundër parlamentit në një farë mënyre, dhe të them të drejtën, më shumë sulmin e ka për njerëzit e mazhorancës, që po u thotë në një farë mënyre se nuk janë më kaq të nevojshëm, kaq të domosdoshëm, le pastaj opozitën. Kështu që këtë lloj populizmi, shpeshherë të rëndomtë, e ngriti vetë kryetari i ekzekutivit. Pastaj këtu mund të dalin sa të duan me propozime të çuditshme.

Pagat e deputetëve duhet të rriten se është e nevojshme. Sigurisht unë do të kisha preferuar formulë tjetër, që të mos bëhej ky lloj debati. Sigurisht që unë e di shumë mirë, edhe shumë prej jush, që ne jemi shumë këtu, një vend me 2 milionë e gjysmë banorë nuk mund të ketë 140 deputetë. Ka ardhur dita të bëhemi më pak, të bëhemi 100 ose 90. A i patë zgjedhjet në Greqi? Përfunduan. Greqia është 4 herë më e madhe se Shqipëria dhe ka 300 deputetë, po të mateshim me këtë ritëm, ne do të na binte të kishim 700. Vendet fqinje këtu, që janë në dimensionin tonë, kanë më pak deputetë. Ka ardhur dita që deputeti të

paguhet mirë, por të jenë më pak. Edhe nga administrata e Kuvendit, njëherë e një kohë, këtu shërbenin 60-70 veta, sot nuk e di se sa janë, se nuk i kam hyrë kësaj pune, por jam i sigurt që është dyfishi.

Të ndalemi te pika tjetër, që të gjithë e prekën këtu, pensionet. Nëse pagat do të rriten që këtë vit, presupozohet që rreth 300 milionë të shtohen në fondin e pagave dhe të pensioneve, siç janë zërat buxhetorë, që do të thotë se kontributi për pensionet presupozohet do të rritet me 100 milionë. Unë do të thosha që kjo qeveri i ka të gjitha mundësitë të gërmojë xhepat e të shtojë edhe një 100-milionësh tjetër. Po u bënë 200 milionë, duke ditur se fondi i përgjithshëm i pensioneve është gati 1,2-1,3 miliardë, i bie që të kemi një fond disponibël për të rritur pensionet mesatarisht 17-16 %, por mund të rrisim ato të voglat më shumë, deri në 25%, dhe të mbajmë pensionet më të larta në një nivel rritjeje më të vogël. Kjo do të shërbejë jo thjesht për të përmbushur nevojat e mijëra familjeve të varfra, sepse edhe kaq nuk mjafton, pasi pensionin shqiptar edhe po ta rritësh 25%, nuk mjafton, por kjo shërben për t'u dhënë shpresë mijëra njerëzve se me një politikë serioze mund të mbërrijnë te niveli i mbijetesës. Kjo është e gjitha, dhe për këtë duhet t'u drejtohem seriozisht qytetarëve tanë.

Përtej zhurmës, demagogjisë, pensionistët janë një masë e madhe, janë 600 mijë vetë, janë votues, por ky është një sektor, me të cilin, të them të drejtën, nuk jemi marrë kurrë me seriozitet. Deficiti ka qenë gjithnjë aty ku është, rreth 400 milionë në vit, por, në fund të fundit, për një shtet që ka marrë gati 10 miliardë para borxh nëpër botë, le ta durojmë borxhin edhe për pensionistët, ata që kanë punuar gjithë jetën dhe janë në një nivel mizerjeje. E bëj këtë lloj propozimi jo për populizëm, as për propagandë, por mendoj se ka një shteg për të dalë edhe sistemi i pensioneve nga kjo gjendje që është sot.

Thënë këtë, nuk do të zgjatëm më tepër; sigurisht që jemi për rritje rrogash, sigurisht jemi që ky proces të mos përdoret për një propagandë banale, sepse rrogat pas një viti vetëkonsumohen nga inflacioni, nga procesi, dhe do të vijmë këtu prapë për të diskutuar. Unë them se ky duhet të jetë fillimi i një procesi që duhet të vazhdojë një dekadë, përtej çdo qeverie, kushdo qoftë, këta apo të tjerë që mund të vijnë mbrapa, sepse ky *gap* i madh që kemi me vendet e rajonit dhe me

Europën, nuk mbyllet as për një vit, as për dy. Nuk ka për t'u mbyllur asnjëherë, nëse nuk do të merremi seriozisht me këtë punë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Ahmetaj, të përgatitet zonja Zhupa dhe zonja Ekonomi.

Arben Ahmetaj – Me shumë respekt, në fakt, do të ndalem tek ajo që tha Dashamir Shehi, me të drejtë, dhe do t'i referohem edhe një kolegut tim të mazhorancës, se rritja e pagave është thellësisht politike. Kur them thellësisht politike, për çfarë aspekti e kam fjalën? Është një reflektim i një qeverie në vazhdimësi për vite të tëra, por së fundi, ky propozim për një rritje historike të pagave dhe reflektimi politik, ka të bëjë me produktivitetin e administratës publike, por, gjithashtu, edhe me hedhjen e një spirance shumë provokative, pozitive për sektorin privat.

Për statistikë, rritja është 1,6% e PBB-së. Nuk është bërë asnjëherë, është hera e parë që rritja është kaq e madhe dhe, në fakt, plotëson pritshmërinë shumëvjeçare të administratës publike. Nëse ne i referohemi administratës publike, si platforma ku do të negociohet, ku po negociohet integrimi europian, ku hartohen, në bazë të orientimeve politike, politikat dhe reformat e një qeverie për 10-12 e më shumë vite, atëherë sigurisht që administrata meriton të shpërblehet edhe në raport me suksesin e reformave. Nëse ekonomia është rritur, PBB-ja nominale është rritur deri në vitin 2025, me parashikimet 80%, paga mesatare rritet gati 100 e ca për qind. Kjo do të thotë që gjithë atë diskutim që bën opozita në raport me inflacionin apo në raport me rritjet historike, kjo statistikë e rrëzon.

Në anën tjetër, kur i referohemi një sfide shumë të madhe ekonomike, sfida ekonomike është te produktiviteti i kësaj ekonomie, në mënyrë që paga e sektorit publik të ndiqet nga rritja e pagës së sektorit privat, pra, paga mesatare në ekonomi. Nëse në vitin 2025 paga mesatare në sektorin publik do të jetë 900 euro, në sektorin privat do të jetë diku te 600 euro. Kjo është kundërshti në një ekonomi (këtë kundërshti, i ftoj edhe deputetët e mazhorancës, edhe deputetët e opozitës ta ndjekin), kjo kundërshti shoqërohet nga një element shumë interesant statistikor, por jostatistikor: imagjinoni që në vitin 2013 fitueshmëria, tatimfitimi, por fitueshmëria pastaj në koncept indirekt, ka qenë 15 miliardë, sot është

48 miliardë. Atëherë, një sfidë për sektorin privat dhe për të gjithë kapitalin në sektorin privat, që do të duhet të reflektojnë në mënyrë ekonomike dhe sociale ndaj të punësuarve: paga mesatare në ekonomi është rritur me 43%, fiksojeni këtë, fitueshmëria e sektorit privat është rritur 300%. Çfarë nuk meritojnë të punësuarit që të përfitojnë nga rritja ekonomike dhe nga rritja e fitueshmërisë? Të gjithë përfaqësuesit e kapitalit, që dikush këtej i quan oligarkë, dikush i quan sipërmarrës, dikush i quan biznesmenë apo bizneswomen, duhet të reflektojmë. Pra, është rritur fitimi i tyre 300%, ndërkohë që paga mesatare në ekonomi është rritur 45%. Por biznesi, nuk ka reflektuar. Çfarë bën qeveria me këtë politikë?

Përtej të gjitha atyre që u thanë këtu me të drejtë, praktikisht qeveria po provokon në mënyrë shumë pozitive sektorin privat. A largohen më të mirët sipas disave? Migracioni dhe emigracioni e ka shoqëruar botën, globin, në forma dhe drejtime të ndryshme gjithë jetën, për arsye politike, për arsye luftërash, për arsye ambientale, për arsye kurioziteti, për arsye ekonomike, të gjitha bashkë janë. Dhe, iu referua me të drejtë Kryeministri, praktikisht, ne kemi sot një fuqi centrifugale që tërheq fuqinë punëtore. Po mirë, nëse kapitali del në treg dhe kërkon fuqi punëtore dhe oferta e tregut të punës është indiferente, a ka një analizë pse kapitali nuk arrin dot të tërheqë fuqi punëtore? Po, sigurisht që duhet të ketë. Atëherë, konkluzioni i parë është që ti si kapital, ti si sipërmarrës, ti si entitet ekonomik, aktor ekonomik, nuk e ke ndarë fitimin tënd më të punësuarin; 43% paga mesatare e të punësuarve në sektorin privat, 300% fitimi.

Qeveria praktikisht po hedh në tregun e punës një provokim shumë interesant për pjesën private të tregut të punës. Po, unë po futem në një reformë graduale për të rritur pagat e administratës publike, është çështje vlerësimi, është çështje produktiviteti, është çështje konsumi, është çështje demografie, patjetër. Mos harroni dhe një element tjetër, rritja e konsumit do të fillojë të balancojë kursin e këmbimit dhe automatikisht do të ndihmojë eksportin, fenomenet ekonomike, fundamentet ekonomike nuk gjykohen tek e tek, gjykohen të gjitha bashkë. Pra, rritja e pagës, sa i përket pjesës së administratës publike, provokon pozitivisht sektorin privat.

Tani do t'i referohem diskutimit që bëri Dashamir Shehi për pensionet. Sigurisht që çdonjëri nga ne, për populizëm, do të thotë: të rrisim pensionet, të rrisim pensionet. Është e domosdoshme t'i rrisim pensionet; iu referua Gazment Bardhi, kur tha se jemi vonë. Ajo që kuptova unë nga çfarë tha pjesa e opozitës, foli kryetari i grupit dhe dikush nga Komisioni i Ekonomisë, praktikisht është një kundërshti e tërë. Të gjitha ato që ju thatë, janë arsye pse rritja e pagave është e domosdoshme, është në kohën e duhur dhe konkluzioni që ju do ta votoni, presupozon një reflektim pozitiv në raport me një reformë që po bën qeveria. Unë do të propozoja që në kohë të bëhej edhe në parlament, me të drejtë iu referua sërish Dashamir Shehi (se këtu ka deputetë me shumë eksperiencë, me 20-25 vjet, që kanë debatuar e diskutuar në vazhdimësi për këtë), pra, të bëhet një grup pune qoftë në parlament, qoftë në bashkëpunim me qeverinë për të parë gradualitetin e pensioneve. Vetëm rritja e pagave prej 350 milionë, do të sjellë gati 120 milionë euro kontribute nga punëdhënësit dhe nga punëmarrësit. Është një burim. Nuk po them se kjo që po them unë është 100% e saktë, por grupi i punës për të parë pensionet, ka ardhur momenti që duhet t'i shohë.

Dua ta mbyll me pjesën demografike, e cila është shumë e rëndësishme. Që të mbash njerëzit, siç iu referova, është një histori e vjetër sa globi, që të mbash njerëzit në tregun e punës, sigurisht që do të duhet t'i shpërblesh.

Dhe, do ta mbyll fjalën time duke ndarë me publikun se, nëse paga mesatare në ekonomi, dhe e përsëris që të na mbetet në mendje duke filluar që nga vetja e kushdo nga ne këtu, pra, nëse paga mesatare në ekonomi është rritur 43%, po flas në ekonomi (privati), fitueshmëria është rritur 300%. Ne nuk e komandojmë dot kapitalin, as me vendim qeverie, por është një thirrje shumë e rëndësishme që fitueshmëria nga kapitali, konsekuencë e tregut të punës dhe krahut të punës, sigurisht të ndahet me të punësuarit në sektorin privat.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Po, zoti Berisha.

Sali Berisha- Fitueshmëria e parafolësit është rritur 800%, e këtij që flet për fitueshmërinë.

Ermonela Felaj- Zoti Berisha, jo komente për parafolësit, nëse keni diçka për procedurë do t'ju japë fjalën, por, nëse nuk keni diçka për procedurë, do t'ju ndërpres fjalën. Cila është kërkesa juaj procedurale?

Sali Berisha- Pikërisht për procedurë do të flas, do të krijojme sistemin e gjobave për mashtrimin. Nëse në këtë parlament nuk vendoset sistemi i gjobave për deputetët që mashtrojnë publikun, ky parlament nuk meriton të ekzistojë asnjë ditë.

Ermonela Felaj- Zoti Berisha, do t'ju ndërpres fjalën, sepse fjala juaj nuk ka lidhje me procedurën. Ju lutem, uluni! Kur të merrni fjalën sipas listës së diskutantëve, mund të thoni të gjitha pretendimet tuaja, por, ju lutem, mos të abuzojmë në këtë mënyrë tani me Rregulloren. Ju lutem, uluni!

Fjalën e ka zonja Zhupa.

Ina Zhupa- Faleminderit!

Në fakt, me propozimin e zotit Berisha jam dakord, sepse, nëse do të vendosej sistemi i gjobave, e gjithë mazhoranca në fund nuk do të arrinte dot jo të merrte rrogën, por edhe të jepte nga pasuria për të paguar për gjokat që detyrohen për mashtrimet që thonë në këtë parlament, por edhe jashtë tij.

Vijmë në këtë parlament pas zgjedhjeve lokale, apo e thënë ndryshe, pas asaj masakre zgjedhore që ju e bëtë të certifikuar edhe nga çdo institucion i kapur i zgjedhjeve, nga KQZ-ja juaj, nga organet tuaja, të cilën e nisët që para se të niste procesi i zgjedhjeve duke mos na lejuar as të konkurronim ashtu siç ishim, si parti politike, si grupim politik, të përfaqësonim opozitën e vendit, atë që, në fakt, përfaqësojmë me dinjitet.

Ju keni rritur mbështetjen, tha Edi Rama para pak minutash. Po, ju keni rritur mbështetjen eksponenciale si kurrë më parë, në të gjitha burgjet e vendit. Historia politike do të shkruajë që në burgjet e Shqipërisë ka vetëm vota të majta. Shpjegimi është i thjeshtë, janë dy arsye: ose administrata e burgjeve ka manipuluar votimin dhe është flagrante se si ndërhyr shteti në votimin e të burgosurve, ose një shpjegim tjetër sociologjik, të cilin unë nuk e besoj, se krimi qenka vetëm socialist, dhe nuk paska demokratë të dënuar në burgje. Nëse ju e besoni këtë të dytën, atëherë mund të jetë edhe ky shpjegimi. Vetëm një nga këto të dyja dhe të dyja shpjegojnë shumë qartë se çfarë ka ndodhur me procesin zgjedhor.

Në Tepelenë 65 të burgosur votojnë pro jush dhe vetëm 3 pro kandidatit “Bashkë fitojmë”; në Peqin 119 të burgosur votojnë pro kandidatit tuaj dhe vetëm 9 vota pro kandidatit “Bashkë fitojmë”; në Burrel 55 të burgosur votojnë pro kandidatit tuaj dhe vetëm 10 vota pro kandidatit “Bashkë fitojmë”; në Belsh 25 të burgosur pro kandidatit tuaj dhe vetëm 4 vota pro kandidatit “Bashkë fitojmë”.

E fundit, por jo nga rëndësia, në fakt ajo që bëri edhe rokadën, Bashkia e Rrogozhinës në histori do të ngelet si bashkia që e morët me votat e burgut, ku kandidati i “Bashkë fitojmë” ishte 53 vota para dhe ju shfaqët në mënyrë magjike kutinë e burgut ku do të vulosnit fitoren e kandidatit tuaj me 92 vota pro dhe vetëm 12 vota për kandidatin “Bashkë fitojmë”. Kjo është mënyra se si ju keni bërë zgjedhjet dhe se si keni garantuar mbështetjen e lartë të qytetarëve për fitoren e kësaj mazhorance.

Para pak minutash, po Kryeministri tha: “Nuk duhet të bëni politikë me largimet e shqiptarëve”. I njëjti Kryeministër, që me zë dhe me figurë, regjistrim të cilin unë mund t'ju vendos edhe tani, ka thënë se shqiptarët ikën nga Shqipëria se këtu nuk jetojnë dot, por atëherë ishte viti 2013, kur ishte në opozitë dhe e mendonte që shqiptarët largohen pikërisht nga politika, nga keqqeverisja. Nëse largimet atëherë ishin 1/100-ta e largimeve sot, imagjinoni se çfarë ka ndodhur me qeverisjen dhe me politikën gjatë këtyre 10 vjetëve që qeveris Edi Rama. Përgjigjen besoj e kuptoni vetë.

Një popull i varfër është një popull shumë lehtë i kontrollueshëm dhe kjo, në fakt, është premisa me të cilën ju keni qeverisur. Një popull i varfër është një popull që blihet më kollaj në zgjedhje, një popull i varfër është një popull që kërcënohet më lehtë nga forca e pushtetit. Me këtë premisë e keni mbajtur popullin e varfër. Ne jemi i vetmi vend në rajon që nuk kemi të përcaktuar minimumin jetik. Është momenti që ky parlament të bashkohet njëzëri, majtas edhe djathtas, për të vendosur minimumin jetik. Sipas studimit të fundit të Avokatit të Popullit, 9,9% e pensioneve minimale janë më të ulëta se minimumi jetik, pra ata 9,9% jetojnë në kushtet e mbijetesës, jetojnë në kushte ku nuk dinë nëse do të kenë bukë për të nesërmen. 37,5% e pagesave të papunësisë janë më të ulëta se minimumi jetik.

Pra, ata njerëz që jetojnë me pagesat e papunësisë jetojnë në kushtet e mbijetesës, 37,5% e tyre. Ky duhet të ishte shqetësimi i këtij parlamenti. Është minimumi jetik i llogaritur nga Avokati i Popullit dhe është 3-fish më i lartë se ndihma ekonomike, 300% më shumë. Pra, njerëzit që jetojnë në këtë vend me ndihmë ekonomike e kanë të pamundur edhe konceptin e mbijetesës, po nuk u ndihmuan nga të afërmit, po nuk kërkuan lëmoshë dhe po nuk sakrifkuan çdo ditë të tyre si të fundit. Dhe për këtë përcaktimi i minimumit jetik është edhe më i rëndësishëm, sepse lidhet me pagesat e papunësisë, me pensionin, me ndihmën ekonomike, lidhet pikërisht me atë shtresë, e cila ndihet më e shtypur, më e varfër, më e nëpërkëmbur dhe me të cilën ju tregtoni kollaj edhe votën për një pushtet të blerë.

Në fakt, zgjedhjet e treguan qartësisht se si shkelje Kushtetuta ditën me diell, se si Kryeministri 5 fjali të fjalimit të tij i kishte të gjitha në shkelje të Kushtetutës, se si kërkonte mospjesëmarrjen në zgjedhje, shkelje e hapur e Kushtetutës, se si thoshte që nuk do t'u jepte fonde kryetarëve të bashkive nga koalicioni "Bashkë fitojmë", shkelje po aq e hapur e Kushtetutës dhe me këtë krenohej, dhe i fuste një tallava në fund. Në fakt, tallavaja, njafton të shikoni kasetat e atyre viteve, më kujtoi takimet që bënte nëpër qytete Rrapush Xhaferrit, të cilin e prisnin njësoj si Ramën, me dajre, muzikë, me këngë për të dhe në fund premtonte edhe ai mrekulli njësoj si Edi Rama. Fundin ia dini besoj dhe besoj se do të jetë i njëjtë edhe për Edi Ramën.

Zonjën Shkodër e shndërruar në shoqja Shkodër. Me gjithë makinerinë e shtetit, me gjithë makinerinë e parave të pista të bandave, të njerëzve të cilët kërcënuan dhe manipuluan rezultatin e një qyteti, i cili, të jeni të sigurt, demokrat është, demokrat do të jetë dhe ju nuk e shndërroni dot sado të mund të blini rezultatin zgjedhor.

Meqenëse keni nisur turin e falënderimeve, turin e falënderimeve përveçse duhet ta ndalni në çdo burg të vendit si mbështetja juaj më popullore, duhet ta ndalni edhe në çdo rajon të policisë. Duhet ta ndalni, sepse Policia e Shtetit kësaj radhe mori pjesë në mënyrë aktive në fushatën elektorale. Mjafton t'ju them rastin e Delvinës, ku kandidati nuk ishte më shumë sesa kushëri i parë i Ardë Veliut dhe Policia e Shtetit

kishte urdhër të prerë të monitoronte kandidatin e opozitës ku shkonte, kë takonte dhe për t'i dërguar mbrapa njerëz me uniformën e policisë për t'i kërcënuar.

Policinë e Shtetit jo vetëm kaq, por e përdorët edhe për takimet tuaja elektorale, duke i reklamuar këto me paturpësi edhe në Facebook, teksa deputetja shkonte në Delvinë dhe thoshte, sot në një familje të nderuar të policit, njeriut që nuk duhet të kishte marrë pjesë në fushatën elektorale, sipas ligjit. Por ju nuk pyetët për këtë, sepse ju jeni vetë ligji, vetë Maliqi. Ju arritët të sillnit në Sarandë bandat. Kjo nuk ka ndodhur ndonjëherë. Në fakt, ai që foli para meje ka qenë përballë meje në vitin 2021 dhe nuk i sollti bandat në Sarandë, nuk arriti deri aty, sepse e dinte që është një qytet me shumë kulturë që nuk i pranon bandat. Për herë të parë keni një rakord tjetër në Sarandë, keni humbur këshillin bashkiak në Sarandë. Keni humbur atë që nuk e keni humbur në 32 vjet, e humbët kësaj radhe. Pse? Sepse paratë i hodhët vetëm për kandidatin, për kandidatin e importuar të mafies së ndërtimit dhe e latë mënjane këshillin bashkiak, kjo për të kuptuar mbështetjen reale që ka Partia Socialiste.

Çfarëdo që të bëni, ju nuk na ndaloni dot që ne të themi fjalën tonë këtu, të jemi opozitë. Edhe e vetme ngelsha, opozitë do t'ju bëj çdo ditë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Zhupa!

Fjalën e ka ministrja Ekonomi.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, ne vijmë këtu në këtë seancë, pas një periudhe ndërprerjeje për arsye të zgjedhjeve lokale dhe aty populli vendosi. Ngjyra që ka marrë harta e Shqipërisë është një ngjyrë që tregon se populli beson në ato që thua dhe shikon ato që bën. Në fakt, kjo ishte motoja kryesore e Shqipërisë për të kuptuar që viti 2030 do të jetë një situatë komplet ndryshe për të gjithë banorët e Republikës, ku Shqipëria së bashku me Partinë Socialiste mendon se do të ketë një rritje ekonomike të konsiderueshme, duke u bërë një forcë në rajon, eksportuese neto e energjisë elektrike, por edhe një vend që ka turizëm të zhvilluar.

Dhe për t'i bërë të gjitha këto, pa dyshim që punon çdo ditë, punon çdo bashki çdo ditë, punon

çdo punonjës çdo ditë dhe kjo ishte arsyeja pse besuan shqiptarët. Sepse, në momente të vështira, siç ishte tërmeti, u mor përsipër të rindërtohej vendi dhe banorët e shumë bashkive, më shumë se 13 bashkive, panë ditë për ditë jo vetëm se si rregulloheshin shtëpitë e tyre, por edhe se si përmirësohej jeta e komuniteteve me infrastrukturë rrugore, elektrike, ujore, me më shumë shkolla, çerdhe dhe kopshte, ndërkohë, duke u dhënë mundësi komuniteteve të zhvillonin biznesin e tyre.

Prandaj, në momentin kur ne menduam që ka ardhur koha për të bërë një reformë pagash, natyrisht pamë edhe historikun e kësaj periudhe 10-vjeçare. Nuk ka qenë e lehtë, sepse nuk ishte vetëm pandemia ajo që ndikoi, përveç tërmetit, por edhe e gjithë pjesa tjetër e tregjeve botërore, duke filluar nga lufta në Ukrainë, që dha edhe një goditje në zinxhirin e furnizimit me shumë materiale, rriti çmimet në tërë botën, por përveç asaj edhe beteja që po bëhej me burimet e energjisë. Kështu që, të gjitha këto i dhanë një kosto inputeve që përdoreshin në produkte.

Megjithatë, INSAT-i mati edhe për vitin e kaluar rritjen ekonomike. Ne të gjithë e dimë se rritja ekonomike që u nxor nga INSTAT-i ishte më e lartë sesa ajo që parashikuan organizmat ndërkombëtarë, duke shkuar në 4,84%, një rritje ekonomike që vinte nga të gjithë sektorët, sektori i industrisë nxjerrëse dhe përpunuese, sektori i ndërtimit, sektori i shërbimeve financiare, por mbi të gjithë qëndronte sektori i turizmit, i cili dha një kontribut shumë të rëndësishëm në ekonominë e vendit, por, gjithashtu tregoi që në Shqipëri mundësitë për të bërë më mirë, janë edhe më shumë.

Ju po e shihni se 3-mujori i parë i këtij viti ka filluar me një rritje turistike, të cilën nuk e imagjinonim kurrë më parë. Nga ana tjetër, inflacioni ishte një element që Banka e Shqipërisë e kontrolloi, duke u përpjekur që me politikën stabilizuese t'i jepte një kontroll mbi inflacionin dhe të merrte masa të tilla që popullata të mos dëmtohej nga kjo gjë dhe në fund të vitit, kur u bë matja, inflacioni në Republikën e Shqipërisë ishte vetëm 6,7%. Ndërkohë, për këtë arritje shumë institucione ndërkombëtare si Joint Vienna Institute dhe të tjerë e falënderuan Shqipërinë për modelin që dha në rajon për mbajtjen e inflacionit të kontrolluar.

Librat e shtetit, të Ministrisë së Financave, treguan që në vitin 2022 edhe të ardhurat nga tatimet u rritën, por kryesisht të ardhurat nga TVSH-ja, për të cilat kanë nevojë të ndalem, ishin 14,2%. Por, ky inflacion dhe kjo e rritur nga TVSH-ja tregoi se ekonomia nuk performoi mirë për arsye të rritjes së çmimeve, por ekonomia performoi mirë për arsye të rritjes së produktivitetit. Kjo ishte baza, e cila bëri që i gjithë stafi i Ministrisë së Financave, i drejtuar nga Kryeministri, shumë shpesh edhe nga zëvendëskryeministrja, të mendonin së bashku për një reformë të pagave.

Kur flasim për reformën e pagave, ka shumë institucione ndërkombëtare që e orientojnë politikën e pagave. Një nga këto institucione është Zyra Ndërkombëtare e Punës, e cila ka dhënë rekomandime për vendet që kanë aderuar në të, se paga midis pagës shtetërore dhe pagës minimale duhet të jenë në kufijtë e 60%-it. Po ta shohim Shqipërinë në vitin 2018, nuk e kishte këtë nivel, as në vitin 2022 Shqipëria nuk e kishte këtë nivel, Shqipëria po tenton ta arrijë këtë nivel në këtë moment që ne po bëjmë reformën e madhe të pagave.

Siç jua thashë, kjo bëhet për dy arsye.

E para, sepse ia dolëm të bënim disa gjëra që i jepnin mundësi rritjes së produktivitetit.

E dyta, sepse kishim të ardhura.

Nga ana tjetër ne sot vëmë re se në vendet e Europës ka një presion shumë të lartë mbi tregun e punës. Të gjitha vendet europiane pas pandemisë kanë kuptuar, jo vetëm europiane por në nivel global, se kanë nevojë për të prodhuar më shumë mallra dhe thërrasin punëtorë nëpërmjet mobilitetit. Kjo gjë ndodhi edhe në Shqipëri. Por në Shqipëri ajo që ndodhi ishte se, po të shohim të dhënat e punësimit dhe të papunësisë të prodhuara nga INSTAT-i, kërkesa për punë gjatë vitit të kaluar u rrit me 3,9% dhe shkalla e papunësisë ishte më e ulët edhe sesa para pandemisë, megjithatë vende pune pati plot. Kjo bëri nga ana tjetër që edhe bizneset, në disa kategori, të rrisnit pagat e punonjësve të tyre, duke marrë parasysh se e donin fuqinë e punës të bënte detyrat e tyre të përditshme, por kjo kërkonte nga ana tjetër edhe një reflektim të politikës së qeverisë për rritjen e pagave. Natyrisht që qeveria shqiptare përdori çdo forum për të diskutuar me biznesin, për të kuptuar se si mund ta rriste pagën dhe ku mund ta rriste pagën.

Gjatë diskutimeve me biznesin u konkludua në diçka shumë të rëndësishme. E para, ishte shumë e rëndësishme që paga të rritej, por kishte sektorë, të cilët nuk mund të shkonin në pagën minimale 400 mijë lekë menjëherë. Ndaj për qeverinë, në një nga politikat e saj të mëvonshme ose të menjëhershme, duke filluar që nga 1 prilli, ishte marrja e masave për subvencionin e sigurimeve shoqërore për të gjitha ato biznese që nuk arrijnë dot të përballojnë rritjen e pagave në 400 mijë lekë për stafin e tyre që kanë punësuar. Pra, edhe rritja e pagave u bë në konsultim të vazhdueshëm me biznesin.

Sot ne jemi në një moment kur kërkojmë edhe më shumë afërsi me tregjet globale. Shqipëria, ju e dini, ka hyrë në një moment shumë të rëndësishëm historik, që është momenti i integritimit. Në momentin e integritimit, administrata publike duhet të punojë më fort, administrata publike duhet të jetë e aftë që *acqui*-në ta marrë, ta përkthejë dhe ta përshtatë në kushtet e ekonomisë sonë të brendshme, duke bërë politika ekonomike dhe sociale të ndryshme nga më parë dhe duke bashkëbiseduar vazhdimisht me biznesin, sepse pjesa më e madhe e *acqui*-së lidhet me përmirësimin e tregjeve. Kështu që në këtë moment, rritja e pagave bëhet shumë e rëndësishme jo vetëm për të motivuar që të kemi një administratë më efikase, por bëhet shumë e rëndësishme edhe për të motivuar biznesin që ta konsiderojë fuqinë punëtore si asetin e vetë ndërmarrjes. Këtu jemi sot, duke pasur një pagë mesatare, që në fund të vitit 2024, për administratën publike do të shkojë 900 euro. Ju e dëgjuat që me këtë pagë ne konkurrojmë vendet e rajonit, ngelemi pak pas Serbisë dhe Malit të Zi, por nuk jemi më të fundit në rajon.

Gjithashtu, u mor në konsideratë që bashkë me rritjen e pagave edhe jeta e përditshme e familjeve shqiptare duhet të jetë në përmirësim të vazhdueshëm, duke u rritur atyre fuqinë blerëse dhe masën e konsumit.

Edhe për inflacionin, Banka e Shqipërisë do të tregojë vëmendjen e duhur për të bërë të njëjtën politikë stabilizuese makro-ekonomike që ndoqi gjatë vitit të kaluar. Banka e Shqipërisë e ka projektuar rritjen ekonomike të Shqipërisë, edhe për këtë vit, një rritje të qëndrueshme dhe më të madhe.

Pa dyshim, ne jemi gjithashtu të ndërgjegjshëm se në momentin që do të rrisim

pagat, ky ligj do të shoqërohet edhe me diçka tjetër, që janë aktet nënligjore. Në aktet nënligjore, ne socialistët kemi pasur gjithnjë në vëmendje se ai që merr më shumë duhet të paguhet më shumë. Prandaj, për ne, zerimi i taksës për ata që janë me pagë deri në 40 mijë lekë, dhe ne synojmë ta çojmë këtë pagë në 45 mijë lekë në fund të mandatit tonë, taksimi duhet të jetë zero; duhet të përgjysmohet taksata për ata që marrin pagë deri në 50 mijë lekë, si dhe do të reduktohet taksata për ata që marrin një pagë nga 150 deri në 200 mijë lekë. Ky është një detyrim që ne e kemi ndaj punonjësve, për të bërë një progres në punën tonë të përditshme dhe për të rritur edhe pjesën e mirëqenies së familjeve tona.

Por të mos harrojmë se nga ana tjetër është shumë e rëndësishme ta kujtojmë, se gjatë vitit të kaluar ishte po ky kujdes që tregoi mazhoranca edhe për pensionistët. Pensioni i pensionistëve u indeksua dy herë, duke pasur parasysh inflacionin dhe masa e indeksimit ishte 9,5%, në krahasim me 6,7 që doli inflacioni kombëtar. Nga ana tjetër, një masë e rëndësishme që mori qeveria për pensionistët ishte edhe shpërndarja e të ardhurave të grumbulluara nga taksimi i dyfishtë që iu grumbullua ndërmarrjeve që prodhonin energji elektrike dhe iu shpërnda pensionistëve në pranverën e këtij viti. Nuk duhet të harrojmë që pensionistët, sikurse edhe biznesi i vogël, nuk paguajnë çmimin e rritur të energjisë elektrike. Për momentin, kur po marrim në konsideratë një politikë të tillë reformuese të pagave, natyrisht që e ardhura e disponueshme e familjeve shqiptare do të jetë në vëmendjen e qeverisë, sikurse është edhe e ardhura e disponueshme e familjeve me pensionistë, që janë në të gjithë territorin e vendit. Jo vetëm këtë, por duhet të kemi parasysh edhe një gjë tjetër, që gjatë këtyre viteve jemi munduar shumë të ulim edhe pabarazinë. Të dhënat nga INSTAT-i na tregojnë se pabarazia, që rrjedh nga koeficienti “Gini”, në harkun kohor të 3 vjetëve është ulur nga 34,3% në 33%, çka tregon se edhe këtu po bëjmë kujdes, që të mos i lëmë ata që kanë të ardhura të ulëta në nivele të tilla të sigurimit të mirëqenies, pasi meritojnë kujdes dhe vëmendje nga qeveria.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zoti Erion Braçe.

Të përgatiten zoti Leskaj dhe ministri i Drejtësisë, zoti Manja.

Erion Braçe – Të nderuar kolegë,
E nderuar drejtuese e seancës,

Ky Kuvend po merr sot vendimin më të rëndësishëm të tij në planin ekonomik, financiar, por edhe social të dekadës së fundit, që ndryshon fort shpërblimin e punës së gjithkujt: punonjësit të shërbimeve publike, nëpunësit të shtetit, shërbyesit të shtetit me përgjegjësi për sigurinë kombëtare, për sigurinë e jetës dhe të pronës së çdo qytetari, shërbyesit të shtetit dhe të qytetarit, me përgjegjësi për të bërë e dhënë drejtësi, shërbyesit të shtetit edhe në ato punë, që disa këtu në këtë sallë apo jashtë saj nuk i kanë bërë dhe nuk i bëjnë kurrë as si punë shtëpie, por, në krahun tjetër, i duan për punët e shtëpisë, dhe jo vetëm, i duan edhe për atë fjalinë e ndyrë që ishte deri dje edhe këtu, në këtë sallë: “Edhe një pastruese në filan institucion merr më shumë sesa ne”; një herë kjo, dhe, në anën tjetër: “Na e rritët neve dhe nuk ua rritët pastruesve rrogën”, thënë po përsëri këtu. Ky vendim ndryshon fort shpërblimin e punës edhe si pagë minimale, edhe si pagë mesatare, dy më të rëndësishmet këto në tregun e punës, por edhe në ekonominë kombëtare e familjare.

39 miliardë lekë më shumë do të jetë shpërblimi i punës në fund të vitit të ardhshëm për 129 mijë e 860 njerëz, e, prej këtyre, po aq familje do të kenë këto të ardhura më shumë.

99,34% e 39 miliardë lekëve do t’u shkojnë 99,9% të 130 mijë shërbyesve e nëpunësve të shtetit.

Paga minimale vendoset sot 40 mijë lekë dhe në vitin 2025 do të jetë 45 mijë lekë, por e kemi gjetur vetëm 22 mijë lekë 10 vjet më parë. Paga mesatare është rreth 71 mijë e 630 lekë, por sot vendoset të shkojë rreth 107 mijë e 257 lekë. E kemi gjetur vetëm 41 mijë lekë, 10 vjet më parë! Vitin tjetër do të jetë 4875 lekë për ditë pune, thuajse 40 euro në ditë, gjë që na bën shumë konkurrues në rajon, por edhe në çdo punë të zakonshme kudo jashtë, nga punët që bën edhe juristi i këtushëm, edhe ekonomisti, edhe bujku ata ku shkon.

Dua ta them e ta shpjegoj me durim, se vendimi që po marrim sot nuk është një instrument për të mundur kundërshtarit politik në këtë sallë, të sotmin apo të djeshmin, apo për t’u pasuruar ne, por një instrument për të qenë në betejë për punëtorët, për të zotët, për të duhurit,

për të gjithë ata që largohen nga ky vend nën efektin e pamundësisë këtu dhe, natyrisht, mundësisë kudo gjetkë, përfshirë rajonin, Europën, përfshirë edhe Amerikën, të gjitha në konkurrencë apo në betejë për punëtorë, edhe për punëtorët tanë.

Për të qenë në këtë betejë, me këtë vendim do t’u kalojmë 12,8 miliardë lekë shërbyesve publikë në arsim. Edukatorëve u shkon paga 87 mijë e 300 lekë, mësuesve në shkollën 9-vjeçare u shkon paga 99 mijë e 50 lekë; mësuesve në shkollat e mesme u shkon paga 110 mijë e 800 lekë, ndërkohë që në vitin 2013 këto rroga ishin: 32 mijë; 59 mijë e 600; 62 mijë e 300 lekë.

Do t’u kalojmë shërbyesve publikë në shëndetësi 5,76 miliardë lekë. Infermierëve u shkon paga 87 mijë e 118 lekë; mjekëve specialistë u shkon paga 174 mijë e 101 lekë; mjekëve të përgjithshëm u shkon paga 136 mijë e 672 lekë, ndërkohë që në vitin 2013 këto paga ishin: 28 mijë; 56 mijë; 51 mijë lekë.

Do t’u kalojmë shërbyesve publikë nën uniformë e gradë në institucionet e sigurisë, 4,75 miliardë lekë. Inspektorëve në polici u shkon paga (më e ulëta) 80 mijë e 500 lekë; kapterëve në ushtri u shkon paga (më e ulëta) 80 mijë e 500 lekë; inspektorit të parë në Gardë i shkon paga 80 mijë e 500 lekë; inspektorit të parë në burgje i shkon paga 80 mijë e 500 lekë; zjarrfikësve u shkon paga (më e ulëta) 74 mijë lekë. Ky është vendimi.

Politika është edhe më e madhe sesa kaq, bëhet edhe fiskale. Rrogat deri në 50 mijë lekë taten me zero për qind, ose zero lekë, dhe çdo lek më shumë në rrogë i nënshtrohet një tatimi progresiv, që bëhet edhe më i drejtë, deri te rroga më e madhe e gjykatësit më të shtrenjtë në këtë vend (ai e ka rrogën më të madhe), por ka edhe më shumë. Të ardhurat nga sipërmarrja e vogël, ajo me xhiro deri në 140 milionë lekë taten me zero lekë, madje edhe ata që janë të pasur janë thjesht të pasur, rrinë dhe arkëtojnë, taten pak dhe sheshtë, vetëm 10%. Ka nga këta edhe këtu, që bërtasin, siç ndodhi edhe sot, por si të pasur taten më pak, si deputetë taten më shumë. T’i themi disa të vërteta, apo jo? Populizmi meriton veç të vërteta!

Shikoni! E kam pafund të vështirë të them si vijon, në prezencë të pensionistëve, pa më të voglin diskutim (nuk kam gojë të flas para tyre), të cilët marrin të ardhurat më të ulëta sot në këtë

vend, që edhe pas këtij vendimi do të jenë po sërish njerëzit dhe familjet me të ardhurat më të ulëta në këtë vend, e, pa më të voglin diskutim, duhet të jetë qëllimi i vetëm i kësaj salle më pas.

Për të pasurit edhe në këtë sallë, nga sipërmarrja, për të tjerë këtu, që kanë burime të dyta dhe të treta të ardhurash nga pasuria, nga sipërmarrja në të gjitha dimensionet e saj ligjore e antiligjore, me tatime të paguara e me evazion fiskal të shquar, për cilindo që e folura rreth parasë e dërgon në haurin e histerisë, sinqerisht, jam kurioz të di: nëse Marksi do të ishte sot gjallë, a do ta kuptonte histerinë e atyre jashtë, qoftë edhe si marksist? Kam gojë të flas me pashë! Turpin nuk ma tregon dot kurrkush në këtë sallë!

Prej vitit 1990, kemi zgjedhur demokracinë të parën dhe jemi përpjekur ta bëjmë të funksionojë përmes institucioneve. Kemi bërë mirë, por, natyrisht, kemi bërë edhe keq, aq sa e kemi futur vendin në cikle që e kanë dëmtuar rëndë shoqërinë, e, mbi të gjitha, njerëzit që banojnë këtu. Pikërisht se është kështu, demokracia dhe institucionet e saj janë të parat; po, ne kemi pranuar me vullnet të plotë që drejtësia të jetë mbi ne për gjithçka, përfshirë korrupsionin në çdo nivel, përfshirë korrupsionin edhe mes radhëve të politikës, patjetër, por përfshirë korrupsionin edhe mes radhëve të drejtësisë, sepse duam të jemi të barabartë para ligjit.

Kemi vendosur drejtësinë mbi të gjitha. Ata sot marrin rrogat më të larta në këtë vend, por nëse doni që ky institucion të ketë integritet, të ketë dinjitet, të vendosë drejt e ndershëm, ndaleni linçimin mbi deputetët këtu edhe jashtë kësaj salle. Për fat të keq, kjo seancë nisi me linçim. Bëjeni deputetin të funksionojë, që Kuvendi të funksionojë, bëjeni Kuvendin të funksionojë, që demokracia të ketë një shtëpi të sajën!

Shikoni! Vetëm 0,66% e fondit prej 39 miliardësh, për të cilin ne vendosim sot (po e them edhe për qytetarët), shkon për deputetët; po e përsëris: 0,66%. Deputetët janë vetëm 0,1% e 130 mijë përfituesve nga ky vendim që po marrim sot; 0,1%, që përfitojnë 0,66% të fondit të përgjithshëm që materializon këtë vendim.

Shpresoj shumë që Marksi të na dëgjojë nga atje ku është dhe të gjithë marksistët të fillojnë të kuptojnë se sa banale është të bësh populistin në derën e Kuvendit apo edhe brenda Kuvendit.

(Bie gongu.)

Sikur koha ishte e pakufizuar!

Ermonela Felaj - E pakufizuar është për ministrat.

Megjithatë, përfundojeni, ju lutem!

Erion Braçe – Nga ajo rrogë bruto, që i ulërin në fytyrë çdo qytetari prej tri ditësh, 85 mijë e 0,3 lekë është vlera e ndalesave si tatime e sigurime, 47 mijë e 457 lekë është veç tatimi mbi të ardhurat dhe trefishohet nga ai që ne paguajmë sot. Dua t’jua kujtoj tatimin progresiv mbi këtë rrogë. Dua t’ju kujtoj favorin prej 10% për të pasurit që rrinë dhe arkëtojnë, që paguajnë shumë më pak se çdo deputet në këtë sallë, madje do të paguajnë shumë më pak edhe se çdo mësues dhe çdo pedagog me rrogat e reja jashtë kësaj salle.

Dëgjova ministren, që e quajti “reformë” vendimin e sotëm. Në fakt, duhet të bëhet reformë, pasi reformat kanë si qëllim produktivitetin. Deri tani po marrim vendim për të shpërndarë para, madje në administratë, pa pasur parasysh fare çmimin e punës.

Edhe një herë, më herët dëgjova ministren e Financave ta shquante këtë vendim si nxitje edhe për sektorin privat. Në fakt, ajo çka na duhet është produktiviteti, si tregues i qartë i eficiencës jo vetëm të administratës, por edhe të kësaj politike që po miratojmë sot. Sot nuk e kemi këtë, kemi një sistem rekrutimi në administratë, që bie shpejt nën presion, lëshon e lëshohet, degradon në klientelizëm, në korrupsion, në përtaci, në zvarritje dhe dështon të jetë konkurrues. Ka edhe një të keqe më shumë, është thelbi i kulturës se: “naj gjo tjetër, përtej rrogës, duhet me e marrë”. Ka edhe një të keqe fare: është një sistem i ngurtë, që duhet të hapet përkundrejt talentit, që është jashtë sistemit të administratës publike sot që flasim. Duhet të ndryshojmë fort këtu: “Rroga nuk mjafton”, ndaj duhet një sistem i ri, i mbështetur fort te produktiviteti dhe që matet me rezultate për cilindo.

Këtu kam dy sugjerime, pa më të voglin diskutim.

I pari lidhet me distancën e madhe në vlerësimin e punës nga drejtuesit te nëpunësit (është e paarsyeshme) në administratë, agjenci ligjzbatuese, ndërmarrje shtetërore, shoqëri aksionare me 100% kapital shtetëror.

Sugjerimi i dytë është që duhet kufi për rrogat e drejtuesve të korporatave publike. Produktiviteti duhet të udhëheqë edhe aty (në korporatat publike). Nëse i referohen ligjit “Për

shoqëritë tregtare”, që na u tregua në komision si kufizues, pikërisht për të ndërmarrë një iniciativë për të vënë kufijtë mbi rrogat e drejtuesve të korporatave publike, atëherë të sillen si të tillë, si shoqëri tregtare në tregun e punës dhe të paguajnë me çmimin real të punës edhe punëtorin në secilin prej korporatave publike.

Në anën tjetër, nëse i pranojmë të gjitha efektet pozitive të këtij vendimi, shpërblim më i mirë i punës, të ardhura më të mëdha dhe konsum më i lartë, duhet të kuptojmë që para kemi edhe një sfidë shumë më të madhe, gjithashtu, sfida: çmimet. Çmimet janë problemi më i madh që kemi tani, pasi po i japim rrugë çështjes së të ardhurave për çdo familje. Posaçërisht çmimet e larta, që nuk ndryshojnë, janë një lajmës i fortë dhe i qartë i një tregu të kapur dhe fare konkurrues, në marrëveshje edhe për çmimet, edhe për fitimet. Inflacioni i importuar po bie, çmimet jo. Duhet t’i bëjmë tregjet të funksionojnë, duhet të bëjmë që ekonomia e tregut të funksionojë lirshëm, që të konkurrojnë çdo operator në treg, ata që janë apo të tjerë që duhet të hyjnë në treg, me qëllim që çmimet të shkojnë aty ku po i çon ekonomia përmes inflacionit në rënie.

Kjo që po ndodh sot në tregje me çmimet, natyrisht që është përtej ekonomisë, sepse, po të ishte ndryshe, gjithçka do të funksiononte në zbritje, në uljen e çmimeve, veçanërisht të produkteve të fabrikuar, të përpunuara dhe të importuara, çmimet e të cilave në tregjet ndërkombëtare po vijnë duke rënë. Në qoftë se nuk e bëjmë ekonominë të funksionojë në të gjitha dimensionet e saj (unë po ndalem në dy aspekte), në atë të konkurrueshmërisë, që, si pasojë, sjell çmime më të ulëta për qytetarët kudo që ndodhen në këtë territor, pa më të voglin diskutim që vendimi që po marrim sot do të vlejë shumë pak, do të çojë para te konsumi, konsumi do të çojë para në ato tregje që janë të kapura nga 3-4 operatorë, që na e solli në vëmendje shumë qartë kriza e një viti më parë dhe veçanërisht funksionimi i bordit të ushqimeve. Në rast se ne do të vazhdojmë ta ushqejmë ekonominë me çmime të larta, pa më të voglin diskutim që edhe politika e sotme do të dështojë, e, në krahun tjetër, unë nuk besoj se sektori privat do të udhëhiqet lehtësisht nga vendimi që ne po marrim sot, për të rritur rrogat për punëtorët e tij. Nuk e besoj këtë.

I dëgjova shifrat këtu pak më parë dhe, natyrisht, është tregues i qartë që përfitimi në sektorin privat është rritur, por ajo që duhet të funksionojë është politika fiskale edhe për ta dhe ku lufta kundër evazionit fiskal në aktivitetin e tyre, duhet të jetë prioritare. Thjesht të besosh në ndërgjegjen e gjithkujt atje matanë, që prioritet në biznesin e tij ka përfitimin, fitimin, madje me norma të larta, është utopi. Ajo që duhet bërë është kontrolli fiskal mbi gjithsecilin prej tyre. Patjetër, këto të dyja bashkë mund ta bëjnë këtë politikë të funksionojë dhe të na mbajnë betejën për të mbajtur punëtorët këtu, më të mirët, më të zotët dhe ata që duan t’u shërbejnë vetes dhe vendit, pikërisht, nga këtu.

Shumë faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Braçe!

Ka ndodhur një zëvendësim, me marrëveshjen e deputetëve, në listën e diskutantëve, kështu që tani fjalën e ka zoti Berisha.

Sali Berisha – Të dashura qytetare dhe qytetarë, që ndiqni këtë seancë,

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Zonja drejtuese e seancës,

Zonja Kryetare e parlamentit,

Së pari, jam këtu në emër të qindra dhe mijëra qytetarëve shqiptarë, të cilëve, me mekanizmat më kriminalë, të hapur dhe nën dorë, iu konfiskua vota dhe vullneti i tyre i lirë. Kjo farsë elektorale do të hyjë në histori si faqja më e zezë në Europë, pas rënies së Perdes së Hekurt. Në këtë farsë, e cila pati si fitimtarë narkoshtetin dhe kartelet e drogës, narkoqeveria e Edi Ramës, për herë të parë në 32 vjet, përdori zarfin elektorale me 50 mijë lekë për çdo pensionist, 683 mijë gjithsej, sikundër shpalli dhe realizoi rritje rrogash në mes të fushatës elektorale, me qëllimin e vetëm blerjen e votës.

Në këtë fushatë elektorale, për të gjithë ata që thonë se rezultati ishte i thellë dhe bëjnë avokatinë e megakrimit elektorale, them vetëm kaq: partia e blerjes së votës, aleati kryesor i kësaj partie, Tom Doshi, e rriti mbështetjen e tij me zarfet nën dorë 240% apo 2,4 herë. Sigurisht, Tom Doshi nuk ka as një të qindtën e pasurisë që administron Edi Rama, nuk ka as një të mijtën e mekanizmit të shpërndarjes së parave që disponon Edi Rama dhe, në këtë kontekst, blerësit më të mëdhenj të votave nën dorë janë Edi Rama me

ministrat e tij të krimit. Atyre, të cilët besojnë se blerja ishte jo e atillë sa të ndryshojë rezultatin, u them se vetëm sa mbroni blerjen dhe kontrollin e votimeve nga qeveria. Në rast se Tom Doshi e rriti blerjen me 240%, po Edi Rama me sa për qind e rriti, duke shpërndarë 33 milionë euro në zarf, ditën për diell, te 678 000 pensionistë? Cili vend në botë ka bërë një akt në mes të procesit zgjedhor?

Edi Rama ia doli të angazhojë të gjitha bandat në Shqipëri, t'i bashkojë ato me presione dhe trysni të tmerrshme ndaj qytetarëve, të shpërndajë qindra milionë euro, me të cilat rrëzoi përtokë monedhën europiane. Nuk po llogaris këtu qindra milionë të tjera, të përdorura nga 1 janari deri më sot, për asfalte elektorale, për zhavorre elektorale, për mijëra e mijëra legalizime për qëllime elektorale, terrorin dhe tmerrin që u ushtrua mbi bizneset dhe qytetarët, avokatinë e shpifur, për të cilën pagoi miliona, në një propagandë të pashembullt me të cilën kërkohet apo bërtitet, thirrej haptas: “Rroftë hajduti! Rrofshin kriminelët elektorale! Lavdi partisë së krimit! Lavdi vjedhjes së votës!”

Nga ana tjetër, u kalua në sulme për likuidim fizik të eksponentëve të opozitës në Vaun e Dejës, në Lezhë, në keqtrajtme barbare të komisionerëve të saj. Ky parlament qëndron mbi krimin, çdo ditë që pajtohet me një situatë të tillë.

Ndaj, edhe unë jam këtu për të dënuar me ashpërsinë më të madhe këtë farsë të turpshme zgjedhore, të pandodhur kurrë më parë, për t'u bërë thirrje shqiptarëve të marrin në dorë fatin e lirive tona, për t'u përlur me nderimin më të madh përpara atyre mbi 500 mijë burrave dhe grave që nuk pranuan të trysnohen, të blihen dhe të shiten, por qëndruan besnikë të idealeve të tyre.

Zonja dhe zotërinj,

Keni sjellë këtu një ligj, të cilin, pavarësisht nga të gjitha këto kundërshti, absolutisht do të doja ta votoja, sepse kam qenë, jam dhe mbetem gjithnjë për rritjen e rrogave dhe të pensioneve. Kam bindjen më të thellë se vetëm me gjysmën e atyre që ju vidhni çdo vit, rrogat mund të dyfishohen dhe kjo jo nga të dhënat e mia, por nga të dhënat e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Unë nuk e votoj kurrë këtë ligj, sepse ky ligj është një mashtrim i tmerrshëm, pasi institucione të pavarura kanë përlogaritur dhe gjetur se, ndërsa dyfishoni rrogat e zyrtarëve të lartë, *de facto* rrisni me 1% ose zbrisni me 1%, në raport me

inflacionin, rrogat e mësuesve, rrogat e arsimit parauniversitar, rrogat e policëve, rrogat e ushtarakëve, përveç Gardës, e cila rritet me 3-4%.

Pra, ju kryeni një akt të turpshëm: për vete rrisni rrogat, për të tjerët bëni një indeksim. Dhe, çfarë indeksimi?! Indeksim thjesht me inflacionin 1-vjeçar të rritjes nga viti 2022 në vitin 2023 dhe, me të gjithë këtë indeksim, përsëri në raport me inflacionin, disa kategori më në nevojë detyrohen të mbeten me minus.

Propozuam të vendosim minimumin jetik në këtë periudhë, kur sirenat e mjerimit po ulërijnë në të gjithë vendin, t'i japim çdo shqiptari 200 euro, llogari kjo e Avokatit të Shtetit, jo e opozitës, jashtë çdo politike. Duke i dhënë 200 euro çdo qytetari, ne nxjerrim nga varfëria ekstreme çdo shqiptar. Asnjë shqiptar nuk meriton sot të jetojë në varfëri ekstreme. Njerëzit janë të varfër, sepse i varfëron qeveria, nuk kanë lindur të varfër, i vjedh qeveria, i keqtrajton qeveria. Me 200 euro çdo pensionist, çdo qytetar me ndihmë ekonomike, çdo të papunë, secilin, ne e nxjerrim nga humnera e varfërisë ekstreme që quhet “mjerim”. Nuk e nxjerrim nga varfëria, por nga ajo më e keqja e nxjerrim, kurse ju rrisni rrogat e larta, *top-down*, nga sipër-poshtë dhe ato poshtë shkojnë poshtë e më poshtë. Ky është cinizëm, kjo është pashpirtësi!

Ju nuk keni asnjë lidhje me qytetarët. E vetmja lidhje që keni me ta është t'u vidhni votat, si kriminelë elektorale, fantazma nate që kaloni nga njëri komunitet në tjetrin, duke kërcënuar dhe vjedhur votën, ndaj dhe e bëni këtë ligj sot. Ligj i turpshëm, ligj cinik! Ejani ta bëjmë ligjin, t'i rrisim rrogat, të fillojmë nga poshtë- lart. Kështu fillohet, sepse nuk jemi ne...

Ermonela Felaj – Zoti Berisha, faleminderit!

Koha në dispozicion ka përfunduar dhe ju është lejuar edhe një minutë shtesë.

(Zoti Sali Berisha ndërhyr pa mikrofon.)

Zoti Berisha, ju dhashë edhe një minutë shtesë dhe ju njoftova paraprakisht të përfundonit, kështu që ju lutem! Jeni pa mikrofon.

(Zoti Sali Berisha ndërhyr pa mikrofon.)

Zoti Berisha, nuk do të bllokujmë asnjë seancë, sepse seancat janë për të punuar deputetët, kështu që lirojeni foltoren, që të mundësojmë fjalën e deputetëve të tjerë! Zoti Berisha, ju lutem!

Fjalën e ka kërkuar ministrja, zonja Spiropali.

Ndërkohë, kolegë, ju njoftoj se Presidenti i Republikës ka dhënë pëlqimin për dekretimin e menjëhershëm të paketës së ligjeve, për shkak edhe të largimit të tij për një vizitë jashtë vendit. Në orën 14:30 ne do të votojmë përpara se të përfundojë seanca, kështu që secili nga kolegët të shohë edhe radhën e diskutimeve të tij, sepse në atë orë do të ndërpriten diskutimet për të kaluar në votim.

Elisa Spiropali – Ka një gisht që tundet kërcënueshëm prej së paku 57 vjetësh në sytë e shqiptarëve; për çerek shekulli, si gishti i komunistit “sekretar partie” dhe për 32 vjet në vijim si gishti i kryetarit që mbajti grusht partinë e tij. Ky është gishti i Sali Berishës, i parafolësit, që kërcënon, akuzon, shantazhon dhe mashtron, gishti që premton të nxjerrë syrin e të tjerëve, në interes të vetullave të tij. Ka 57 vjet që ky burrë, dikur zelltar i regjimit dhe tani regjisor i çdo ekstremizmi në vend, të mirën dhe të ligën, të drejtën dhe të gabuarën, të ndershmen dhe të pavlerën, virtytin dhe moralin, i mat vetëm me një kut vetjak: “Çfarë lidhje kam unë me çfarë bëj unë?” Si kurrë më parë, i rikthyer në krye të një projekti personal, edhe për hall personal, Sali Berisha e udhëhoqi partinë e tij, edhe gjysmën tjetër, në një humbje që do të turpëronte çdo disfatist dhe që e ka bërë çdo disfatit politike të kujtdo tjetër përpara tij, të ngajjë si fitore.

Hupe, Sali, hupe! Shqiptarët të refuzuan nga Veriu në Jug, nga Lindja në Perëndim, sepse vetëm ti nuk e ke kuptuar se shpresa jote për rilindje ka perënduar njëherë e mirë. Të rrëzoi Shkodra dhe të mohoi Tirana, të braktisi Tropoja dhe të dha munxët Vlora, të nëmën Elbasani, Durrësi e Kamza dhe nuk i dhanë nam nishanit tënd të humbur Gjirokastra, Lezha, Malësia e Madhe, Korça, Dibra, Berati, Vau i Dejës e gjetkë, të gjitha, dhe të refuzuan, si kujtim të lig, plot 95% e shqiptarëve. Të kishte mbetur vetëm një rrugë për t’u ndjekur, nëse do të të kishte ngelur një fije njerëzillëku, meqë e përmende, sepse burri thyhet, por nuk përulet, por ti edhe një herë, si përherë, iu përule vesit dhe thirre në apel vesin tënd të vjetër, që të mos pranosh çka di e gjithë Shqipëria, por të shesësh si realitet dynjanë tënde paralele.

“Më vodhën narkoshteti, krimi; makineria shtetërore; aktivist; patronazhist”, lumi i hershëm i justifikimeve të tua mediokre, tanimë një rrëke edhe më mediokre dhe një përrua psikik që ndjell

keqardhje, u derdh sërish në të gjithë Shqipërinë, për të përmbysur tryezën e rezultateve.

Hupe, hupe! Por kjo është humbja jote personale, sepse Serreçi dhe Perashi, Parruca dhe Xhabija, Dërguti dhe Zdralja, Rusi dhe Dudasi, Gjuhadolli dhe Ndocej, Skënderbegu, Bahçallëku, Zogaj të bënë të derdresh mendsh në Zall të Kirit. *Ciao e selam* nga Postriba e Guri i Zi, Dajçi, nga rrethinat, nga Bërdica, Ana e Malit, Shala, Shoshi, Pulti, Velipoja! *Hi e selam*, Sali e të tjerët, nga e gjithë Shkodra e shkodranët që i fyeve dhe i poshtërove për herë të fundit, bashkë me këta që u ke humbur vulën.

U the: “Të shitur”; u the: “Pengje”; u the: “Banditë”. Ty, njeriut që ke mbajtur peng Shkodrën për ambicien tënde dhe për të shitur pushtetin tënd sa më shtrenjtë, ne, kjo qeveri, socialistët shqiptarë, Edi Rama, si kryetar partie, Benet Beci, si kryetar bashkie, unë, si drejtuese politike e qarkut të Shkodrës, të lemë një takim, nuk është sfidë, është ftesë, jo mbas katër vjetësh, por vetëm mbas 24 muajsh të vish në Shkodër dhe ta shohësh “Zojën Shkodër” të zgjuar nga letargjia, ku e kanë lënë për tri dekada dallkauklëku, parazitizmi dhe padija e qeverisjes suaj. Nxito të vish, sepse pas katër vjetësh nuk do ta njohësh Shkodrën, nëse nuk je bërë *non grata* deri atëherë nga njerëzit, që i ke mpirë me përrallën e antikomunizmit, ti, komunisti i fundit shqiptar.

Tani, ti dhe rrethi yt pa parti, katandisur si një trumcak në dimër, rrotullohesh në pluhur dhe bën banjë pluhuri për të ngritur furtunën tënde të radhës dhe për t’u hedhur pluhur në sy shqiptarëve për cilësinë e zgjedhjeve. Aferim për energjinë, por as Muli, as Noka e as Paloka nuk të besojnë në çfarë thua, por të ndjekin, se nuk kanë çfarë bëjnë dhe s’dinë si të ta thonë. Ti, antifaraoni i ditëve të sotme, që, ndryshe nga çfarë thotë historia, je i gatshëm të shohësh të varrosen nën piramidën e pushtetit tënd iluziv të gjithë ndjekësit, edhe të sinqertët, që vijnë pas nga halli dhe malli, idealistë naivë dhe llogaritarë cinikë, ai grusht gjithmonë e më i vogël njerëzish që dëgjojnë, por nuk i besojnë marrëzitet e tua. 22 mijë vota më pak në Shkodër, nga Gjuhadolli, Dukagjini e deri në Velipojë. Në të gjitha kutitë njësoj, Sali, nuk ka krim që i blen, nuk ka bandit që i kërcënon. Hupe, Sali, hupe, por ti nuk ke marre. Ke qenë qederi i këtij vendi për tri dekada dhe ky vend i dha nder vetes që të refuzoi. Ti thua:

“Mbas meje, qameti”, e ke thënë dikur, e thua edhe sot, por ti je sot vetë ku thërret qameti. Hupe, por për ty ky nuk është problem, nga fitorja në fitore të kanë mësuar të parët. Turpi nuk bën konak tek ty.

Shëndet, Sali!

Mos harro të shijosh perëndimin e diellit. Edhe pse nuk e meriton bukurinë e saj, mund të vish në Shirokë a në Bunë kur të duash.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zoti Leskaj.

Të përgatitet ministri i Drejtësisë.

Bujar Leskaj – Në fakt, unë do ta filloj me një vërejtje për një pjesë të parafolësve: ju lutem, përqendrohuni tek tema dhe, ju lutem, mos flisni nga mbrapa, sepse na shqetësoni!

Modestisht, në këndvështrimin tim, pa atakuar asnjë nga mendimet e deputetëve parafolës, qoftë të pozitës, qoftë të opozitës, 10 arsyet pse ne, deputetët, në veçanti ne deputetët e opozitës, nuk duhet ta votojmë këtë pseudopaketë, janë të natyrës politike dhe ekonomike. Unë mendoj se e kam shumë mirë, megjithatë jam gati që për secilën nga këto të debatoj me secilin prej jush në këtë seancë, ose në seanca të tjera.

Tek arsyet politike, e para është kjo: me këtë arrogancë që ka marrë kjo mazhorancë dhe ky Kryeministër, ne si opozitë vërtet nuk kemi parë gjë akoma. Ne duhet ta fillojmë që në rrënjë zgjidhjen e problemit. Ne nuk duhet të votojmë politikisht asnjë ligj që sjell kjo qeveri, ky sekt, kjo mazhorancë, për sa kohë ne si Kuvend nuk i zhbëjmë ndryshimet kushtetuese të muajit prill të vitit 2008, ndryshime kushtetuese për të cilat ne kemi përgjegjësi të gjithë, edhe deputetët e PD-së, që ishim në pushtet atëherë, edhe deputetët e PS-së. Me këto ndryshime kushtetuese, praktikisht me ndryshimin që bëme te mocioni i besimit dhe mosbesimit të Kryeministrit për sa i përket sistemit të zgjedhjeve, vendosjes së kandidatëve për deputetë nga kryetarët e partive dhe që ne prodhuam një kryeministër të fortë e cenuam figurën e Presidentit e të tjerë, praktikisht kemi kaluar në një republikë kryeministore. Kjo republikë edhe me burra shteti rrezikon, jo më me Kryeministrin tonë, që është i zoti, shumë i zoti, lideri global, por është burrë pushteti dhe jo burrë shteti. Ne si opozitë nuk duhet të votojmë asnjë ligj, për sa kohë nuk do të fillojë puna për këto.

Arsyeja e dytë politike: dihet nga të gjithë shqiptarët, edhe ne opozitarët e kuptojmë dhe e ndiejmë që në vitet 2020, 2021 me të ashtuquajturën reformë zgjedhore (ajo që u firmos në oborrin e një ambasade me bekimin e ndërkombëtarëve) Rama u tall më vonë, u tall me deputetët e “kërperatave”, u tall kur votoi Kodin Zgjedhor. Dhe ne nuk duhet të votojmë asnjë ligj, në rast se nuk ulemi seriozisht për një reformë të plotë zgjedhore, e cila duhet të përfshijë të konfirmuara listat e hapura, të drejtën e partisë për koalicion, faktin që deputetët të mos i caktojnë totalisht, absolutisht kryetarët e partive, por, mbi të gjitha, përmes kësaj reforme të kemi një ligj të drejtë, një ligj të barabartë, i cili i siguron frymëmarrje opozitës, atë frymëmarrje që i sigurohet në të gjitha vendet e botës. Reformë zgjedhore me mjeshturin për të keq, Damian Gjickurin, nuk mund të ketë.

Arsyeja tjetër politike është (për deputetët e opozitës): në rast se ne e votojmë pro këtë paketë zgjedhore, nuk bëjmë gjë tjetër vetëm se shkojmë në një linjë me korrupsionin parazgjedhor dhe zgjedhor të Ramës, i cili premtoi rritjen e pagave, shtesën 5000 lekë për 690 000 pensionistë, të cilën e provokoi, e shpërndau publikisht, e shpërndau materialisht përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore të 14 majit, zgjedhje, të cilat ne të gjithë i dimë si u bënë dhe si u zhvilluan, pra, në njëfarë mënyre, ne i certifikojmë veprimet joligjore, për mendimin tim dhe të shumicës së pjesës së shëndoshë të shqiptarëve, të Kryeministrit dhe të drejtuesit të koalicionit të së majtës në pushtet.

Pjesa e dytë, kolona e dytë e arsyeve që kam unë, janë arsyet social-ekonomike.

Kalojmë te pika e katërt: ne nuk duhet të votojmë asnjë rritje pagash, në rast se në Shqipëri nuk përcaktohet minimumi jetik. Mua më vjen mirë që dje e përmendi kryetari i Partisë Demokratike, zoti Berisha, por më vjen mirë që personalisht e kam ngritur në këtë Kuvend dhe kam zhvilluar një interpelancë me ministren Manastirliu, ku kam theksuar me forcë domosdoshmërinë e përcaktimit të minimumit jetik. Duhet përcaktuar minimumi jetik dhe pastaj ne të vazhdojmë me reformën e pagave dhe të pensioneve. Për këtë nuk do të zgjatem këtu, pasi i kam komunikuar në interpelancë.

Pika e pestë: me këtë rritje pagash, me këtë formulë që, çuditërisht, u zhvillua këto ditët e fundit, ne si deputetë të opozitës, por edhe të

mazhorancës, nuk bëjmë asgjë tjetër veçse thellojmë pabarazinë shoqërore, pavarësisht se unë jam dakord me atë që tha deputeti Braçe, i cili është i saktë në shifra, që 0,1% e deputetëve përfitojnë 0,66% të shumës, por kjo nuk do të thotë që ne të lejojmë që punonjësit, të cilët janë në frontin e parë të shërbimit publik, si mësuesit, policët, zjarrfikësit, mjekët, infermierët, të përfitojnë në këta muaj rritjen 7%, e cila, po të korrektohet me inflacionin (unë po e marr në variantin më të mirë të INSTAT-it zyrtar, 5%) shkon në një rritje prej 2%. Rritja për pjesën tjetër, pra për zyrtarët e nivelit të lartë, drejtuesit e institucioneve të varura dhe të pavarura, që të gjitha, në fakt, janë institucione që kanë një emër dhe një drejtues, Edi Rama, të përfitojnë 40-45 herë më tepër! Në këtë mënyrë ne i shërbejmë maksimalisht thellimit të kësaj pabarazie shoqërore.

Pika e gjashtë: pagat deformatojnë piramidën shtetërore të shpërblimit. Ne kemi ecur dhe llogaritëm koeficientin 0,7, ose 0,60 e ca të pagave tona, ose të pagave të drejtuesve të lartë, në raport me pagën e Presidentit, por unë mendoj se e kemi gabim, sepse ky koeficient duhet të përgjysmohet, pasi Presidenti është një dhe vetëm një, po të doni, edhe në respekt të postit, natyrisht mund të shtohen edhe Kryetarja e Kuvendit dhe Kryeministri dhe stop këtu, sepse pastaj duhet të ketë një diferencë të theksuar, të konsideruar. Nuk na justifikon ne ai koeficienti që ta rritim këtë vlerë dhe të ndikojmë e të japim një perceptim shumë negativ edhe për veten tonë, por edhe te qytetarët shqiptarë. Nuk kam asgjë për populizëm, por është e drejtë e çdo deputeti në ato që ka parashtruar.

Pika e shtatë: për mendimin tim kjo është një rritje pagash pa planifikim afatmesëm buxhetor. Kur miratuam projektbuxhetin e vitit 2023 në fund të vitit 2022, në planin afatmesëm të buxhetit të shtetit për vitet 2023-2025 nuk është përmendur nga Ministria e Financave kjo reformë e madhe. Mungesa e parashikimit (shtetet serioze i parashikojnë ato) dëshmon se kjo vetëm reformë nuk mund të quhet, por ishte një veprim pragmatist, një veprim i zgjuar në kurriz të votës së qytetarëve shqiptarë, një veprim manipulativ i Kryeministrit të Shqipërisë, që e hodhi këtë ide me guxim dhe aventurë, siç di ai, përpara zgjedhjeve dhe vazhdoi e elaboroi gjithë kohës.

Pika e tetë: nuk mund të ketë rritje pagash pa analiza të thelluara ekonomike dhe pa realizuar paraprakisht censin e popullsisë. Unë e kam theksuar edhe herë të tjera në Kuvend. Ne kemi 2-3 vjet që jemi larguar nga detyrimi që kishim për të realizuar censin 10 vjet pas realizimit të censit të vitit 2011, dhe po citoj këtu, për ndonjë që nuk e njeh rëndësinë e censit apo mund të bëjë ironi, një gazetar shumë serioz, opinionist, Ben Andonin: “Censi i popullsisë (sipas literaturës) na tregon se kush jemi dhe ku do të shkojmë si komb, por edhe i ndihmon komunitetet tona të përcaktojnë se ku të ndërtojmë, gjithçka u nevojitet, nga shkolla te supermarketet dhe nga shtëpitë e deri te spitalet. Censi ndihmon qeverinë si të shpërndajë fondet dhe ndihmën për strukturat shtetërore dhe lokale. Censi duhet realizuar dhe më tej qeveria të vazhdojë me reforma, të cilat duhet të jenë dhe, në këtë rast, certifikohen si reforma të studiuara dhe të mirëstudiuara”.

(Bie gongu.)

Pika e dhjetë, ndoshta më duhen edhe 20 sekonda: për mendimin tim, për ne, si deputetë të opozitës, me këto që thashë më sipër nuk kisha asnjë frymë populiste dhe e neveris frymën populiste; të votosh këtë paketë, do të thotë të biesh në kurthin e Ramës.

Të dashur deputetë,

Pasi ta votoni këtë paketë, mos i kërkoni llogari Ramës: “Jo i bleve votat, jo i shite, jo i provokove qytetarët shqiptarë, jo pensionistët, jo fshatarët, jo qytetarët, jo personat me aftësi të kufizuara, jo kjo, jo ajo, jo tallavaja, jo tepsia”. Në rast se ne bëjmë këto dhe vazhdojmë në apati, kështu siç jemi, ne nuk bëjmë gjë tjetër, por konfirmojmë paaftësinë tonë në sytë e qytetarëve shqiptarë. Ne, minimalisht, duhet të ndjekim dhe të respektojmë traditat më të mira të parlamenteve perëndimore, ku ka votime që e përcaktojnë pagën, siç është, dinjitoze. Në këndvështrimin tuaj keni të drejtën tuaj dhe argumente, por kjo bëhet për deputetët e legjislaturës tjetër dhe bëhet pasi të reformohet i gjithë sistemi ynë, pasi reformohet administrata jonë, nuk e zhvillon në këtë mënyrë, ose të respektojmë...

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Leskaj!

Bujar Leskaj – Edhe 20 sekonda.

Ermonela Felaj – E keni kaluar disafish 20-sekondëshin. Kështu që, ju lutem, zoti Leskaj!

Besoj se u kuptua qëndrimi juaj. Kishit mjaftueshëm kohë dhe e parashtruat qëndrimin tuaj.

Zoti Gjijnuri, a e dëshironi fjalën për replikë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka ministri i Drejtësisë, zoti Manja.

Ulsi Manja – Të nderuar kolegë,

Unë nuk mendoj se sot është dita dhe seanca plenare, ku ne do të duhet të ndalem. Sot çdo diskutim dhe qëndrimi politik do të duhet të përkthehet me votën pro të të gjithë deputetëve të parlamentit për një paketë ligjesh që çojnë në rritjen e pagave për qytetarët shqiptarë, të cilëve ne me votën tonë sot do të duhet t'u japim mundësinë që të përfitojnë nga rritja e pagave. Ka seanca dhe ditë të tjera, ku ne do të duhet të merremi dhe të bëjmë politikë, po të doni ju edhe për zgjedhjet e 14 majit, për të cilat në më pak se dy javë shqiptarët folën, por nuk është kjo dita.

Unë nuk i kuptoj disa kolegë në këtë sallë, të cilët kërkuan që të mblidhet parlamenti edhe në seancë jashtë radhe para zgjedhjeve të 14 majit që ne ta votonim paketën e ligjeve për rritjen e pagave dhe, çuditërisht, sot, po të njëjtët njerëz, bëjnë thirrje që të mos votohet kjo paketë ligjesh dhe ta shtyjmë për një moment të dytë. Shqiptarët duhet ta kuptojnë se sa seriozisht dhe sa i dhimbsen kësaj klase politike, kësaj race politikanësh, qytetarët shqiptarë dhe hallet që kanë qytetarët shqiptarë.

Unë nuk kam pse i bie rrotull kësaj gjëje, por dua t'i them zotit Berisha: mos dëgjo vetëm zërat e brendshëm për zgjedhjet e 14 majit, që të mblidhen në kokë, as servilët që të rrinë afër dhe të thonë se keni fituar më 14 maj, por reflekto dhe dëgjo edhe zërat e jashtëm të atyre demokratëve qëndrestarë në këta 32 vjet, të cilët të kanë dhënë votën dhe vazhdojnë të ta japin votën. Meqenëse tani, në këtë moshë, doktori është fansi i TikTok-ut, dua t'i them: dëgjo Lek Plepin në Shkodër, por edhe atë Vrenozin në Korçë, sepse shprehin shpirtin e demokratëve të lirë dhe të ndershëm. Këta janë ata, për të cilët ke nevojë dhe nga zëri i këtyre do të fillojë ringritja e së djathtës në Shqipëri, nuk do të fillojë nga zërat e brendshëm dhe nga servilët politikë këtu në Tiranë që të rrinë rreth e rrotull. Gjithsesi, kjo është puna juaj dhe nuk na përket neve.

Ne sot si mazhorancë kemi sjellë në Kuvend një paketë ligjesh për rritjen e shumëpritur të pagave nga shqiptarët. Dua t'i falënderoj kolegët e mi të mazhorancës, sigurisht, dua të falënderoj të gjithë kolegët e mi në kabinetin qeveritar, në mënyrë të veçantë, sepse është dita për ta falënderuar, Kryeministrin e vendit, Edi Rama, që e ka pasur qëndrim konstant nga viti 2013 rritjen e pagave për punonjësit e administratës publike, pse jo edhe në sektorin privat. Sigurisht, do të kishim dashur të ishte një rritje më e madhe, të ishte bërë edhe më parë. Unë nuk jam ekonomist. Sigurisht, ekspertët, kolegët e mi, kanë folur e kemi ardhur në këtë pikë dhe është në nderin tonë dhe të këtij Kuvendi që sot të japim votën pro, sepse si ministër i Drejtësisë edhe unë kam fushën time të përgjegjësisë: punonjësit e Policisë së Burgjeve presin të marrin rritjen e pagave me efekt prapaveprues që nga 1 prilli, por edhe stafet e burgjeve, mjekët dhe infermierët, që shërbejnë në burgje, presin të marrin rritjen e madhe të pagave. Të nderuar kolegë, nuk është pak që një shef shërbimi, një mjek i përgjithshëm në sistemin e burgjeve, i cili sot merr 86 mijë e 920 lekë, të marrë 136 mijë e 900 lekë; nuk është pak për një vend si Shqipëria. Një infermier merr 47 mijë e 700 lekë, pasi ne të japim votën këtu në këtë sallë të parlamentit, do të marrë 51 mijë e 100 lekë. Rritje të qenësishme do të marrin edhe punonjësit e Policisë së Burgjeve, gradë për gradë, dhe tashmë ata e dinë dhe presin votën tonë nga kjo sallë, një orë e më parë, dhe më vjen mirë që do ta votojmë në orën 14:30. Është edhe një shprehje: vota jonë sot është një nder, është një borxh që ne ua kthejmë qytetarëve tanë, të cilët na dëgjojnë çdo ditë të enjte në këtë sallë me një retorikë politikë, me një fjalor, të cilin nuk e meritojnë qytetarët shqiptarë, kështu që të paktën sot të japim votën të gjithë bashkërisht.

Sot në këtë paketë është një ligj i rëndësishëm, që lidhet me rritjen e pagave, pra ka të bëjë me statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Është një ligj që kërkon shumicë të cilësuar, kërkon 84 vota, dhe unë jam i bindur se në këtë sallë janë votat. Kur e bëjmë reformën në drejtësi, një nga shtyllat kryesore të reformës në drejtësi për të siguruar pavarësinë dhe efektshmërinë e sistemit të drejtësisë ishte edhe një trajtim financiar dinjitoz për gjyqtarët dhe prokurorët. Sigurisht, në vitin 2021, për shkak të problemeve që lindën me zbatimin e formulës për

pagat e magistratëve, në lidhje me mënyrën e përllogaritjes dhe pagën referuese, Kuvendi i Shqipërisë bëri një ndryshim të ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, por Unioni i Gjyqtarëve e atakoi këtë ndryshim ligjor në Gjykatën Kushtetuese dhe në nëntor të vitit 2022 Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi normën e ndryshuar në vitin 2021, duke përcaktuar pagën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe duke i lënë në diskrecion ligjvënësit të përcaktojnë një pagë referuese për magistratët. Gjykata Kushtetuese i thotë ligjvënësit që, nëse do të mbajë këtë sistem aktual referimi që kemi, pra referimin të nëpunësit civilë apo do t’u referosh një shtyllë tjetër nëpunësve të lartë shtetërorë, është në diskrecionin dhe tagrin e këtij Kuvendi. Këto ndryshime që do të kalojmë sot, së pari, sigurojnë zbatimin me korrektësi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk cenojnë të drejtat e fituara të magistratëve në raport me pagën. Këtu duhet të jemi shumë të qartë. Për këtë gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë e dinë se Kuvendi sot do të votojë një ndryshim që nuk e cenon pagën që ata kanë fituar me ligj, por edhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa lidhur me sistemin e referimit, ne sot për ta respektuar pushtetin gjyqësor dhe dinjitetin e gjyqtarëve, u kemi bërë një referim të paga e Presidentit të Republikës. Ju e dini se në Republikën e Shqipërisë, edhe sipas ligjit të buxhetit, Presidenti i Republikës është personi më i paguar në Republikën e Shqipërisë. As më shumë dhe as më pak, me ndryshimin që ne propozojmë sot në ligjin e statusit, kemi përllogaritur, ekzaktësisht Ministria e Financave dhe ekspertët e financave kanë përllogaritur pagën reale që kanë fituar magistratët sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë dhe, pa e cenuar këtë pagë bruto, kanë referuar koeficientin e kësaj page te Presidenti i Republikës. Natyrisht, një risi e këtij ligji është fakti që paga e magistratëve do të indeksohet çdo dy vjet në raport me normën e inflacionit. Domethënë, edhe nëse Presidentit të Republikës hipotetakisht nuk do t’i ngrihet paga, gjyqtarëve dhe prokurorëve, jo vetëm që u sigurohet paga që kanë, u garantohet indeksimi i pagës, por, sigurisht, duhet ta dini, të nderuar kolegë, që magistratët në Republikën e Shqipërisë kanë edhe një shtesë page ligjore (është e përcaktuar në ligj). Ndryshe nga rritja e pagave që bëhet në

administratën publike, që herë pas here e bën qeveria në përqindje, magistratët në Republikën e Shqipërisë e kanë shtesën e vështirësisë për pozicion në ligj 90% mbi pagën bruto, që është e garantuar me këtë ligj dhe, sipas niveleve, marrin edhe shtesat e rritjes së pagës. Dua t’ju bëj me dije që sot që flasim, me këtë ligj, një magistrat që sapo del nga Shkolla e Magistraturës dhe merr emërimin rishtas në një nga nivelet e gjyqësorit, e ka pagën 290 mijë lekë bruto, ndërsa Prokuroria Speciale dhe Gjykata Speciale, në dijeninë tuaj, dhe të opinionit publik (po marr drejtuesit) e ka pagën bruto 640 mijë lekë të rinj, ndërsa prokurorët 600 mijë lekë të rinj. Ka qenë marrëveshja jonë me reformën në drejtësi që sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë të ketë një trajtim financiar të diferencuar nga pjesa tjetër e administratës shtetërore dhe publike, së pari për shkak se ne garantojmë pavarësinë e gjyqtarëve dhe të prokurorëve me këtë pagë; së dyti, mbajmë pastërtinë e sistemit të drejtësisë, pra gjyqtarët dhe prokurorët të mos kenë mundësinë të tundohen drejt korrupsionit me këtë pagë; së treti, edhe për shkak të vështirësisë së punës që ata kryejnë.

Kështu që unë dua t’ju ftoj, të nderuar kolegë, që ne t’i votojmë në paketë këto ligje. E thashë në fillim që ndihem shumë krenar që m’u dha mundësia të jem në këtë sallë për ta dhënë votën time pro kësaj pakete, njësoj si unë, jam i bindur që të gjithë kolegët e mi deputetë në këtë sallë pa dallim, sepse sot nuk vlen dallimi politik, do ta votojmë këtë paketë dhe t’u themi qytetarëve shqiptarë: faleminderit që na duroni 365 ditë të vitit, faleminderit që na duroni edhe gjatë fushatave elektorale, por ky është momenti që ne të gjithë bashkë duhet të punojmë për qytetarët shqiptarë.

Faleminderit dhe respekte!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka zoti Asllan Dogjani.

Të përgatitet ministrja e Arsimit, zonja Evis Kushi.

Asllan Dogjani – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Diskutimin tim për projektligjin për rritjen e pagave do ta nis me familjen e Edlira Kovaçit, një nenë me pesë vajza, banuese në njësinë nr. 9, atje ku banoj edhe unë.

Edlira ka pesë vajza. Më e madhja është 17 vjeç dhe më e vogla është 12 vjeç. Vajza e madhe është invalide, me një sëmundje të rrallë, e cila quhet *Myasthenia Gravis* dhe përkthehet dobësimi i rëndë i muskulaturës, që është një sëmundje e rrallë neurologjike, e cila të çon në plasjen e zemrës dhe kockat rriten në mënyrë të pakontrolluar. Si vajza e madhe, me këtë sëmundje janë diagnostikuar edhe vajzat e tjera, por edhe e ëma Edlira.

Para disa vjetësh, Edlira përfundoi në spital nga zemra dhe mezi mbijetoi. Fatmirësisht e kaloi, kjo për fatin e vajzave të saj, sepse ajo është e vetmja që kujdeset sot për vajzat e saj.

Edlira merr 9400 lekë pension invaliditeti në muaj për vajzën e saj dhe paguan 10 800 lekë në muaj për qiranë e një dhome ku jetojnë.

Nëna kërkon përditë në kazanët e plehrave për të siguruar ushqimin për vajzat e saj. Ne, disa banorë të lagjes, e kemi ndihmuar për disa vjet, por ajo ka nevojë për ndihmë të madhe, sepse i nevojiten ilaçe për vete dhe për pesë vajzat e saj.

Këta fëmijë kanë nevojë për ushqim, kanë nevojë për të shkuar në shkollë, për t'u veshur, për t'u vizituar dhe, më e rëndësishmja, është se ato kërkojnë ilaçe në mënyrë të vazhdueshme, përndryshe rrezikojnë të verbohen plotësisht, ose të vdesin.

Edlira i bën të gjitha përpjekjet për t'i ushqyer këta fëmijë, nuk del për të lypur në rrugë, por kërkon nëpër kazanët e plehrave. Edhe aty ka vështirësi, për shkak se si Edlira ka edhe të tjerë që e kërkojnë ushqimin nëpër kazanë.

E fillova me Edlirën, se e shoh çdo ditë kur dal nga shtëpia dhe, pavarësisht përpjekjeve dhe ndihmave nga banorët e lagjes, të cilët janë munduar ta ndihmojnë, nuk është e mjaftueshme, pasi ajo ka nevojë për ndihmë të vazhdueshme.

Unë do t'ju tregoj se si duket Edlira bashkë me vajzat e saj, të cilat, po t'i shikosh (e kam edhe për medien) ku jetojnë, duken si skelete, sikur kanë dalë nga kampet e nazizmit. Shikoni të ëmën, e cila mbledh nëpër kazanët e plehrave për të mbijetuar, për t'u ushqyer. Janë si skelete, sepse nuk e kanë mbushur ndonjëherë barkun me bukë.

Jemi munduar ta ndihmojmë të aplikojë tek "e-Albania" për të marrë pagesën e invaliditetit për vajzat e tjera që janë me aftësi të kufizuar, por nuk ka mundur të aplikojë. Ajo ka shkuar në shumë institucione, por nuk ka gjetur ndihmë.

Thotë që duan lekë për t'i dhënë pagesën për aftësi të kufizuar.

Pikërisht në fillim të këtij projektligji duhej të ishte parashikuar ndihma për këto familje, minimumi jetik se sa i duhet një familjeje, një personi për t'u ushqyer, sa i duhet një familjeje për të shkolluar fëmijët, për të marrë shërbimin shëndetësor, për të blerë ilaçet, pa marrë parasysh problemet e tjera të përditshme që kanë familjet shqiptare. Eh, sa janë si Edlira! Shumë familje të tjera shqiptare, për shkak të pamundësisë për të siguruar bukën e gojës, janë larguar nga vendi.

Në vazhdim të diskutimit tim, mendoj se në këtë projektligj duhej të ishte parashikuar edhe rritja e pensionit për pensionistët, sepse janë me qindra pensionistë që marrin 10 mijë lekë në muaj pension. Si do të jetojë një pensionist në Kamzë, Paskuqan, Kukës, Tiranë me 10 mijë lekë në muaj? A i dalin këto para për të blerë ilaçet, për t'u ushqyer, për të paguar dritat, ujin, se fëmijët u janë larguar nga Shqipëria bashkë me familjet e tyre dhe ndoshta nuk kanë mundësi për t'i ndihmuar?

Kjo duhej të ishte parashikuar në projektligjin për rritjen e pagave. Duhet të ishte parashikuar edhe rritja e ndihmës ekonomike. Çfarë mund të bëjë me 70 mijë lekë të vjetër, me 110 mijë lekë apo me 120 mijë lekë të vjetër, që është pagesa e papunësisë, një qytetar, një familje për të kaluar muajin?

Këto janë problemet, nga të cilat kanë ikur rreth 1 milion shqiptarë nga Shqipëria. Këto janë një pjesë e problemeve, sepse këtu ka shumë probleme. Nuk të hapet një derë në administratën publike, nuk të hapet një derë, por të shohin nga xhepi, gjuha e bindjet politike. Uluni e mendoni për të ardhmen e këtij vendi, se njerëzit tanë po largohen. Janë larguar të rinjtë. Dje dëgjova një intervistë të ambasadorit britanik që thoshte se 1520 të rinj shqiptarë janë në burgjet angleze. Po sa e sa të tjerë janë nëpër burgjet e Europës, sa familje nuk e dinë ku i kanë fëmijët e tyre, sepse nuk kanë asnjë lloj komunikimi me ta. E dëgjova Kryeministrin që tha se të rinjtë ikin, se e kanë dy orë larg. Askush nuk largohet me dëshirë nga vendi i vet. Askush nuk ka dëshirë t'i lërë nënën e babanë vetëm, të lërë shtëpinë këtu e të largohet për një copë bukë, por ikin, sepse nuk kanë asnjë dritë jeshile. Nuk kanë asnjë lloj mundësie. Të rinjtë nuk kanë mundësi të krijojnë familjet e tyre. Arsimi nuk merret siç duhet; shëndetësinë nuk e

marrin siç duhet. Njerëzit vuajnë duke pritur të bëjnë një operacion në zemër, sepse ka radhë të mëdha. Këto gjëra duhej të ishin parashikuar në këtë projektligj.

Sigurisht që paga e administratës publike duhet të rritet, sepse për shkak të pagave të ulëta ne sot kemi një administratë jokonkurruese; kemi një administratë, e cila nuk është e zonja. Të rinjtë e shkolluar janë larguar nga Shqipëria. Takova një specialist sot në mëngjes, që punonte në administratë, i cili më tha se me 47 mijë lekë në muaj mban 6 anëtarë në familje. 47 mijë lekë nuk më dalin për të jetuar. Pra, shumë mirë që rritet paga e administratës, madje është e vonuar, sepse, po të ishte rritur më parë paga e administratës, ne sot nuk do t'i kishim dyert e gjykatave të mbushura plot me hallexhinj, sepse, kur nuk zgjidhet ndonjë problem nga administrata, përfundojnë e dergjen nëpër dyert e gjykatave. Shkoni e shikoni se sa vuajnë njerëzit! Ka gjyqe, qoftë edhe për një divorc, që kanë shkuar tre vjet. Është martuar tjetra, është bërë me fëmijë dhe i kërkon burrit para, se thotë që është fëmija yt, se është regjistruar në emrin e tij. Pra, këto janë qindra e qindra probleme që i vuajnë çdo ditë qytetarët. Unë do t'ju kërkoja që në këtë paketë, përveç rritjes së pagës së administratës, të rritim ndihmën ekonomike, të rritim pensionet, të rritim pagesën e papunësisë. Meqenëse m'u kujtua pensioni, dua të them se çfarë keni bërë te ligji për pensionet, gjë që nuk e dinë qytetarët shqiptarë. Pas disa vjetëve edhe gratë, edhe burrat do të dalin në pension 67 vjeç, në një kohë që Franca u dogj pse shtoi një vit. Këtë nuk e dinë njerëzit.

Kryeministri rri e flet: gratë, gratë, gratë, në një kohë që gruaja do të dalë në pension në moshën 67 vjeç. Ajo nuk ka mundësi të punojë deri në moshën 67 vjeç dhe nuk do të arrijë ta gëzojë pensionin, për shkak se mosha mesatare në Shqipëri është 72-73 vjeç maksimumi.

Unë ju falënderoj që më dëgjuat dhe ju kërkoj që në ligjin për rritjen e pagave të përfshihen edhe ndihma ekonomike, edhe pensionet, edhe pagesa e papunësisë, si dhe të vendoset minimumi jetik për Edlirën dhe fëmijët e saj, që ajo të ketë mundësi dhe të mos shkojë të gërmojë në kazanët e plehrave. Nëse media apo kushdo nga ju do, le të vijë me mua dhe ta shikojmë se ku është Edlira, sepse unë e kam parë me sytë e mi se ku jeton, por jo vetëm ajo, edhe shumë e shumë Edlira të tjera.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjalën e ka ministrja e Arsimit, zonja Kushi.

Të përgatitet zonja Lindita Metaliaj.

Evis Kushi – E nderuar drejtuese e seancës, Të nderuar kolegë,

Vitet e fundit qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme, reforma rrënjësore, të guximshme, ku mund të përmend reformën në drejtësi, reformën territoriale, reformën në arsim, reformën në shëndetësi dhe në të gjithë sektorët. Por, sot e them me bindje se një nga reformat më historike pa dyshim që do të jetë reforma e rritjes së pagave, pjesë e së cilës është edhe ligji që do të votojmë sot. Kjo është një reformë që prek administratën publike, prek sektorin e arsimit, sektorin e shëndetësisë, Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit e kështu me radhë.

Them se kjo është një referomë historike, sepse sot shpërblehet puna. Kapitali njerëzor është pasuria më e madhe që ka ky vend. Shqipëria ka shumë pasuri, ka shumë vlera, ka pasuri natyrore, ka male, ka dete, ka fusha, por kapitali njerëzor është më i rëndësishmi dhe sot ne, me këtë reformë dhe me masat e vendimet e tjera që do të pasojmë, pa dyshim që vlerësojmë me dinjitet dhe me respekt kapitalin njerëz dhe punën në veçanti.

Pse pikërisht tani? Pikërisht tani, sepse nga njëra anë vitet e fundit kemi pasur vështirësi të jashtëzakonshme, për të cilat të gjithë jemi dëshmitarë, duke filluar që nga fatkeqësitë natyrore, por edhe faktorë të tjerë të ardhur nga jashtë që nuk vareshin nga ne. Nga ana tjetër, pikërisht sot kanë filluar të japin rezultat reformat e guximshme që kemi ndërmarrë këto vite, që sot po japin efekt në ekonominë dhe financat e vendit.

Kjo rritje vjen falë rritjes së të ardhurave; falë rritjes së eksporteve; falë rritjes së prodhimit; falë rritjes së investimeve publike, por edhe private; falë procesit të digjitalizimit; falë miradministrimit të mbledhjes së të ardhurave, të taksave dhe tatimeve; falë përmirësimit të shërbimeve për biznesin; falë forcimit të shtetit dhe uljes së korrupsionit, kryesisht në tatime dhe dogana.

Fillimisht, më lejoni të ndalem te mësuesit dhe pedagogët. Të gjithë biem dakord se ata janë të parët që duhet të vlerësohen, sepse rritja e pagave për ta është pa dyshim shpërblim për dijen,

shpërblim për sakrificën, për përkushtimin dhe për kontributin që ata japin në shoqëri.

Po e nis me pedagogët, sepse për ta tashmë rritja e madhe e pagave ka filluar që nga data 1 prill e këtij viti. Ne gjatë këtyre ditëve kemi punuar intensivisht në Ministrinë e Arsimit për të grumbulluar informacion edhe nga vendet e tjera të rajonit për të bërë krahasime, sepse, për fat të keq, edhe për mësuesit, edhe për pedagogët për shumë vjet Shqipëria ka qenë në vendin e fundit të tabelës dhe ja ku jemi sot.

Kjo tabelë, ky grafik tregon pagën për një asistent lektor, që është niveli më i ulët, le të themi, apo për pedagogët që fillojnë punë menjëherë pas studimeve master.

Shqipëria sot është në vendin e parë, ky është realitet, nuk është plan, nuk është dëshirë. Po ta krahasojmë edhe me Serbinë, edhe me Bosnjë-Hercegovinën, edhe me Kosovën, edhe me Maqedoninë e Veriut, një asistent lektor në Shqipëri paguhet më shumë se të gjitha vendet e tjera të rajonit, konkretisht 922 euro. Llogaritja është bërë në euro.

Për sa i përket pagës për një lektor, unë kam shënuar me rreth vendet që kemi lënë pas, konkretisht: Bosnjë-Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut, ndërkohë që jemi thuajse njësoj me Serbinë. Një lektor në universitetet shqiptare paguhet 1135 euro në muaj dhe një lektor në Serbi paguhet 1140 euro. Natyrisht, vendin e parë në këtë kategori e ka Kosova, sepse diferencat variojnë nga pozicioni lektor, profesor, profesor i asociuar.

Vazhdojmë me pagat për titullin “Profesor i asociuar”, këtu Shqipëria ka lënë pas Maqedoninë e Veriut dhe është pothuajse njësoj me Kosovën: Shqipëria e ka 1322 euro në muaj dhe Kosova e ka 1334; në vend të parë në këtë kategori është Serbia.

Vazhdojmë me titullin “Profesor”, që është kategoria më e lartë, këtu përsëri Shqipëria ka lënë dy vende pas, që janë Kosova dhe Maqedonia e Veriut, vendin e parë e ka Serbia, më pas vjen Bosnjë-Hercegovina dhe më pas Mali i Zi.

Ndërkohë që e thamë, por po e përsëris edhe një herë, rritja e pagave për pedagogët tashmë është realitet, e kemi filluar që në shtator të vitit të kaluar me 15%, ku 7% paguhen menjëherë nga buxheti i shtetit dhe 8% nga të ardhurat e vetë institucioneve të arsimit të lartë dhe më 1 prill u bë rritja e dytë me 30%, ku 20% i mbulon buxheti

i shtetit dhe 10% universitetet me të ardhurat e tyre.

Vijomë me mësuesit, me arsimin parauniversitar.

Edhe mësuesit kanë qenë vazhdimisht në fokusin tonë, madje pavarësisht vështirësive që kemi kaluar këto vite, në mandatin e kaluar pagat për ta u rritën me 32%, ndërkohë që në këtë mandat pagat vitin e parë u rritën me 6%, këtë vit u rritën 7% dhe vitin e ardhshëm ne kemi parashikuar rritjen më të madhe që ka ndodhur ndonjëherë në vitet e fundit, që shkon deri në 36% apo 37%.

Po filloj me mësuesit fillestarë në arsimin parashkollor, edukatorët e kopshtit. Kur them mësues fillestar, nënkuptoj që nuk ka as përvojë pune, as kualifikime, pra kjo është paga e parë që merr një edukatore apo një mësues, që e quajmë ne, i arsimit parashkollor sapo fillon punë. Përsëri kemi lënë pas në rajon tri vende, kemi qenë në vendin e fundit, ndërkohë që në vitin 2024, kur të hyjë në fuqi edhe rritja e madhe, një mësues i arsimit parashkollor fillestar do të marrë 605 euro. Kemi lënë pas Bosnjë-Hercegovinën, kemi lënë pas Kosovën, kemi lënë pas edhe Serbinë, ndërkohë që me Maqedoninë e Veriut jemi pothuajse njësoj dhe Mali i Zi është vendi i parë.

Vijojmë me mësuesit fillestarë të arsimit fillor, mësuesit e klasave të para, (përsëri fillestarë, kur nuk kanë as përvojë, as kualifikime, sigurisht që këto llogariten me rritje page), siç e shikoni në tabelë, vetëm Mali i Zi është para nesh dhe të gjitha vendet e tjera do të jenë pas. Shqipëria do ta ketë pagën për një mësues të arsimit fillor 664 euro në muaj dhe më pas vijnë Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Paga maksimale, këtu kemi llogaritur tani edhe përvojën maksimale të punës, edhe kualifikimet maksimale për një mësues, për të parë diferencën edhe te mësuesit me përvojë dhe jo vetëm te mësuesit...

Ermonela Felaj – Ju lutem, mos flisni nga vendi!

Nuk është diskutim nga vendi ky.

Evis Kushi – Përsëri kemi lënë pas dy vende, jemi pothuajse njësoj me Maqedoninë e Veriut e me Serbinë dhe Mali i Zi është në vendin e parë.

Këtu kemi mësuesin fillestar për arsimin e mesëm të ulët për klasat 9-vjeçare, pra nga klasa

e gjashtë deri tek e nënta. Jam shumë e lumtur, sepse, siç e shikoni, përsëri jemi në vendin e dytë në rajon, duke lënë pas edhe Bosnjë Hercegovinë, edhe Kosovën, edhe Maqedoninë e Veriut, edhe Serbinë.

Ndërkohë, për pagën maksimale, pra nëse një mësues i arsimit të mesëm të ulët ka përvojën maksimale të punës dhe, gjithashtu, kualifikimet maksimale, përsëri situata është e tillë, siç e shikoni, Shqipëria ngjitet në një vend vërtet dinjitoz në klasifikimin e rajonit.

Në fund, edhe për mësuesit e arsimit të mesëm të lartë, pra mësuesit e gjimnazeve, situata është shumë pozitive, jemi në vendin e dytë për mësuesin fillestar, po kështu edhe për mësuesin me përvojë.

I përmenda, i solla të gjitha këto fakte (siç e thashë, kjo është falë një pune intensive që kemi bërë këto ditë për të marrë informacionet zyrtare nga të gjitha vendet e rajonit) për t'u thënë mësuesve që të jenë më të motivuar dhe të jenë me kokën lart, të jenë krenarë, sepse sot ata kanë një pozicion dinjitoz, kanë një pagë dinjitoze, me respekt në raport edhe me kolegët e tyre në rajon. Ata të jenë edhe më shumë të motivuar, sepse kemi vërtet shumë punë përpara për të bërë.

Sistemi ynë arsimor ka nevojë edhe për shumë përmirësime. Një fakt tjetër, që na bën optimistë, është edhe renditja në vendin e dytë përsëri nga testi PIRLS i vitit 2021, që na bën krenarë dhe të përulur për të vijuar për të bërë më të mirën për fëmijët tanë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zonja Lindita Metaliaj.

Lindita Metaliaj – Të nderuar kolegë,
Të dashur qytetarë,

Në fakt, sot në rendin e ditës duhej të ishte farsa elektorale e 14 majit dhe kjo duhej të diskutohej pa përjashtim nga të gjithë ne. Megjithatë, unë nuk mund të rri pa i thënë dy fjalë në lidhje me paketën që po diskutojmë sot: atë të rritjes së pagave të administratës publike. Po, do të isha dakord, madje është shumë e vonuar, pasi keni 10 vjet në qeverisje, ndërkohë që pagat janë më të ulëtat në rajon. Fatkeqësisht, keni harruar disa kategori. Po rritni pagat e të gjithë administratës publike, po me pensionistët çfarë do të bëni? Kur do t'i rritni pensionet? Janë 670 000

pensionistë, që po presin se kur do ta ngremë kartonin për rritjen e pensioneve?

Po me ndihmën ekonomike çfarë do të bëni? Janë me mijëra familje atje poshtë, që po presin se kur do ta ngremë kartonin jeshil për rritjen e ndihmës ekonomike.

Kur do ta përcaktojmë minimumin jetik? Jemi i vetmi vend në Europë që ende nuk e kemi të përcaktuar minimumin jetik. Kjo është e turpshme dhe e pafalshme! Avokati i Popullit e ka përcaktuar qartë: 200 euro minimumi jetik për çdo person. Atëherë, ejani të bëhemi bashkë dhe ta miratojmë 200 euro për person minimumin jetik, këtë ta bëjmë për çdo individ atje poshtë, që i ka sytë nga ne, pastaj të ulemi dhe të diskutojmë për të gjithë administratën publike.

Thënë kjo, në fakt, unë nuk e kuptoj se si ky parlament mund të futet në shinat e normalitetit pas asaj masakre zgjedhore, që ndodhi vetëm 10 ditë më parë. Tashmë e dimë të gjithë, e di i madh e i vogël, se si u deformua vullneti i sovranit në Lezhë dhe në mbarë Shqipërinë. Zor se gjen banor të Lezhës që nuk i është ofruar para në këmbim të votës për "Rilindjen".

Në fakt, si përfaqësuese e Lezhës, mua më vjen turp që sot ndodhem në këtë seancë! Pse e them këtë? Unë drejtova fushatën elektorale në Lezhë bashkë me bashkëpunëtorët e mi, ku bëmë një fushatë model, një fushatë dinjitoze me burra e me gra, me të rinj e të reja, të cilët punuan fort, me shpirt e me zemër. Punuam fort, trokitëm kudo, derë më derë, në qytet e në fshat, me një program të shkëlqyer, të realizueshëm dhe me synime të qarta për ta ndryshuar Lezhën, krejt ndryshe nga ju, në fakt, sepse ne kishim kandidatin më të mirë, kishim kontratën me qytetarët dhe për qytetarët.

Në çdo takim shihej qartë dëshira për ndryshim; në çdo takim kryefjala ishte ndryshimi si për demokratët, ashtu edhe socialistët e ndershëm. Por për sa kohë që ky vend, fatkeqësisht, të drejtohet nga Rama, në këtë vend nuk mund të ketë zgjedhje të lira e të ndershme.

E kisha paralajmëruar më herët që aktorët e dosjes 184 të masakrës zgjedhore në Dibër, do të bënin të njëjtën masakër edhe në Lezhë dhe, në fakt, kështu ndodhi. Dyshja e korruptuar Ndreu – Manja, kombinacioni perfekt i krimit elektorale, bënë çdo gjë për ta mbajtur peng Bashkinë e Lezhës:

Ushtruan presion, shantazh mbi administratën, duke e detyruar të listonin nga 20 emra votues për “Rilindjen”.

Përdorën paratë e tërmetit, legalizimet, lejet e ndërtimit, të cilat ndikuan te liria e votës.

U përdorën paratë e krimit, të drogës dhe të korrupsionit, të cilat u hodhën lum.

Kriminelët, me mbështetje vendore dhe qendrore, ushtruan terror në qytet dhe në fshat.

U prenë qindra bileta nga agjencitë e udhëtimeve në Lezhë për të sjellë me bileta falas emigrantë nga jashtë vendit për të votuar “Rilindjen”.

Euroja arriti nivelin më të ulët të këmbimit valutor deri në datën 14 maj dhe u ringrit të nesërmen, më 15 maj.

Ndërkohë që fushata jonë ishte me shtrëngim duarsh, duke i parë njerëzit në sy dhe duke u dëgjuar hallet, sepse ne nuk blejmë vota.

Ndaj, unë sot gjej rastin të falënderoj nga zemra 16 376 banorë të Lezhës që e votuan ndryshimin përtej kërcënimeve dhe përtej presioneve! Jam krenare për të gjithë ekipin dhe bashkëpunëtorët e mi, për shpirtin që demonstuan në këtë fushatë të egër, me rregulla të pabarabarta loje dhe në një fushë të minuar. Mirënjohje pa fund për secilin prej tyre!

Po ashtu, kam falënderime të përzemërta për komisionerët tanë, për vëzhguesit, për numëruesit, që nuk bënë asnjë hap pas, por shpresuan deri në fund që vota e lirë do të triumfojë mbi makinerinë e krimit, duke u bërë mburojë e vullnetit të njerëzve të lirë, amanetqarë të votës për ndryshim.

Në fakt, 14 maji do të mbetet në historinë e Lezhës dhe të mbarë Shqipërisë si një ditë e zezë për demokracinë, për pluralizmin politik, pasi u vra vota e lirë. “Plumbi vret armikun tënd, vota, vret fëmijët e tu”, do të thoshte Abraham Lincoln-i.

Të dashur qytetarë, a e fitoi Bashkinë e Lezhës sektin e “Rilindjes”? Jo, në Lezhë fituan bandat dhe sot kjo bashki është peng i tyre. Këtë e di i madh dhe i vogël. Ndaj ftoj sot drejtuesin politik të Lezhës, ministrin e Drejtësisë pa drejtësi, që theu rekordin e përsëritjes së krimit elektoral edhe në Lezhë, të sqarojë makinacionet që u përdorën atje.

Unë i propozoj këtij parlamenti që t’i ndryshohet edhe emërtimi dhe nga ministër i Drejtësisë, të bëhet ministër i masakrës zgjedhore,

meqenëse është recidivist, pra përsëritës i suksesshëm i këtij krimi elektoral.

Gjithashtu, të na sqarojë se si u fituan zgjedhjet në Lezhë. A u përdor administrata publike? A iu bë presion administratës? A ishin drejtuesit e lartë të institucioneve të shpërndarë në çdo qendër votimi brenda dhe jashtë tyre, duke intimiduar votuesit? A u përdorën fondet publike? A u shtruan asfaltet elektorale deri ditën e zgjedhjeve? A u ushtrua terror në qytet dhe në fshat nga të fortët, të cilët i dhuruan fitoren dhe po e mbajnë peng Bashkinë e Lezhës? Sa bileta janë prerë nga agjencitë e udhëtimit në Lezhë me urdhër të “Rilindjes”? Verifikoni në sistemin TIMS se sa hyrje ka pasur më 13 maj dhe sa largime më 14 maj?

Gjithashtu, dua të pyes: në cilin vend të botës dhe aq më tepër në një vend që është anëtar i NATO-s, siç është Shqipëria, e cila aspiron për integrim drejt BE-së, i ashtuquajturit Kryeministër, del në fushatë duke kërcënuar votuesit dhe thotë: “Nëse do të votoni kandidatin e të djathtës, do t’ju ndërpriten fondet, si dhe do t’ju mbyllet rubineti i financimit”? A ka moral ky kërcënim? Vetëm një tradhtar dhe një i pabesë mund ta thotë këtë.

Në cilin vend të botës ndodh që në muajin elektoral, në prag zgjedhjesh, të rriten pagat e administratës dhe 670 mijë pensionistëve u jepet një bonus prej 5 mijë lekësh? Pra, shitblerja në këtë vend është kthyer në sistem.

Në këto kushte, gjej rastin t’u drejtohem publikisht ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonjës Juri Kim, dhe ambasadorëve të vendeve të Bashkimit Europian që ndodhen në Shqipëri, OSBE-ODIHR-it, të cilët i takova para zgjedhjeve dhe u dhashë një panoramë të qartë të situatës elektorale në Lezhë, duke i paralajmëruar për krimin elektoral që po përgatitej nga dyshja Ndreu – Manja, i bëj thirrje drejtuesit të SPAK-ut, zotit Dumani, Prokurorit të Përgjithshëm, zotit Çela, të hetojnë të gjithë masakrën elektorale në Lezhë, duke filluar me ministrin e Drejtësisë, kryebashkiakun e Lezhës, me veprimet dhe mosveprimet e Policisë së Shtetit në Lezhë, me drejtuesit e institucioneve, por edhe me personat e inkriminuar me të cilët bashkëpunuan në këtë farsë elektorale, pasi është e patolerueshme dhe e papranueshme që me këtë që ka ndodhur, të mos ketë asnjë person nën hetim dhe aq më pak prapa

hekurave. Megjithatë, unë shpresoj se deri në fund organet ligjzbatuese do ta thonë fjalën e tyre.

Për ta mbyllur, drejtuesi politik të na sqarojë, meqenëse ia dhashë edhe fjalën për replikë, për farsën elektorale në Lezhë. Ai të mos bëhet qesharak përpara banorëve të Lezhës, të cilët e dinë shumë mirë se çfarë ka ndodhur atje, por mbi të gjitha të mos bëhet qesharak për ata që ia dhuruan dhe ia mundësuan fitoren, të cilët po e mbajnë peng bashkinë.

Të dashur banorë të Lezhës, ne nuk do të dorëzohemi, por do të ringrihem përtej vështirësive, përtej pengesave dhe përtej çdo problematike. Ne do të jemi aty përsëri, Lezha nuk i nënshtrohet askujt që i imponohet asaj me metoda, të cilat zhbëjnë e njollosin historikun dhe traditën tonë. Unë ju ftoj të jeni optimistë, të mos humbasim besimin në energjitë tona! E diela e 14 majit, po, është e vërtetë, vrau të tashmen, por kurrsesi nuk mund të vrasë të ardhmen.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjala për ministrin e Drejtësisë, zotin Ulsi Manja, për replikë. Pastaj fjala është për kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotin Taulant Balla, me të cilin mbyllem diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Kjo është një replikë e detyruar, por edhe e bukur. Si drejtues politik i qarkut të Lezhës, jam shumë krenar për fushatën dhe rezultatin spektakolar të Partisë Socialiste në Lezhë dhe në Kurbin. Unë isha drejtues politik në Lezhë, në Kurbin dhe në Mirditë, por në Mirditë, ku fitoi modeli politik i zonjës, Ulsi Manja nuk ekzistonte, ndërsa në dy qarqet e tjera ministri i Drejtësisë dhe Ulsi ka bërë namin.

Zonjë e nderuar, për gjuhën diskriminuese, raciste, përçarëse dhe krahinore që përdorët në Lezhë, e morët përgjigjen, ndaj 1964 lezhjanë nuk mendojnë si ti.

Të nderuar kolegë, modeli i zonjës dhe gjuha që përdori në fushatë, e morën përgjigjen edhe nga lagjja e tyre. 228 qytetarë lezhjanë ku ka votuar zonja dhe ku banon zonja, kanë votuar për Pjerin Ndreun, ndërsa 154 veta kanë votuar kandidatin e zonjës. Pra, as lagjja e vet nuk e mbështeti këtë gjuhë dhe retorikë përçarëse.

Unë jam shumë krenar, sepse populli i Lezhës, i Kurbinut dhe i Mirditës më bëri të

ndihem edhe lezhjan, edhe kurbinas, edhe mirditor.

Gjuha e Sali Berishës dhe jotja ishte një mesazh i pastër për të ndarë Veriun dhe Jugun, por e mori përgjigjen me votë, më 14 maj. Rruga e mbarë të qoftë ty dhe të gjithë atyre që mendojnë si ti!

Unë jam krenar si ministër dhe si drejtues politik qarku. Por, për sa kohë unë dhe kolegët e mi mandatohe mi me votën e qytetarëve shqiptarë, ne do të përballemi sa herë do të vijnë zgjedhjet.

Respekt për të gjithë qytetarët e Lezhës, Kurbinut dhe Mirditës, për qytetarin që treguan më 14 maj! Unë së bashku me kandidatin tonë i kemi uruar fitoren kandidatit të Mirditës të nesërmen, sepse kjo është qytetari, është dinjitet.

Sigurisht, dua të përsëndes edhe kolegët, sepse nuk janë të gjithë njëllor në këtë krah, të cilët ia kanë uruar fitoren Majlinda Carës në Kurbin, sepse kjo është qytetaria në fund të fundit. Ndërsa gjuha jote do të marrë ndëshkim sa herë që do të shkojmë në zgjedhje.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Unë jam verior, jam malësor dhe jam shumë krenar. Unë jam edhe lezhjan, edhe kurbinas, edhe mirditor, edhe dibran edhe shkodran dhe malësor dhe çfarë të duash.

Ermonela Felaj – Zoti Ministër, mbaroi koha e replikës.

Fjala është për zotin Balla.

Ulsi Manja – Edhe ti je nga Lezha, por gjysmën tënde më të mirë nuk e ke nga Lezha. Lezha u ka bërë vend të gjithëve, edhe dibranëve...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ia kam ndërprerë fjalën zonjës, është pa mikrofon.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Zonjë, përse i bëni këto reagime, sepse jeni pa mikrofon. Kam ftuar zotin Balla në foltore.

Zoti Balla, fjala është për ju.

(Debat pa mikrofon)

Kolegë, a ka mundësi të mbani qetësi dhe të tregoni respekt ndaj kohës që i jepet secilit?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Unë përpiqem t'i mbaj të gjitha, zonja Ačka, edhe kur dikush thyen solemnitetin e seancës duke u paraqitur me veshje të papërshtatshme në seancë. Nuk besoj se aty ku jeni, keni parë dikë të vendosë kapelë gjatë zhvillimit të seancës.

Taulant Balla – Pas pak minutash do të votojmë një paketë, që përbëhet nga tri ligje, të cilat përmbajnë një vendim historik për rritjen e pagave në të gjithë sektorin publik. Nëse i rumbullakosim, janë rreth 180 apo 190 mijë përfitues të këtij vendimi historik, por nuk janë 140 përfituesit e këtij vendimi.

Nuk kishte asnjë diskutim që nga dita e parë kur qeveria solli këtë propozim në Kuvend, por kjo sallë nuk do t'i shpëtonte dot populizmit nga individë të caktuar, të cilët duan t'i rumbullakosin 180 mijë përfitues me 140 deputetë.

Kur kemi marrë vendimin, në vitin 2016, në kuadër të reformës në drejtësi dhe më pas në vitin 2017 me përcaktimet në buxhet, për të rritur pagat në sektorin ose në fushën e drejtësisë, thamë se rritja e pagave do të jetë ilaçi i duhur për të luftuar korrupsionin. Ne e dimë shumë mirë se me përjashtimin e deputetëve apo të ministrave nga kjo rritje që po bëhet në të gjithë sektorët, do të ngrihej një pyetje: po te politikanët përse nuk luftohet korrupsioni duke u rritur pagat?

Më lejoni të bëj një përmbledhje për të gjithë këtë proces. Qeveria solli një propozim, i cili ishte shumë i qartë: synimi ynë është që pagat mesatare të rriten në 900 euro deri në prill të vitit të ardhshëm. Qeveria në propozimin e vet përjashtoi dy kategori, ministrat dhe deputetët, për hyrjen në fuqi, por me një instrument që ishte ndërhyrje në hierarki.

Nga viti 1991 dhe deri më sot, Shqipëria është republikë e pastër parlamentare, ku Kuvendi është në krye të hierarkisë institucionale të vendit. Nëse do të kisha mundësi të bëja një amendament, do të ishte që në krye të hierarkisë, sikurse është edhe në Gjermani (nga ku e kemi kopjuar pothuajse pjesën më të madhe të Kushtetutës sonë), të mos jetë Presidenti i Republikës, por të jetë Kryetari i Kuvendit, pra, ashtu siç është në Gjermani, ku në hierarkinë institucionale, protokollare dhe në atë të pagave është Presidenti i Bundestagut referenca e parë, nuk është Presidenti i Republikës.

Megjithatë, ne kemi ruajtur këtë hierarki që nga viti 1991. Pra, sa herë që është votuar ligji i pagave i pari është Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe pas disa shkallëve janë deputetët. E njëjta gjë do të votohet edhe sot.

Që të jemi shumë të qartë dhe ta kuptojnë edhe ata që na ndjekin: sot nuk po rriten pagat e

deputetëve, por po rriten pagat e 189 mijë punonjësve të shtetit, sipas hierarkisë që kanë në pozicionin që mbajnë, për detyrën që kryejnë.

Deri në vitin 1991 deputetët, anëtarët e Kuvendit Popullor, nuk ishin me pagesë, ndërsa kooperativisti paguhej në kooperativë, minatori në minierë. Ne kemi vendosur të aplikojmë këtë sistem, duam apo nuk duam. Do apo nuk do Dashi, ne këtë gjë duhet ta bëjmë ose të biem dakord, të gjejmë një formulë tjetër institucionale dhe të ndryshojmë Kushtetutën.

Nëse propozimi do të votohej siç ishte, atëherë do të binte në kundërshtim me Kushtetutën, sepse hierarkia e pozicionit që mban është në varësi të hierarkisë institucionale.

Në komisione, propozimi i qeverisë u ndryshua. A është kështu apo jo? Më thoni një deputet të opozitës që e kundërshtoi dakordësinë e vendosur në komision? Të çohet një deputet, nga këta që folën kundër, dhe të thotë: vajta në komision dhe isha kundër dakordësisë së vendosur në komisione. Madje e përshëndes...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ti nuk ke qenë në mbledhje.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ti nuk ke qenë në mbledhje dhe thua: "Jam kundër".

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Nuk ke qenë në mbledhje.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Lëri populizmat, sepse të futi Saliu në rresht sot.

Në komisione është dakordësuar ky variant. Që të shkohet për ndryshimin e variantit në komisione duhet që të ketë një amendament. Propozimi ynë, i bërë nga Kryeministri...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Zonja Tabaku, kur flisni ju, unë tregoj shumë vëmendje. Nuk ju kam ndërprerë asnjëherë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dakord, por ti mos u peshko.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Shumë e thjeshtë, mos bjer pre...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ajo që po ju them është: nëse edhe ju jeni dakord që të bëjmë një amendament për hyrjen në fuqi vetëm për 2 grupet, deputetë dhe ministra, jeni të mirëpritur. Ne e kemi bërë propozimin tonë, e bëri Kryeministri, të cilin do ta argumentoj më poshtë. Sikurse e thashë, edhe me argumentet

që lidhen me hierarkinë, për pozicionin që ka Kuvendi, këtu bëhet fjalë për një paketë, ju e dini fare mirë që në këtë paketë përfshihet edhe një ndërhyrje e domosdoshme të ligji “Për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, sepse nëse nuk bëhet kjo ndërhyrje, atyre që e kanë rrogën 6 milionë u shkon 9 milionë. Pra, ajo që po ndodh është që deputetët të kenë të paktën sa gjysma e kësaj page, se duam të jemi të sinqertë me të gjithë ata që na ndjekin. Me këtë rritje, përsëri në Republikën e Shqipërisë një deputet e ka rrogën sa gjysma e një drejtuesi të institucionit të drejtësisë, që të mos fillojmë të abuzojmë. Kjo duhet votuar e gjitha në paketë. Ne nuk i kemi 84 vota, por për këtë vendim çdo deputet duhet ta tejkalojë atë populizmin bajat, të ndonjë fjalimi këtu, të cilët bëjnë si interesantë duke thënë: “Shiko se...”.

Të flisni ju për pensionistët? Ju që u kujtuat sot për pensionistët, sepse ne i kemi bërë disa vendimmarrje për ta dhe do të vazhdojmë të bëjmë edhe ndërhyrje të tjera. Ne bëmë një shpërblim në janar, një shpërblim tjetër e bëmë në prill, për të cilin ju ishit kundër, do të bëjmë një tjetër përsëri në fund të gushtit apo në shtator dhe e kemi kthyer në politikë mbështetjen dhe shpërblimin për pensionistët në fund të vitit. Të mos harroni se kjo rritje historike e pagave, në fund të fundit, kush di mirë matematikë, që $7 \times 7 = 49$ dhe jo $7 \times 7 = 42$, e kupton qartë se do të sjellë rritjen e pensioneve, sepse do të rritet kontributi për efekt sigurimesh shoqërore dhe fondi ynë i sigurimeve shoqërore do të ketë më shumë mundësi për të paguar pensione më të larta.

Nëse e doni, këtë propozim që e tha Kryeministri, unë si kryetar i grupit jam në një linjë me Kryeministrin dhe grupin tim parlamentar, e jani të bëjmë një amendament të hyrja në fuqi për këto dy grupe. Nëse nuk jeni dakord, zonja Kryetare, mund të kalojmë në votim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Balla!

Po, zonja Aça. Përse e kërkoni fjalën?

Flutura Aça – Për replikë me ju.

Ermonela Felaj – Jo, nuk ka replikë me drejtuesen e seancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po jua përsëris: në Kuvendin e Shqipërisë sjellja duhet të jetë e përshtatshme, sikundër edhe veshja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Tabaku e ka parë me vëmendje zonjën Aça se si u soll në momentin kur po fliste Kryeministri, dhe nuk ia kam tërhequr vëmendjen, sepse qartësisht kërkonte të provokonte seancën. Ama, zonja Aça nuk mund të kërkojë vetëpërmbytje nga kolegët dhe respektimin e Rregullores dhe të etikës, kur nuk e zbaton vetë këtë gjë.

Këtu mbyllet diskutimet për paketën ligjore.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem!

Ndërkohë që deputetët bëhen gati...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bardhi, e pyeta dhe u përgjigj: “Për replikë me ju”. Jam shumë e qartë në ato çfarë them, pasi kujdesem t’i dëgjoj deputetët.

Zonja Aça, ju lutem, uluni!

Ndërkohë që deputetët bëhen gati për procesin e votimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është dikush tjetër.

Ndërkohë që deputetët bëhen gati për procesin e votimit të projektligjeve që kanë të bëjnë me rritjen e pagës, më lejoni t’ju bëj me dije komunikimin shkresor me institucionin e Presidentit të Republikës nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.

Pranë institucionit të Presidentit të Republikës janë përcjellë dy shkresa: shkresa me nr.1255/2 protokolli, datë 24 maj, dhe shkresa me nr.1380 protokolli, datë 25 maj. Në të dyja këto shkresa, Kuvendi i Shqipërisë i ka kërkuar institucionit të Presidentit të Republikës, që konform Kushtetutës dhe neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe konform neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit, të japë pëlqimin për dekretimin e menjëhershëm të këtyre projektligjeve.

Ka një motivim të parë, që u tha gjatë fjalës së ministrit të Drejtësisë dhe gjatë fjalës së kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste: është kërkuar dhënia e pëlqimit nga Presidenti i Republikës për hyrjen në fuqi menjëherë të projektligjit që ka të bëjë me një ndryshim në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, i cili, menjëherë pasi është dhënë, e detyron Kuvendin e Shqipërisë të reagojë. Është parashikuar një dispozitë e re për pagën referuese të magjistratit

dhe për të siguruar një planifikim në kohë dhe efektiv të shpenzimeve buxhetore për përballimin e pagesave për pagën e magjistratëve brenda vitit 2023, me efekt që nga data 1 prill 2023, Presidentit të Republikës, me kërkesë të Kuvendit, i është kërkuar dhënia e pëlqimit për dekretim të menjëhershëm. Kjo kërkesë është miratuar dhe citon: “Presidenti i Republikës jep pëlqimin për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit, pasi ky ligj të miratohet në Kuvendin e Shqipërisë”.

Të njëjtën përmbajtje ka edhe shkresa e dytë, që i është nisur Presidentit të Republikës së Shqipërisë për dy projektligjet e tjera: për projektligjin që ka të bëjë me ndryshimet në ligjin “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat në institucionet e pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, si dhe për projektligjin “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

Meqenëse këto tri projektligje janë shqyrtuar si paketë, Presidenti i Republikës, pasi ka dhënë pëlqimin për dekretimin e menjëhershëm të projektligjit që lidhet me magjistratët, ka dhënë pëlqimin edhe për dy projektligjet e tjera. Kjo është arsyeja pse Kuvendi i Shqipërisë ftohet të kalojë në procesin e votimit.

U lutem kryetarëve të grupeve, nëse kolegët janë gati, të fillojmë me votimin!

Zoti Balla.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, kolegë!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Zoti Korreshi mund ta kërkojë fjalën vetë, nuk ka nevojë të ketë ndihmës.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Zoti Korreshi, për çfarë e keni kërkuar fjalën?

Saimir Korreshi – Do të flasim edhe ne në emër të grupit.

Ermonela Felaj – Ju nuk mund të flisni në emër të grupit, sepse grupi ka kryetar.

Saimir Korreshi – E nderuar drejtuese e seancës,

E fillon duke sqaruar dhe sërish bën populizëm. Nuk mund të bëhet populizëm, sepse nuk ka amendament dhe ne jemi jashtë

Rregullores këtu. Mos bëni populizëm! Po të doni, unë jam dakord me Kryeministrin. Vjen dhe na thotë neve: “Ju vuri ai në rresht”, dhe më pas viheni në rresht pas Kryeministrit.

E shkelim dot ne Kushtetutën dhe Rregulloren, që do të futësh amendament te kjo pjesë?! Nëse mund ta shkelim Kushtetutën dhe Rregulloren, oburra, ta shkelim! Heqim edhe pjesën tjetër pastaj, ndalimin kushtetues, që deputetët të bëjnë edhe ndonjë punë të dytë, në piceri ose në larje pjatash.

Ermonela Felaj – Zoti Korreshi, nëse më dëgjuat me kujdes (besoj se nuk më keni dëgjuar), unë nuk fola në asnjë moment për amendamentin që u propozua këtu, por fola për arsyen se përse do të votojmë tani për këtë paketë ligjore.

U lutem kryetarëve të grupeve të më konfirmojnë kur të jenë gati për votimin, që të vijojmë!

Kolegë, ju lutem, uluni! Të fillojmë me procesin e votimit!

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Janë 101 deputetë prezentë. Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 3 deputetë.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ju kujtoj se ky akt, sipas Kushtetutës, kërkon një shumicë të cilësuar votash prej 3/5-tash. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi do të jetë i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 98 vota pro, 2 kundër, asnjë abstenim. Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 4 deputetë.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit. Komisioni përgjegjës për këtë projektligj është Komisioni i Ligjeve.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 93 vota pro, 2 kundër, asnjë abstenim. Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 8 deputetë.

Me këtë shumicë, projektligji miratohet edhe në tërësi.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara më ligj”, i ndryshuar”. Ju kujtoj që ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash, sepse votohet për pagat dhe shpërblimet e strukturave të institucioneve. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

97 deputetë kanë votuar pro ndryshimeve në këtë projektligj, 3 deputetë janë kundër, abstenime nuk ka. Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 3 deputetë.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit përgjegjës.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

95 deputetë janë pro ndryshimeve në këtë projektligj, 3 deputetë janë kundër, abstenime nuk ka. Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 5 deputetë.

Miratohet.

Kalojmë në votimin e tretë të paketës, që lidhet me reformën e pagave: projektligji “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 96 vota pro ndryshimeve në këtë projektligj, 1 kundër, asnjë abstenim. Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 6 deputetë.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit përgjegjës.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 janë nene të tjera të këtij ligji.

Kam një shënim.

Ju lutem, sekretaria...

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Ju lutem kolegë, vijoni me votimin.

Mbyllet votimi.

Janë 97 vota pro, 2 vota kundër, asnjë abstenim.

Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 5 deputetë.

Miratohet në tërësi projektligji.

(Diskutime pa mikrofon)

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve””. Kolegët deputetë që i përkasin Grupit Parlamentar

të Partisë Socialiste, si: Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Eduard Shalsi dhe Taulant Balla janë tërhequr nga diskutimet. Mbeten 3 kolegë të tjerë deputetë, si: Arbi Agalliu, Ina Zhupa, Andia Ulliri dhe zoti Bujar Leskaj.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Tërhiqeni nga diskutimet?

Atëherë, mbyllet diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë tek akti normativ nr.1, datë 27.04.2023 “Për një shtesë në ligjin nr.8952, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”. Pra, bëhet fjalë për kohëzgjatjen që i dhamë vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike me rastin e zgjedhjeve.

Deputetët që kishin regjistruar emrat për të folur për këtë pikë të rendit të ditës janë tërhequr, kështu që unë do t'i ftoj kolegët të kalojmë në procesin e votimit për këto dy pika. Më pas do të kalojmë te diskutimet jashtë rendit të ditës, nëse deputetët që janë regjistruar do të duan të diskutojnë.

Atëherë, kalojmë në votim.

Ka dy votime me elektronikë për sa i takon ligjit që sapo lexuam, që ka të bëjë me mbështetjen e startup-eve.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 78 vota pro, 12 kundër, 1 abstenim.

Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 14 deputetë.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 3 deri te neni 8 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)

Neni 9/1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni tjetër i ligjit, i cili, në fakt, në projekt është vijuar si neni 9. Besoj se shërbimet do të bëjnë korrigjimin për ndryshimin e numrit, meqenëse është shtuar neni 9/1.

Neni 9. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14 “Hyrja në fuqi”. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, 15 kundër, 1 abstenim.

Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 16 deputetë.

Miratohet projektligji.

Kalojmë në miratimin e aktit të fundit të rendit të ditës, që ka të bëjë me aktin normativ nr.1, datë 27.04.2023 “Për një shtesë në ligjin nr.8952, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 30 deputetë.

Miratohet akti normativ.

Këtu mbyllet procesi i votimit.

Ju njoftoj se në seancën e ardhshme plenare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem kolegë, kemi edhe dy momente të fundit.

Atëherë, kemi edhe projektvendimet që ju njoftuam në hyrje të seancës plenare.

Projektvendimi “Për emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit të Statistikave”. Zoti Adrian Kamenica emërohet në detyrën e anëtarit të Këshillit të Statistikave, përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i fshehtë. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 69 vota pro, 2 kundër, asnjë abstenim.

Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 34 deputetë.

Miratohet projektvendimi për emërimin në detyrë të këtij anëtari të Këshillit të Statistikave.

Kalojmë në projektvendimin “Për emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit të Statistikave, zotit Edvin Zhllima”. Ndiqet e njëjta procedurë edhe për këtë rast. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i fshehtë. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 69 vota pro, 2 kundër, 1 abstenim.

Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 34 deputetë.

Miratohet projektvendimi për emërimin në detyrë të këtij anëtari të Këshillit të Statistikave.

Kalojmë te projektvendimi “Për emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit të Statistikave, zonjës Elora Kokalari”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i fshehtë. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 71 vota pro, 2 kundër, 1 abstenim.

Të pranishëm, që nuk kanë votuar, janë 32 deputetë.

Miratohet projektvendimi për emërimin në detyrë të zonjës Elora Kokalari si anëtare e Këshillit të Statistikave.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit të Statistikave, zonjës Kozeta Sevrani”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i fshehtë. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 76 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi për emërimin në detyrë të zonjës Sevrani.

Kalojmë në projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”. Zoti Frrok Gjini caktohet anëtar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Kalojmë në projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”. Zoti Shkëlqim Bullari caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, 1 abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Kalojmë në projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”. Zoti Qani Xhafa caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 81 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”. Deputeti, zoti Ilir Metaj, caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 69 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Kalojmë te projektvendimi “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”. Deputeti, zoti Bardhyl Kollçaku, caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Politikën e Jashtme. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa merak, po e korrigjoj!

Po bëj edhe korrigjimin përkatës: zoti Kollçaku emërohet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme, megjithëse, në fakt, unë këtu e kam të shkruar “zëvendësues”, kështu që isha korrekte.

Kalojmë te projektvendimi tjetër “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”. Zoti Petro Koçi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 70 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Kalojmë te projektvendimi “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”. Zonja Greta Duraku caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Politikën e Jashtme.

**Sekretare e Sekretariatit për
Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka**

**Drejtoreshë e Shërbimit të Redaktorëve
Suela Bala**

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Këtu mbyllet procesi i votimit të projektvendimeve që kanë të bëjnë me komisionet e përhershme parlamentare.

Kolegë, ju njoftoj se në seancën e ardhshme plenare, ditën e enjte, në orën 13:00, do të mbajë një fjalë Presidentja e Hungarisë. Meqenëse java që vjen, në mos gaboj, nga Konferenca e Kryetarëve është vendosur të jetë “Javë e gjelbër”, po ju njoftoj paraprakisht për marrjen pjesë në këtë seancë të posaçme që do të zhvillohet në nder dhe në respekt të Presidentes së Hungarisë.

Faleminderit!

Ditën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 15:00)

Nënkryetarja e Kuvendit

Ermonela Felaj